

Bashkim Azemi & Remzi Bujari

Bazat e kërkimit në edukim

Prishtinë, 2013

Botues
Instituti Pedagogjik i Kosovës

Autorë
Bashkim Azemi & Remzi Bujari

Recensent:
Prof. Dr. Naser Zabeli

Redaktor përgjegjës
M.sc. Nezir Çoçaj

Lektor
Bekim Morina

Faqosja
Skender Mekolli

Përmbajtja

Hyrje.....	7
I. KËRKIMET SHKENCORE NË FUSHËN E EDUKIMIT.....	8
1. Rëndësia e kërkimit shkencor	9
2. Fokusi i kërkimit shkencor	9
3. Përshtatshmëria e kërkimit shkencor	10
4. Qëllimi i kërkimit shkencor.....	11
5. Arsyeshmëria e kërkimit shkencor	11
6. Vlefshmëria e kërkimit shkencor.....	12
7. Besueshmëria e kërkimit shkencor.....	12
8. Praktikimi i kërkimit shkencor	13
9. Burimet e domosdoshme për kërkim	14
10. Koha e nevojshme për kërkim	14
11. Llojet e kërkimeve shkencore	14
II. METODAT E KËRKIMIT SHKENCOR.....	20
1. Metoda eksperimentale	21
2. Metoda e analizës së dokumentacionit	22
3. Metoda përshkruese.....	23
4. Metoda krahasuese (komparative).....	23
5. Metoda historike	24
6. Metoda statistikore	25
7. Metoda e grupit të përqendruar (fokus-grupi)	25

8. Metoda e vrojtimit - vëzhgimit	27
9. Metoda demografike	28
III. TEKNIKAT DHE INSTRUMENTET E KËRKIMIT SHKENCOR.....	30
1. Instrumentet e kërkimit në fushën e edukimit	30
2. Teknikat e kërkimit në fushën e edukimit	35
3. Shkallët e matjes	38
4. Indekset	43
5. Indikatorët.....	44
IV. HIPOTEZAT DHE VARIABLAT E KËRKIMIT SHKENCOR.....	47
1. Hipotezat e kërkimit shkencor	47
2. Variablat e kërkimit shkencor.....	53
V. POPULLACIONI DHE GRUPI PËRFAQËSUES	58
1. Popullacioni.....	58
2. Grupi përfaqësues	60
VI. ETIKA HULUMTUESE DHE CILËSITË E HULUMTUESIT..	69
1. Etika hulumtuese	69
2. Cilësitë e hulumtuesit.....	72
VII. FAZAT E KËRKIMIT SHKENCOR.....	74
1. Zgjedhja e temës për kërkim.....	75
2. Përcaktimi i detyrave të kërkimit.....	78
3. Përcaktimi i objektivave të kërkimit	79
4. Shqyrtimi i literaturës.....	79

5. Ndërtimi i hipotezave.....	80
6. Zgjedhja e metodologjisë.....	81
7. Qasja në hulumtim.....	81
8. Përshtatja e metodave (cilësore ose sasiore) të kërkimit.....	82
9. Përzgjedhja e teknikave dhe instrumenteve	84
10. Shkrimi i projektit (planifikimi i punës kërkimore: skica, dizajni i kërkimit).....	89
11. Mbledhja e fakteve - të dhënave.....	91
12. Përpunimi i të dhënave (fakteve).....	93
13. Interpretimi i rezultateve.....	98
14. Të shkruarit e raportit të kërkimit.....	99
15. Përgatitja e punimit për botim.....	102

VIII. DISA RREGULLA GJATË SHKRIMIT TË PUNIMIT

SHKENCOR.....	104
1. Hapësira në mes të rreshtave në punim	104
2. Kufijtë - margjinat	104
3. Citimet.....	106
4. Parafrazimet.....	108
5. Fusnotat.....	108
6. Bibliografia.....	109
FJALORTH	112
Literatura.....	121
SHTOJCAT	123
Shtojca A.....	123

Udhëzues për përdorimin e programit SPSS (Statistical Package for Social Sciences).....	123
Shtojca B.....	133
Disa shembuj të instrumenteve.....	133

Hyrje

Libri *Bazat e kërkimit në edukim* trajton aspekte themelore që kanë të bëjnë me kërkimin në edukim, gjegjësisht një përpunim sistematik dhe të strukturuar të detyrave komplekse, të cilat i dalin kërkuesit të ri, si një përgatitje moderne: në procesin e hartimit, mbledhjes, planifikimit, zbatimit dhe bartjes së njohurive solide në specifikat e punës shkencore.

Libri e ka një qëllim të thjeshtë: t'u ofrojë studentëve (hulumtuesve) të rinj njohuri themelore për të mësuar në lidhje me metodologjinë e kërkimit, në mënyrë që të mund të mësojnë më shumë për “sekretet” e punës hulumtuese, gjatë realizimit të kërkimeve në edukim.

Libri do t'u shërbejë studentëve për njohuri themelore (fillestare) të domosdoshme për të kryer punë kërkimore të pavarur, për tejkalimin e vështirësive që u dalin gjatë zgjedhjes së temës, metodologjisë së kërkimit, zgjedhjes së teknikave dhe instrumenteve hulumtuese, problemeve gjatë realizimit të kërkimit dhe kompleksitetit të shkrimit përfundimtar të punimit (nga titulli, përmbajtja, hyrja, parathënia, paraqitja e rezultateve, grafikonet, tabelat, nxjerrja e konkluzioneve, shkrimi i përfundimit, rezymesë, bibliografisë dhe shtojcës, e deri te redaktimi, lekturimi, redaktimi teknik dhe shtypja apo botimi i punimit). Këto nxënie u shërbejnë si ndihmesë për pavarësim dhe aftësim, për të pajtuar metodën me qëllimin, si dhe për të harmonizuar instrumentet e kërkimit me detyrat e kërkimit, duke u mbështetur në zbatimin e metodave dhe përvetësimin e mënyrave të veprimit të pavarur gjatë kërkimeve, në aspektin e skicimit, si dhe për të zhvilluar idetë (tezat) e veta me pavarësi kërkimi.

Ky kompleksitet rrjedh nga fakti se në punën hulumtuese nuk ka një pikë zero dhe një koordinatë të përcaktuar qartë, për shkak të problemeve dhe të ndërhyrjeve që duhet të bëhen gjatë kërkimit (për mendimin tonë zbërthimi i njohjes së kompleksitetit të kërkimit do të donte një punim më të zgjeruar dhe është një çështje në vete), të cilën do ta prekim aq sa na duket e mjaftueshme për studentët, andaj vëllimi i librit ofron mundësi praktike të përdorimit të tij.

I. KËRKIMET SHKENCORE NË FUSHËN E EDUKIMIT

Kërkimet shkencore në fushën e edukimit kanë funksione e tipare të përbashkëta me kërkimet shkencore në fusha të tjera të shkencës, por kur është fjala për karakteristikat e kërkimeve në edukim, atëherë mund të arrijmë në përfundim se në këtë fushë, për arsye të natyrës së shtrirjes institucionale, qëllimit dhe synimeve, ekziston trajtim i veçantë i disa aspekteve të edukatës dhe të arsimit, vështrimin e tyre, klasifikimin, aplikimin etj.¹

Kërkimi shkencor është proces për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për disa qëllime², apo një shqyrtim sistematik, kontrollues, empirik dhe kritik i dukurive të natyrës, udhëhequr nga teoria dhe hipotezat për studimin e lidhjeve të supozuara midis dukurive.³

Çdo kërkim shkencor fillon me një përgatitje të caktuar teorike, praktike (teknike) dhe organizative.

Përgatitja teorike nënkupton përvetësimin e njohurive kërkimore, për të përçuar dhe mbartur logjikën epistemologjike në veprën shkencore, të ligjshmërive: teoritë, njohuritë, stilin, gjuhë, terminologjinë etj.

Përgatitja teknike nënkupton qasjet e grumbullimit, të vëzhgimit, të rregullimit, të eksperimentimit dhe të matjes së saktë të të dhënave, të cilat mund të përdoren në kërkim.

Përgatitja organizative nënkupton organizimin e kërkimit dhe aspektit të sigurimit të teknologjisë për punën kërkimore.

Çdo kërkim shkencor zhvillohet duke kaluar në një varg fazash të ndryshme, duke filluar nga vrojtimet, mbledhja dhe sqarimi i fakteve, formulimi dhe verifikimi i rezultateve, e deri te vlerësimi kritik i rezultateve të arritura. Me zotërimin e metodologjisë shkencore kërkimore lehtësohen dhe përvetësohen mënyrat e kërkimit në fushën e edukimit.

Metodologjinë e punës shkencore kërkimore e avancojnë shumë faktorë, siç janë:

1. Metodatat bashkëkohore;

¹ Më gjerësisht, Prof. Dr. Xheladin Murati. 2004. Metodologjia e kërkimit pedagogjik, (botimi i tretë), “Çabej”, Tetovë, f. 38.

² James H. Mc. Millan, Sally Shchumacher. 1989. Research in education.

³ Kerlinger. 1986. Foundation of behavioral research.

2. Kërkimet fundamentale, aplikative dhe zhvillimore;
3. Mundësitë reale të planifikimit dhe të financimit të shkencës;
4. Të arriturat pozitive në sferën e sistemeve të informacioneve etj.

1. Rëndësia e kërkimit shkencor

Kërkimi shkencor është proces sistematik i dukurive deri më tani të panjohura, me karakter teorik ose empirik, për të zgjidhur probleme praktike dhe për të verifikuar teori ose për të shtuar njohuri të reja.

Kërkimi shkencor është një proces sistematik njohës, në përpjekje për t'i dhënë përgjigje pyetjes së parashtruar në hipotezë.

Pra, kërkimi shkencor ka të bëjë me gjurmimin sistematik të fakteve, nga të cilat mund të nxirren parimet dhe ligjshmëritë e caktuara shkencore, e në pajtim me këtë, fakti që shkencën në të vërtetë e përbëjnë rezultatet, deri tek ato arrihet me anë të kërkimeve.

2. Fokusi i kërkimit shkencor

Ekzistojnë disa mënyra për të identifikuar objektin dhe subjektin e kërkimit:

- a) Fusha e kërkimit shkencor - edukimi;
- b) Orientimi i kërkimit - mësimdhënia, tekstet, korniza e kurrikulës etj.
- c) Problemi ekzistues i kërkimit - duhet të jetë i identifikuar dhe i vlerësuar, në mënyrë që të pranohet se ia vlen të hulumtohet si problem;
- d) Qëllimi i kërkimit - për problemin dhe identifikimin e njohurive inspiruese;
- e) Pyetja e kërkimit - përcaktimi preliminar, apo artikulimi i saj në formë të temës.

Kërkimi empirik mbi mendimin e përgjithshëm u përket informacioneve që lidhen me përvojat e përditshme, të cilat mblidhen në formë eksploruese për t'i përcaktuar kufijtë e një teme apo një problemi.

Gjatë kërkimeve është rregull që kërkuesi t'i bëjë pyetje edhe vetvetes për stereotipet. Fillimi i kërkimeve duhet të jetë gjithëpërfshirës, sepse:

- Identifikimi i qëllimit të kërkimit na ndihmon në fokusimin e çështjes, për të cilën do të hulumtojmë ose që na intereson;

- Fokusi i kërkimit gjithashtu na ndihmon të kemi një grup të synuar për kërkim;
- Fokusi i kërkimit na ndihmon të përzgjedhim edhe vendbanimin ose vendbanimet e individëve.

3. Përshtatshmëria e kërkimit shkencor

Karakteri i kërkimit kërkon edhe përshtatshmërinë e caktuar, mirëpo varet nga parakushtet specifike në mbledhjen e të dhënave dhe varësisht se çfarë rezultatesh priten nga kërkimi.

Kërkimi është i përshtatshëm për mbledhjen e informatave në tri kushte:

1. Kur mund të mbledhim informata kuantitative dhe kualitative;
2. Kur informatat janë specifike për një problem dhe respondentët dinë për këtë;
3. Kur kërkuesi ka dije paraprake se çfarë rezultatesh për afërsisht do të mund të fitojë.

Një rëndësi e ka gjithashtu edhe vazhdimësia (produktet e kërkimit) pas realizimit të kërkimit, për të ditur se:

1. A është ky kërkim përfundimtar (që bëhet vetëm një herë), apo duhet të përsëritet në rrethana e ambiente të ndryshme;
2. Si do t'i përdorim rezultatet e kërkimit (dobia e tyre), teorike apo praktike.

Qasja metodologjike e kërkimit shkencor

Qasjet hulumtuese shkencore janë element i rëndësishëm i njohurive shkencore dhe një nga përcaktuesit e kërkimit shkencor. Praktika e kërkimeve në edukim i ka tejkaluar këto ndarje strikte, për shkak se, edhe pse mund të përcaktohem për qasjen metodologjike kualitative, apo qasjen metodologjike kuantitative, dukuritë në edukim i përfshijnë të dyja. Pra, komponentët kualitativë dhe kuantitativë, nga fakti se jo të gjitha dukuritë mund të maten saktë dhe në mënyrë precize.

Praktika e tanishme e kërkimit, sidomos përpunimi i instrumenteve dhe i të dhënave, është integrale, kualitative-kuantitative.

4. Qëllimi i kërkimit shkencor

Qëllimi i kërkimit shkencor është që të arrihen rezultatet dhe përfundimet, me të cilat zbulohen apo verifikohen ligjshmëritë, rregullat, ndonjë teori, ligj, sistem, ose analizë teorike, praktike dhe empirike e një problemi të panjohur, apo pak të njohur më parë.

Si qëllim kryesor ka ofrimin e një sistemi dijesh dhe njohurish, duke vëzhguar e studiuar botën reale dhe jetën, duke bërë përgjithësime teorike (për një fushë apo degë të caktuar), apo edhe shpjegimin, parashikimin dhe kontrollimin e dukurive, fenomeneve etj.

Pra, qëllimet e kërkimit shkencor mund të jenë: analiza e problemeve dhe njohurive ekzistuese, ndërtimi ose krijimi i proceduarave të reja për gjetjen e zgjidhjeve për këto probleme dhe me këtë edhe shtimi i njohurive të reja.

Zakonisht, qëllimi shkruhet me një fjali.

Shembull:

Tema: *Ndikimi i emisioneve televizive në edukimin moral të fëmijëve.*

Qëllimi i temës: Të konstatohet cili është ndikimi i emisioneve televizive në edukimin moral të fëmijëve.

5. Arsyeshmëria e kërkimit shkencor

Kërkimi shkencor e ka si qëllim kryesor ofrimin e njohurive, duke vëzhguar, kontrolluar dhe analizuar botën reale (në një fushë në të cilën është fokusuar studimi dhe mbi bazën e të dhënave empirike të bëjë shpjegimin e rezultateve të kërkimit).

Bëhet duke identifikuar dobinë e kërkimit dhe duke dhënë së paku tri arsye kryesore:

- Personale (ambiciet personale për titull);
- Profesionale (nevojat tuaja për ngritje në karrierë);
- Shkencore (teorike ose praktike).

6. Vlefshmëria e kërkimit shkencor

Një kërkim shkencor është i vlefshëm atëherë kur rezultatet e tij bazohen në fakte dhe kur ato janë logjike dhe të vërteta.

Vlefshmëria e kërkimit shkencor përfshin dy koncepte: vlefshmërinë e brendshme dhe vlefshmërinë e jashtme.

- Vlefshmëria e brendshme është përmasa në të cilën përfundimet e kërkimit mund të interpretohen në mënyrë të saktë dhe të besueshme (nëse ai mat atë që ka dëshiruar të masë, nëse përfundimet e tij janë rezultat i atyre faktorëve që kanë qenë objekt i kërkimit dhe jo rezultat i faktorëve të tjerë që nuk kanë të bëjnë në mënyrë sistematike me kërkimin);
- Vlefshmëria e jashtme është përmasa në të cilën përfundimet e kërkimit mund të përgjithësohen në popullatë, situata apo kushte reale përtej studimit.

Për kërkuesin një kërkim është i vlefshëm kur vlerësohet se është arritur qëllimi i dëshiruar, si rezultat i planifikuar i një kërkimi të realizuar.

Mund të themi se vlefshmëria e një kërkimi ka të bëjë me interpretimin e saktë të rezultateve (vlefshmëria e brendshme) dhe me përgjithësimin e rezultateve (vlefshmëria e jashtme)⁴.

Në literaturë flitet edhe për vlefshmërinë e hipotezës, metodave, teknikave, instrumenteve dhe pyetjeve të kërkimit.

7. Besueshmëria e kërkimit shkencor

Besueshmëria është përmasa në të cilën përfundimet e kërkimit shkencor janë të qëndrueshme sa herë që ai të përsëritet, si dhe përmasa në të cilën një studim mund të replikohet (mund të përsëritet nga studiues të tjerë). “Besueshmëria e një kërkimi ka të bëjë me pandryshueshmërinë e metodave, kushteve dhe rezultateve të kërkimit, si dhe me shkallën (masën) e origjinalitetit të kërkimit”⁵.

Besueshmëria e kërkimit shkencor përfshin dy koncepte: besueshmërinë e brendshme dhe besueshmërinë e jashtme.

⁴ Dr. Maksim Shimani. “Natyra, klasifikimi dhe karakteristikat e kërkimit shkencor në arsim”, “Revista pedagogjike”, nr. 1, 1999, f. 11.

⁵ Po aty f. 11.

- Besueshmëria e brendshme është përmasa në të cilën përfundimet e një kërkimi janë të qëndrueshme, në rast se ky kërkim përsëritet nga i njëjti studiues në kushte të njëjta.

Shembull:

Nëse tema *Ndikimi i emisioneve televizive në edukimin moral të fëmijëve* do të organizohej në një popullatë të caktuar nga ndonjë hulumtues e do të jepte rezultatet e caktuara dhe nëse e njëjta problematikë do të hulumtohej nga i njëjti hulumtues në popullatën e njëjtë, do të duhet të dilnin rezultatet e njëjta.

- Besueshmëria e jashtme shkencore është përmasa në të cilën përfundimet e një kërkimi janë të qëndrueshme, nëse ky kërkim do mund të përsëritet nga studiues të tjerë.

Shembull:

Nëse tema *Ndikimi i emisioneve televizive në edukimin moral të fëmijëve* do të organizohej në një popullatë të caktuar nga ndonjë hulumtues, pastaj për të njëjtën temë në popullatën e njëjtë është organizuar një kërkim nga ndonjë hulumtues tjetër dhe rezultatet janë të njëjta, atëherë mund të flasim për besueshmërinë e jashtme.

8. Praktikimi i kërkimit shkencor

Praktikimi lidhet me gatishmërinë, parapërgatitjet, burimet e domosdoshme dhe kohën, në kuptimin që kërkimi të jetë i mundshëm për realizim.

Gatishmëria e kërkuesit:

Kërkimi është një proces, i cili, përveçse kërkon njohuri profesionale, kërkon vendosmëri dhe gatishmëri nga ana e kërkuesit.

Gatishmëria në aspektin e kërkimit mund të përkufizohet si një kombinim i “të qenit gati” dhe mobilizimit të individit. Gatishmëria lidhet me “të qenit gati” për të hulumtuar. Çdo hulumtues e di paraprakisht kur është i gatshëm dhe i mobilizuar për të kryer një kërkim.

Kur kërkuesi dëshiron të bëjë një kërkim, zakonisht i duhet të bëjë një parapërgatitje.

Parapërgatitja e mirë gjithmonë ndihmon në fillimin e mbarë të një kërkimi:

- A jeni të përgatitur të angazhoheni në realizimin e kërkimit?
- Në çfarë mase jeni të gatshëm ta bëni këtë?

- A i keni njohuritë, shkathtësitë dhe aftësitë për një punë të tillë?
- A jeni të vendosur ta çoni deri në fund kërkimin, pavarësisht vështirësive dhe sfidave që ju dalin?
- A doni ta bëni, a e keni motivimin e duhur, vendosmërinë dhe përkushtimin për punë?

E gjithë kjo gatishmëri duhet të fokusohet në një problem hulumtues, ndërsa kërkuesi duhet ta gjejë një përshtatje ndërmjet aftësive dhe interesave.

9. Burimet e domosdoshme për kërkim

Për realizimin e kërkimit normalisht kërkohen mjetet e punës:

kompjuteri, letra, vetura, nëse ju duhet të dilni në terren për t'i marrë të dhënat.

10. Koha e nevojshme për kërkim

Kërkimi është aktivitet specifik, i ndryshëm nga të tjerët për nga qëllimi. Kërkimet në fushën e edukimit, sidomos ato empirike, janë të kufizuara në kohë. Ndonëse kërkimi para së gjithash është aktivitet vërtet intelektual, në realizimin e tij rol shumë të madh ka komponenti kohë, sidomos me rastin e zbatimit të metodës së eksperimentit dhe vëzhgimit me pjesëmarrje.

Andaj, mund të themi se, pavarësisht që objekti i kërkimit duhet të vërehet drejtpërsëdrejti, më e nevojshme është koha për realizimin e kërkimit, sidomos në rastet kur vetë dukuria që hulumtohet nuk është e përsëritshme.

11. Llojet e kërkimeve shkencore

Varësisht nga qëllimi i kërkuesit dhe i kërkimit, mund të ekzistojnë lloje të ndryshme të kërkimeve në edukim. Më kryesoret janë tri:

- Kërkimi formulativ (qëllimi i të cilit është njohja më e mirë nga afër e dukurisë që hulumtohet);
- Kërkimi deskriptiv (ka të bëjë me përshkrimin e dukurive në proces) përdoret kur dëshirojmë të fitohet një matje e saktë e çështjeve, duke i përshkruar ato;

- Kërkimi kauzal, apo shkakor (i cili ka të bëjë me zbulimin e lidhjeve shkak-pasojë, pra duke analizuar të dhënat për të shpjeguar pse dhe si ndodh diçka), përdoret kur dëshirojmë të gjejmë shkakun dhe pasojat, p.sh. notat shkollore dhe vetëbesimin e nxënësit.

Në literaturë hasim ndarje të ndryshme, nga autorë të ndryshëm, për kërkimet në edukim.

Një nga pikënisjet më të thjeshta për t'i ndarë llojet e kërkimeve në edukim është kjo:

1. Kërkimet shkencore sipas qëllimit të kërkimit;
2. Kërkimet shkencore sipas orientimit ndaj fenomeneve që studiohen;
3. Kërkimet shkencore sipas metodave hulumtuese;
4. Kërkimet shkencore sipas asaj se çfarë dëshirojmë të arrijmë;
5. Kërkimet shkencore sipas numrit të hulumtuesve që i realizojnë këto kërkime etj.

11.1. Kërkimet shkencore sipas qëllimit të kërkimit

Kërkimet shkencore sipas qëllimit janë:

11.1.1. Kërkimi shkencor themelor (fundamental)

Qëllimi kryesor i këtij lloji të kërkimit shkencor është zgjerimi i dijeve rreth një fenomeni (dukurie), nga cilido aspekt i disiplinës. Ai mund të jetë një enigmë teorike ose të ketë bazë empirike. Puna e kërkuesit është të ekzaminojë cila teori është më e përshtatshme, të zhvillojë teori dhe koncepte të reja (nëse ka nevojë), të shtyjë kufijtë e dijes, me shpresë se diçka e vlefshme do të zbulohet. Ky lloj i kërkimit zakonisht bëhet kur kërkuesi dëshiron informacion shtesë ose informacion të ri për natyrën e përgjithshme të problemit.

11.1.2. Kërkimi shkencor provues

Qëllimi këtij lloji kërkimi shkencor është të gjejë kufijtë e përgjithësimeve të mëparshme nga një ose disa kërkime. Ky lloj kërkimi ju mundëson të

punoni brenda një kornize të paracaktuar paraprakisht, në kushte që ju japin mundësi të vlerësoni (provoni) shumicën e ideve, argumenteve dhe përgjithësimeve që janë dhënë në kërkimet e mëhershme.

11.1.3. Kërkimi shkencor i zbatuar (i aplikuar)

Qëllimi kryesor i këtij lloji të kërkimit shkencor është të zgjidhë një problem praktik. Zakonisht nis nga një problem i veçantë, nga realiteti, ndërsa mbështetjen e ka në punët teorike ose në punët eksperimentale, të cilat kryhen për të arritur njohuri të reja, si dhe për orientim e kanë zgjidhjen e ndonjë detyre konkrete, përkatësisht zgjidhjen e objektivit praktik që mund të ndihmojë në zgjidhjen e tij.

11.2. Kërkimet shkencore sipas orientimit ndaj fenomeneve që studiohen

Ekzistojnë këto lloje të kërkimeve shkencore sipas orientimit të fenomeneve që studiohen:

11.2.1. Kërkimet e orientuara

Këto kërkime i kanë të përcaktuara kahet, synimet, caqet në fushën e zgjedhur e të kornizuar dhe shërbejnë si bazë për implementim në praktikë.

11.2.2. Kërkimet e paorientuara

Janë të natyrës së lirë, nuk janë të kornizuara dhe objekti hulumtues përcaktohet nga vetë interesi i kërkuesit, për të gjurmuar një dukuri në natyrë apo në shoqëri, pa ndonjë tendencë të posaçme për zbatim në praktikë.

11.3. Kërkimet shkencore sipas metodave hulumtuese

Kemi këto lloje të kërkimeve shkencore në bazë të metodave që i përdorim:

11.3.1. Kërkimi eksperimental

Është punë shkencore kërkimore, i cili mbështetjen e ka në metodën eksperimentale, të matshme, me të cilën mund të sublimohen rezultatet me saktësi.

Në kërkimet shkencore eksperimentale të paktën një variabël, zakonisht variabli eksperimental, manipulohet ose ndryshohet me qëllim nga studiuesi, për të përcaktuar efektet e këtij manipulimi/ndryshimi.

11.3.2. Kërkimi thuajse-eksperimental

Ky lloj i kërkimit shkencor, për dallim nga kërkimi eksperimental, pjesëmarrësit nuk i zgjedh në mënyrë të rastësishme, por ata janë grupe të formuara në mënyrë natyrore, si p.sh klasa etj.

11.3.3. Kërkimi jo-eksperimental

Në kërkimet shkencore jo-eksperimentale nuk kemi manipulim të variablave eksperimentale, por ato studiohen ashtu siç janë në situatë natyrore. Në këto kërkime mund të matim vetëm ndonjë ndikim, lidhje, apo veprim të ndonjë variable në ndonjë variabël tjetër, pa bërë asnjë ndikim në variabla.

Shembull: *Ndikimi i vetëbesimit në suksesin e nxënësve.* Nuk bëjmë asnjë ndërhyrje, por e vlerësojmë vetëbesimin, pastaj edhe suksesin, dhe nxjerrim një përfundim lidhur me ndikimin e vetëbesimit në suksesin e nxënësve.

11.3.4. Kërkimi historik

Ky lloj i kërkimeve shkencore merret me një përshkrim të fakteve dhe ndodhive të së shkuarës historike dhe jep ose mundohet të japë vlerësim, gjykim se pse ka ndodhur.

11.3.5. Kërkimi etnografik

Në këtë lloj të kërkimit shkencor përshkruhen tërësisht, në thellësi, fenomenet aktuale (p.sh. përshkrimi shkencor i sistemit arsimor në Kosovë etj).

11.4. Kërkimet shkencore sipas asaj se çfarë dëshirojmë të arrijmë

Kemi këto lloje të kërkimeve shkencore:

11.4.1. Kërkimi monitorues

Zakonisht bëhet në bazë të indikatorëve të paraparë më herët. Për shembull për të vlerësuar si shkojnë përpara projektet (zbatimi i kurrikulës së re).

Gjithsesi ka vështirësi në identifikimin e indikatorëve, prandaj në këso llojesh të kërkimeve bëhet një kontroll i vazhdueshëm i implementimit të ndonjë risie në arsim.

11.4.2. Kërkimi kontekstual

Konsiderohet kur qëllimi është ndryshimi i situatës ekzistuese, në kontekstin e caktuar vendor.

11.4.3. Kërkimi zhvillimor

Qëllimi kryesor i tij është që situata të ndryshojë, të lëvizë përpara për të mirë, për t'u përmirësuar gjërat ekzistuese në elemente dhe përmbajtje të reja dhe aktuale.

11.4.4. Kërkimi korrelacional

Qëllimi kryesor i tij është zbulimi i marrëdhënieve në mes të dukurive, nëse një dukuri është e lidhur dhe ka marrëdhënie me një dukuri tjetër. Në këto kërkime bëhet matja e marrëdhënies së një variable me një tjetër, si dhe forca e kësaj marrëdhënie që ekziston.

Shembull: Cili është ndikimi i gjinisë në vetëbesimin e nxënësve të shkollës fillore.

11.5. Kërkimet shkencore sipas numrit të hulumtuesve

Kemi këto lloje të kërkimeve shkencore:

11.5.1. Kërkimet individuale

Këto kërkime shkencore kryhen nga individët, varësisht nga qëllimi, aftësitë, afiniteti dhe përkushtimi i tyre. Kërkimet shkencore me një individ kryesisht kryhen për qëllime profesionale personale, p.sh. tema e diplomës së studimeve themelore, tema e masterit etj.

11.5.2. Kërkimet kolektive (ekipore, në grupe, të përbashkëta)

Kryhen nga ekipe të zgjedhura, të organizuara, të cilat e kanë bartësin kryesor, i cili është përgjegjës për mbarëvajtjen e realizimit të programit

kërkimor. Këto kërkime kryesisht bëhen kur është në pyetje ndonjë projekt që kërkon punë dhe angazhim të madh, e që ka nevojë edhe për njerëz të fushave të ndryshme, por nuk përjashtohen edhe punimet jo të vëllimshme, por në të cilat marrin pjesë më tepër se dy persona.

II. METODAT E KËRKIMIT SHKENCOR

Metoda është mënyrë e kërkimit, e planifikuar, përkatësisht mënyra e punës për realizimin e kërkimit, struktura e së cilës është e vërtetuar shkencërisht dhe vlera e saj është e verifikuar.

Termi metodë zbatohet në dy kuptime:

Sipas kuptimit të parë, e ka domethënien e modelit të gatshëm, të procedurës, të skenës, të renditjes, sipas së cilës zhvillohet një veprimtari praktike, hulumtuese.

Sipas kuptimit të dytë, metodë do të thotë qasje e kuptimit të zbatuar, me qëllim që sa më lehtë dhe sa më saktë të zbulohen dhe të përpunohen sistematikisht faktet shkencore, të dhënat dhe informacionet (metodat shkencore).

Metodat në shkencë e kanë domethënien e mënyrës së kërkimeve, të cilat shkenca i shfrytëzon, me qëllim të kërkimit në fusha të caktuara shkencore, me të cilat sigurohen dhe vilen dituritë e sigurta, të rregulluara, të sistemuara dhe të sakta. Njohuria shkencore, para së gjithash, fitohet përmes kërkimit shkencor, duke i zbatuar metodat përkatëse shkencore.

Metoda e kërkimit shkencor është sistem kompleks i rregullave logjike, nëpërmjet së cilave arrihen njohuri shkencore, andaj për këtë arsye është e rëndësishme të kemi:

- 1) Njohuri të mjaftueshme për metodën;
- 2) Aftësi për zbatimin, gjegjësisht procedurën, e cila mundëson përdorimin e saj në kërkime.

Si metoda shkencore të kërkimit, metodat hulumtuese janë të definuara edhe sa u përket procedurave të zbatimit në praktikë. Megjithatë, ato nuk është e domosdoshme që në të njëjtën mënyrë të zbatohen në çdo proces të kërkimit shkencor, mirëpo sipas rregullit asnjëra nga to nuk mund të shmanget në kërkimet shkencore.

Përcaktimi i metodave hulumtuese:

Kur i përcaktojmë metodat e kërkimit në edukim, duhet të kemi parasysh që ato, gjithashtu, duhet t'u përgjigjen (përshtaten) karakteristikave të objektit të kërkimit që hulumtohet.

Në kuptimin e **qasjes së kërkimit** dallojmë metodat sasiore dhe ato cilësore. Metodat sasiore karakterizohen nga të shprehurit e rezultateve të kërkua në sasi, në numra, të cilat përpunohen nga ana statistikore.

Metodat cilësore janë metoda përmes së cilave synohet studimi i përvojave jetësore të njerëzve në vendndodhjen e tyre natyrore. “Me anë të kësaj metode studiuesit synojnë t’i kuptojnë njerëzit në mjediset e tyre sociale, ashtu siç shfaqen me të gjitha ngjyrat dhe përvojave të tyre”⁶.

Metodat shkencore që i përdorim gjatë kërkimeve shkencore në edukim janë: metoda eksperimentale, **metoda e analizës së dokumentacionit, metoda përshkruese, metoda krahasuese (komparative), metoda historike, metoda statistikore, metoda e grupit të përqendruar (fokus-grupi) dhe metoda e vrojtimit-vëzhgimit.**

1. Metoda eksperimentale

Metoda eksperimentale është metodë e kërkimit, ku studimi bëhet në kushte eksperimentale, me çka arrihet saktësi dhe mundësitë janë të favorshme, ngase i njëjti akt mund të përsëritet disa herë, deri në konfirmimin preciz të punës shkencore kërkimore. Çdo eksperiment udhëhiqet nga një hipotezë, e cila është parashikim i bashkëveprimeve të mundshme ndërmjet ndryshoreve të pavarura dhe të varura. Gjatë realizimit të një eksperimenti, kërkuesi është me rëndësi të njohë ndryshoren e varur dhe të pavarur, si dhe ndryshoren hetuese.

“Qëllimi i zbatimit të eksperimentit janë studimi dhe kërkimi sistematik i shkaqeve dhe i pasojave të caktuara pedagogjike, arsimore, sociale e psikologjike në shkollë, të cilat determinojnë jetën në të”⁷.

Në rast të aplikimit të metodës eksperimentale për realizimin e kërkimit formohen dy grupe: grupi eksperimental dhe grupi i kontrollit. “Në grupin eksperimental bëjnë pjesë subjektet që eksperimentohen për faktorin e pavarur, ndërsa në grupin e kontrollit bëjnë pjesë subjektet që nuk eksperimentohen për faktorin e pavarur”⁸. I vetmi ndryshim në mes të dy

⁶ Lekë Sokoli, Metodat e kërkimit në shkencat sociale, f. 51

⁷ Murati, 2004, f. 239.

⁸ Terry F. Pettijohn. (1996). Psikologjia, Një hyrje koncize (botimi i dytë), “Lilo”, Tiranë, f. 25.

grupeve është prania ose mungesa e faktorit (eksperimental) të pavarur. Ata trajtohen në mënyrë identike për të gjitha gjërat e tjera. Faktori i varur matet në mënyrë saktësisht të njëjtë në të dy grupet.

Shembull:

Nëse dëshirojmë të dimë efektin e Abetares së re në raport me Abetaren e vjetër, atëherë në një klasë me nxënës mësojmë me Abetaren e re, ndërsa tjetrën me Abetaren e vjetër, duhet pasur parasysh se nxënësit e të dy grupeve duhet të kenë karakteristika të përafërta.

Çdo eksperiment kalon nëpër tri faza:

- Në fazën e parë maten treguesit e ndryshores së varur;
- Gjatë fazës së dytë ndryshorja e varur vihet nën ndikimin e ndryshores së pavarur;
- Në fazën e tretë maten përsëri treguesit e ndryshores së varur për të parë nëse treguesit kanë ndryshuar dhe si kanë ndryshuar.

2. Metoda e analizës së dokumentacionit

Një nga metodat për mbledhjen e të dhënave është metoda e analizës (përmbajtjes) së dokumenteve.

Kërkuesi zgjidhjen e ndonjë detyre të parashtruar shkencore e fillon me grumbullimin e dokumentacionit mbi të dhënat dhe rezultatet tashmë ekzistuese, që kanë të bëjnë me problemin e tij. Qëllimi i qasjes së këtillë është i dyfishtë. Së pari, kërkuesi e ka mundësinë që t'i aplikojë përvojat e deritashme nga ajo fushë në projektin e ri hulumtues. Së dyti, nuk ka nevojë që të merret me diçka që tashmë qëmoti është hulumtuar dhe është e njohur. Dokumentacioni, në kuptimin e gjerë të fjalës, nënkupton punimet monografike, pasqyrimet e ndryshme sintetike, të dhënat e pasistematizuara, librat, tekstet mësimore, vjetarët, gazetatat javore, gazetatat ditore etj.

Ato përmbajnë lloje të ndryshme të të dhënave numerike, informacione politike, arsimore, kulturore, zyrtare, institucionale dhe personale (ditarë, procesverbale, kronika, filma, fotografi, audio, video etj.). Kjo metodë i ka instrumentet e veta (mostrën, kodeksin, tabelat etj.).

Në këto raste duhet të merren gjithmonë parasysh konteksti dhe autenticiteti, sidomos nëse përdoren dokumente nga interneti.

3. Metoda përshkruese

Kjo metodë zbatohet në kërkime të ndryshme, në përshkrimin analitik të dukurive të ndryshme, ashtu siç janë, paraqiten dhe zhvillohen në realitet. Përshkrimi duhet të jetë i detajuar, i plotë dhe gjithëpërfshirës. Përshkrimi shkencor duhet të ketë vlerë, e jo vetëm të jetë përshkrim, ngase funksioni i tij është të zbulojë shkaqet dhe pasojat e dukurive, në mënyrë që në bazë të rezultateve të nxirren konkluzione, fakte, teori etj.

Nëpërmjet zbatimit të (metodës) ecurisë përshkruese me modalitetet e saj (analiza, krahasimi dhe gjeneralisimi) spikaten veçantitë specifike, të cilat e karakterizojnë problematikën që e kemi për objekt të studimit.

Në pikëpamje të zbatimit kjo metodë zë një vend të rëndësishëm dhe është pjesë përbërëse e veprimtarisë së përditshme në procesin e organizimit të punës mësimore.

4. Metoda krahasuese (komparative)

Kjo metodë përdoret për konstatimin e ngjashmërisë dhe ndryshimit në mes të dukurive të ndryshme. Metoda komparative paraqet procedurë të krahasimit të faktorëve, të dukurive, të proceseve të njëjta, ose tepër të ngjashme, për t'i identifikuar ngjashmëritë ndërmjet tyre, si dhe dallimet.

Metoda e krahasimit ka rëndësi në procesin e të njohurit dhe zbulimit të vetive të dukurive të ndryshme, por ajo po ashtu e ka edhe vlerën e vet praktike, sepse, duke krahasuar dukuritë e ndryshme, institucionet e ndryshme, dhe duke zbuluar vetitë dhe anët e njëjta të dukurive të tjera që kanë të njëjtat veti, konstatohet ngjashmëria dhe ndryshimi ndërmjet tyre.

Krahasimi bëhet me veprime të njëpasnjëshme dhe së pari vërtetohen veçoritë e përbashkëta, madje të gjitha veçoritë dalluese, me të cilat vjen në shprehje dallimi ndërmjet tyre. Krahasimi mund të bëhet edhe kur është fjala për më shumë se dy dukuri.

Në kahun e shqyrtimeve të ngjashmërive dhe të elementeve të njëjta veçohen:

- Identifikimi i veçorive të caktuara, të përbashkëta ose të ngjashme, të sendeve dhe të dukurive të njohura më herët, si dhe të sendeve dhe dukurive të reja, të cilat hulumtohen;

- Shtuarja e hipotezave themelore se sendi i ri ose dukuria e re ka veti të njëjta ose të ngjashme strukturore, formë, lidhje, procese, përkatësisht edhe sjellje;
- Vërtetësinë e hipotezave themelore të shtruara dhe të karakteristikave të një fushe të sendeve dhe të dukurive të reja;
- Krahasimi sistematik dhe sa më i plotë i dukurive dhe sendeve të njohura më herët dhe të dukurive dhe të sendeve të njohura rishtazi;
- Klasifikimi i dukurisë së re ose i llojit të ri të dukurive në sistemin e dukurive të gjera.

Shembull i një studimi, ku është e domosdoshme aplikimi i metodës krahasuese: *Krahasimi i mësimdhënies tradicionale dhe ndërvepruese*. Metoda në fjalë na mëson që të veçojmë ato karakteristika që i dallojnë këto dy qasje të mësimdhënies.

5. Metoda historike

Metoda historike dukuritë edukativo-arsimore i studion në zhvillimin e tyre historik, ashtu sikurse janë të shfaqura njëra prej tjetrës dhe të lidhura në mes veti. Metoda historike përfshin analiza, zbardhje të fazave të zhvillimit, nëpër periudha kohore të niveleve zhvillimore, si dhe përcakton dhe identifikon ngjarjet, për të qenë në gjendje të jepen përgjigjeve në pyetjet: Kur? Ku? Si? Pse? Në çfarë rrethanash janë shënuar ndodhitë? Cili është shkaku dhe pasoja e tyre?

Njohja e gjendjes së sistemit të drejtësisë, sistemit arsimor, institucioneve financiare në të kaluarën dhe specifikat historike të vendeve në veçanti, po ashtu të historisë në tërësi, kanë treguar se në rrafshin historik sillen rezultate pozitive shkencore.

Kjo metodë shkencore e ka vlerën e vet, meqë e bën të mundshëm interpretimin tërësor historik të zhvillimit të dukurive të ndryshme, nëpër periudha të ndryshme kohore, të mbështetura në dokumente dhe në materiale të verifikuara, prandaj për këtë arsye vjen në shprehje saktësia sa më e madhe për përshkrimin dhe analizën e ngjarjeve që kanë ndodhur.

E metë e kësaj metode është se në shumë raste nuk ekzistojnë materiale relevante, për shkak të mungesës së burimeve faktike për sistemin e arsimit në Kosovë.

Shembull i një punimi që hyn në punë metoda historike:

Kontributi i Gjerasim Qiriazit në themelimin e shkollës shqipe.

6. Metoda statistikore

Metoda statistikore është metodë që aplikohet kur kemi të bëjmë me kuantifikimin e rezultateve. Do të thotë se në bazë të një numri të caktuar të elementeve të ndonjë bashkësie vihet deri te konkluzioni i përgjithshëm për vlerat mesatare, për deviacionet në masë apo bashkësi të dukurive.

Metoda statistikore zë vend të rëndësishëm, sepse përmes saj shprehen statistikisht rezultatet e nxjerra nga kërkimi. Roli i metodës statistikore nuk qëndron vetëm në faktin e të përshkruarit të ngjarjeve, të dukurive dhe të sendeve, por me ndihmën e saj shpjegohen raportet shkak-pasojë të dukurive që shqyrtohen.

Kjo metodë e bën të mundur nxjerrjen e treguesve relevantë në kërkim, shprehjen e të dhënave në mënyrë tabelare, në mënyrë grafike, pastaj kuantifikimin dhe në shprehjen e vlerave.

Metoda statistikore i ka edhe mangësitë e veta, të cilat lidhen më së shumti me konkluzionet për të përcaktuar një dukuri, zakonisht janë të shprehura me numra dhe ato ndikohen shumë nga përzgjedhja e mostrës së kërkimit.

Me gjithë këto mangësi dhe vështirësi, metoda statistikore paraqet metodën më bazike në punën shkencore kërkimore.

Metoda statistikore aplikohet pothuajse në të gjitha kërkimet, pasi që në rezultate kryesisht prezantohen përqindje. P.sh. rreth 25 % e të anketuarve shprehen se puna me nxënës u jep shumë stres, ose mesatarja për femra është 2.86, ndërsa për meshkuj 2.65.

7. Metoda e grupit të përqendruar (fokus-grupit)

Grupi i përqendruar (fokus-grupi) bën pjesë në qasjet kualitative të metodave hulumtuese. Grupet e fokusit në kërkimin shkencor realizohen përmes diskutimeve në fokus-grupe, të cilat kanë për qëllim mbledhjen e

informacionit për pikëpamjet dhe përvojat e tyre në lidhje me temën specifike të kërkimit. Metoda e fokus-grupit është veçanërisht e dobishme për të mbledhur pikëpamjet e ndryshme (në perspektivë), në të njëjtën temë. Në burime të ndryshme hasim sugjerime për numër të ndryshëm të pjesëmarrësve në grupin e përqendruar: 6-12, 8-12, 10-12. Sa i përket kohës, sugjerohet që një sesion të zgjatë 1.5 - 2 orë⁹.

Gjatë zbatimit të metodës së grupit të përqendruar, kërkuesi duhet të ketë njohuri për procedurat që duhet ndjekur gjatë realizimit të kësaj metode, siç janë:

- Përgatitja e çështjeve për diskutim;
- Përgatitja e planit për sesion;
- Përzgjedhja e pjesëmarrësve në grupin e përqendruar;
- Përgatitja teknike për sesion.

Dallimi ndërmjet bashkëbisedimit në intervistë dhe bashkëbisedimit në fokus-grupe është se derisa në rastin e parë bëhet bashkëbisedim i qëllimshëm me secilin të intervistuar, në rastin e dytë bëhet një bashkëbisedim në grup.

Bashkëbisedimi me fokus-grupe bëhet në një grup prej 5 deri në 15 persona, të cilët kanë njohuri për temën ose punojnë në atë fushë dhe modelohet gjatë gjithë kohës nga kërkuesi.

Në kërkimet në fushën e edukimit diskutimi zgjat një deri dy orë mbi një temë të vetme dhe zakonisht preferohet vetëm me të rritur dhe jo me të vegjël. Në kërkimet në fushën e edukimit fokus-grupi mund të përdoret si metodë e vetme, ose bashkë me ndonjë metodë tjetër.

Roli i kërkuesit në fokus-grupe është shumë i rëndësishëm, sidomos që:

- Diskutimi të përqendrohet në temë;
- Hulumtuesi t'i krijojë mundësi secilit individualisht ose në grup të shfaqë mendimin e vet.
- Të nxisë ndërveprimin brenda grupit;
- Të përdorë udhëzuesin tematik, i cili përmban pyetjet që duhet t'i paraqesë kërkuesi, në mënyrë që temat të trajtohen në secilin grup.

⁹ Focus Group Fundamentals, [www. extension.iastate.edu/publications/pm1969_b.pdf](http://www.extension.iastate.edu/publications/pm1969_b.pdf) (20.07.2010)

Mbledhja e të dhënave përmes kësaj metode mund të bëhet duke regjistruar me zë (audio) ose duke shënuar në ‘flipçartë’.

Mos harroni se analiza e të dhënave nga fokus-grupet bëhet sipas qasjes analitike induktive.

Shembull:

Tema *Mësimdhënia Tradicionale dhe Mësimdhënia Ndërvepruese*. Formohet grupi nga mësimdhënësit që i zbatojnë të dyja qasjet e mësimdhënies, pastaj diskutohet për çështje që kanë të bëjnë me mësimdhënien.

8. Metoda e vrojtimit - vëzhgimit¹⁰

Është e ditur tashmë se njohja e realitetit fillon me anë të vrojtimit dhe vëzhgimit, i cili është një proces i natyrshëm i përcjelljes së individëve gjatë një aktiviteti të caktuar, apo ngjarjeve dhe situatave të ndryshme, që bën të mundshme të mblidhen fakte përkitazi me atë që e studiohet.

Vrojtimi i thjeshtë është metodë sasiore. Përmes vrojtimit të thjeshtë kërkuesi (hulumtuesi) përcakton:

- Sa njerëz duhet të vrojtohen, një apo një grup;
- Sa duhet të zgjasë vrojtimi;
- Çfarë do të vrojtojë;
- Si do t’i regjistrohen të dhënat;
- Si do të bëhet analiza e të dhënave nga vrojtimi.

Të dhënat vrojtuese mund të përdoren në hulumtimet cilësore nëse janë përshkruar dhe interpretuar ato.

Vrojtimi paraqet supozimin e rëndësishëm dhe themeltar për kërkime dhe njohuri objektive. Nëpërmjet metodës së vrojtimit shkencor arrihet deri te faktet e reja shkencore, por edhe të vërtetimit të hipotezave ekzistuese. Megjithatë, vrojtimi shkencor dallon nga i përditshmi, pasi që në vrojtimin shkencor duhet t’i përmbahemi disa parimeve:

¹⁰ Metoda e vëzhgimit dhe metoda e grupit të përqendruar janë edhe teknika për mbledhjen e fakteve.

- Qëllimi i vrojtimit duhet të jetë i caktuar qysh në fillim, i zgjedhur mirë dhe i përcaktuar me precizitet, dhe jo të ndikojnë në situatat e ndryshme në rrjedhën e kërkimit;
- Vrojtimi duhet të bëhet me plan, pra duhet të jetë paraprakisht i organizuar dhe i planifikuar për të gjitha detajet themelore;
- Çdo gjë që vërehet dhe ka rëndësi për kërkimin duhet të shënohet dhe duhet të jetë preciz, me qëllim që kuantifikimet të jenë bazë solide për rezultatet e kërkimeve;
- Vrojtimi duhet të jetë sa më objektiv, pa përzjerje në ndonjë dozë të dukshme të subjektivizmit;
- Vrojtimi duhet të jetë i kontrolluar.

Dallimi i vëzhgimit që përdoret në studimet cilësore nga ai që përdoret në studimet sasiore është se gjatë vëzhgimit në studimet cilësore nuk ka nevojë të kemi listë kontrolli, por të shkruhet kur reagon subjekti dhe si reagon.

Në studimet cilësore vlefshmëria e vëzhgimit është më e ulët, ndërsa besueshmëria është shumë e lartë.

Mangësitë e kësaj metode shfaqen në faktin se dukuritë nuk mund të vëzhgohen në mënyrë retrospektive.

8.1. Llojet e vëzhgimit - vrojtimit

Gjatë hulumtimeve mund të përdoren këto lloje të vëzhgimit-vrojtimit:

- Vëzhgimi - vrojtimi i drejtpërdrejtë dhe jo i drejtpërdrejtë;
- Vëzhgimi - vrojtimi i pjesshëm dhe i përgjithshëm;
- Vëzhgimi- vrojtimi sistematik dhe josistematik;
- Vëzhgimi - vrojtimi pjesëmarrës dhe jopjesëmarrës.

9. Metoda demografike

Kjo metodë bën pjesë në grupin e metodave më të rëndësishme në shkencat shoqërore dhe si e tillë është shumë e nevojshme për njohjen dhe studimin e dukurive të ndryshme, pa të cilën nuk do të ishte i kompletuar studimi. Këto metodë kërkuesi e përdor zakonisht kur i mbledh të dhënat për popullin, si: moshën, gjininë, nivelin arsimor, vendbanimin etj. Natyrisht se këto të

dhëna statistikore për analizën sociologjike janë burime shkencore, të analizuara e të njohura nga të tjerët. Kjo metodë ka rëndësi të madhe për kërkime shkencore, pa përdorimin e së cilës nuk ka analizë të mirëfilltë shkencore.

Në kërkimet shkencore nuk mund të themi se njëra metodë është më e rëndësishme se tjetra, pasi që në kërkimet në fushën e edukimit zbatohen më shumë se një metodë shkencore dhe secila prej tyre e ka rëndësinë e saj. Sa më shumë metoda që përdoren në një kërkim shkencor, aq më shumë të dhëna shkencore mund të nxirren.

Shembull:

Nëse tema do të ishte *Ndikimi i faktorëve psiko-socialë në stresin e mësimit në shkollën nëntëvjeçare*, atëherë do të ishte e nevojshme që të aplikohen metoda demografike, krahasuese, statistikore, përshkruese, e fokus-grupit, por do të mund të organizohej edhe një eksperiment, ku përveç metodës eksperimentale do të zbatoheshin edhe metoda e vëzhgimit, krahasimit etj.

III. TEKNIKAT DHE INSTRUMENTET E KËRKIMIT SHKENCOR

Me ndihmën e teknikave dhe instrumenteve hulumtuese bëhet vjelja e informacioneve komplekse për ndriçimin dhe studimin e problemeve edukativo-arsimore. “Teknikat dhe instrumentet kërkimore paraqesin elementet dinamike në realizimin e një studimi. Ato sigurojnë rezultate dhe informacione valide, të cilat shërbejnë për trajtimin e aspekteve të ndryshme”¹¹.

Varësisht nga instrumentet matëse që përdoren gjatë kërkimit varet edhe cilësia e të dhënave shkencore, e në këtë kontekst edhe vetë kërkimi shkencor. Nëse instrumentet që përdoren gjatë kërkimit janë cilësore, atëherë kërkimi ka mbështetje të fortë, në të kundërtën nuk është bërë asgjë, përveçse është humbur kohë.

Meqenëse shpeshherë përdoren nocionet teknikë dhe instrument në kuptimin e njëjtë, e ndonjëherë edhe të ngatërruar, e shohim të udhës të sqarojmë se instrumentet janë formularët e përpiluar që përdoren për të nxjerrë informata, ndërsa teknikat janë punë praktike me këta formularë. P.sh., anketa është instrument, ndërsa procesi i anketimit është teknikë; intervista është instrument, ndërsa procesi i intervistimit teknikë; testi është instrument, ndërsa procesi i testimit është teknikë.

1. Instrumentet e kërkimit në fushën e edukimit

Një instrument është test ose mjet, përmes të cilit bëhet mbledhja e të dhënave të kërkimit.

Nëse në kërkimin tuaj do të përdorni një instrument tashmë të standardizuar, ju duhet të përshkruani përputhshmërinë e këtij instrumenti me studimin dhe popullatën tuaj, vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tij, dhe procesin e administrimit dhe të vlerësimit (pikëzimit) të tij.

Por, nëse jeni duke përdorur një instrument të ri, tuajin, ju duhet të përshkruani se si do të zhvillohet ky instrument, çfarë do të masë, si do të masë, si do të përcaktoni vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tij dhe si është i

¹¹ Murati, 2004, f. 255

lidhur ky instrument me hipotezën dhe mostrën e kërkimit tuaj? Nëse në projektin tuaj përcaktoheni që të përdorni më shumë se një instrument, atëherë secili prej tyre duhet të përshkruhet në mënyrë të detajuar, edhe pse duhet thënë që në këtë fazë mund të mos jeni në gjendje të bëni përshkrimin e detajuar të këtyre instrumenteve.

1.1. Llojet e instrumenteve

Përcaktimi i llojeve të instrumenteve të kërkimit në fushën e edukimit është i lehtë, pasi që instrumentet dhe teknikat e kanë një bazë, ngase nga instrumentet që përdoren përcaktohen teknikat e kërkimit.

1.1.1. Anketa

Anketa është një sistem pyetjesh të lidhura rreth një problematike, çështje ose dukurie të caktuar që na intereson, që ia shtrojmë një grupi të caktuar, të cilin paraprakisht e kemi zgjedhur që të përgjigjet.

Me anë të pyetësorit të anketës mblidhen të dhëna për subjektet, duke kërkuar prej tyre që të përgjigjen në disa pyetje.

Si instrument të saj e përdor pyetësorin anketues, të sistemuar në mënyrë strikte, me pyetje të formuluar më parë, të definuara qartë dhe me ofrimin e përgjigjeve që shërbejnë për mbledhjen e informatave, opinioneve, mendimeve etj.

Besueshmëria e informatave varet nga sinqeriteti i të anketuarve. Verifikimin e bën anketuesi, i cili është më aktiv në momentin e vendosjes së kontaktit me të verifikuarin, ndërsa më tutje ka rol pasiv.

Pyetësorët përmbajnë një varg pyetjesh të përpiluara sipas disa parimeve të caktuara:

- Pyetjet duhet të jenë të formuluar qartë dhe të jenë të kuptueshme për subjektin;
- Pyetjet duhet të jenë precize dhe të njëkuptimshme;
- Pyetjet nuk duhet të jenë sugjestive;
- Pyetjet nuk duhet të kërkojnë informata për jetën intime;
- Pyetjet duhet të bëhen për gjëra që janë të njohura për subjektet.

1.1.2. Intervista

Intervista është instrument kërkimor-shkencor që mundëson t'i mbledhim informacionet për të kaluarën, si dhe për përvojat dhe qëndrimet e tashme lidhur me çështjet dhe problemet e ndryshme.

Rëndësia e intervistës si instrument qëndron në shpejtësinë e mbledhjes së shënimeve të kërkuara, që është me rëndësi të veçantë për ato dukuri që ndryshon për një kohë të shpejtë, bie fjala reagimi i njerëzve në ndonjë çështje aktuale me rëndësi.

Për të realizuar një intervistë me një subjekt të caktuar mund të shfrytëzojmë pyetësorë të standardizuar dhe pyetësorë të hartuar nga vetë kërkuesi.

Protokolli i intervistës bëhet që pyetjet të jenë të strukturuar, që i ngjason pyetësorit.

Përzgjedhja e pyetjeve të përgjithshme dhe specifike.

Përzgjedhja e pyetjeve që hulumtuesi duhet t'i shënojë bëhet varësisht nga ajo se:

- Çka dëshiron të kuptojë;
- Qëllimi i intervistës;
- Informacioni thelbësor që dëshiron ta nxjerrë (ose që i intereson) nga intervista.

Pilotimi i protokollit të intervistës

Është me rëndësi të bëhet testimi i intervistës, sepse ndihmon të vlerësohen:

- Përmbajtjen e pyetjeve;
- Rrjedha e temave;
- Teknika e shtruarjes së pyetjeve;
- Kohëzgjatja e intervistës.

Disa këshilla rreth shtruarjes së pyetjeve gjatë intervistave:

- Mos shtroni pyetje që kërkojnë dy përgjigje;
- Mos i kombinoni pyetjet;
- Mos shtroni pyetje me disa opsione;

- Mos shtroni pyetje orientuese;
- Mos shtroni pyetje sugjестive.

Llojet e intervistave

- Intervista e lirë;
- Intervista e strukturuar;
- Intervista gjysmë e strukturuar.

1.1.3. Testi

Ndër instrumentet me të cilat kërkuesit mund të mbledhin të dhëna përkitazi me problemet, të cilat i hulumtojnë, është edhe testi.

Testi është një varg detyrash (pyetjesh) të zgjedhura paraprakisht nga kërkuesi, sipas parimeve të caktuara shkencore të shtruarjes së pyetjeve, të cilat na bëjnë të mundshme që në mënyrë objektive t'i studiojmë cilësitë e ndryshme personale të individit.

Gjatë përpilimit të instrumenteve për mbledhjen e të dhënave me test duhet:

- Të përkufizohet qëllimi i kërkimit;
- Të përcaktohet qasja që do të ndiqet gjatë kërkimit;
- Të hartohen pyetjet, varësisht sipas instrumentit të kërkimit;
- Të analizohen pyetjet e instrumentit;
- Të riformulohen ato nëse ka nevojë;
- Të përcaktohen pyetjet e përgjithshme dhe specifike.

Gjatë dizajnit të pyetësorit për kërkim janë me rëndësi:

- Identifikimi i kategorive të pyetjeve në kategori jo të lidhura me njëra-tjetrën, të cilat kanë të bëjnë me tematikën e kërkimit;
- Formulimi i saktë i pyetjeve: të qarta, të thjeshta dhe të pranueshme nga i anketuari;
- Pilotimi i pyetësorit, për të sqaruar (kuptuar) qartësinë e pyetjeve.

Fletëpyetësi i testit kërkon nga hulumtuesi që paraprakisht:

- Të përcaktojë pyetjet kryesore;
- Të hartojë draftin e pikave kryesore të pyetësorit;
- Të hartojë pyetësorin;

- Të organizojë pilotim-testimin e pyetësorit;
- Të zgjedhë teknikën e mbledhjes së të dhënave;
- Të dërgojë pyetësorin për plotësim;
- Të shqyrtojë të dhënat e analizës.

Përpilimi i një pyetësori të mirë mund të marrë kohë një javë. Gjatë përpilimit të fletëpyetësit me rëndësi është:

- Radhitja e kërkesave (pyetjeve);
- Njëra pyetje të mos shtrihet në dy faqe;
- T'i jepen udhëzimet respondentit;
- Të shënohen numrat e pyetjeve;
- Të radhitet pyetësori sipas paragrafëve;
- Të kufizohet gjatësia e pyetësorit, maksimumi në katër faqe (formati A4).

Testimi i fletëpyetësit

Pyetësorët e mirë paraprakisht testohen nga kërkuesi.

Shembull:

Një fletëpyetës mund të testohet në këtë ecuri veprimi nga kërkuesi:

- Ua ofroni atë 5-6 respondentëve, i lutni t'i plotësojnë, diskutoni për pyetjet: a ishte e qartë, a mundëson dhënien e përgjigjes, çka është lënë jashtë;
- Tregojuni kolegëve tuaj atë dhe shkruani - komentet, ngase pyetjet mund të jenë të qarta për ju, por mund të jenë të paqarta për respondentin;
- Bëni përmirësimet e duhura në pyetësor, bazuar në komentet e tyre.

Kërkesat e draft-fletëpyetësit

Varësisht nga ajo se çfarë kërkojmë të shpjegojmë, me ndihmën e fletëpyetësit bëhen edhe kërkesat, andaj po përmendim gjashtë tipa kërkesash, që zakonisht kërkohen në pyetësorët e ndryshëm:

- Kërkesat me alternativa të dhëna;
- Kërkesat me plotësim, njërën nga to;

- Kërkesat me shkallën për rangim;
- Kërkesat për përpilim të listës;
- Kërkesat me komente;
- Kërkesat e shkalles së Likert-it.

2. Teknikat e kërkimit në fushën e edukimit

Teknikat e kërkimit në fushën e edukimit dalin si rezultat i instrumenteve të kërkimit në këtë fushë, pasi që procedura e zbatimit për realizimin e punës në terren me instrumentin përkatës ka të bëjë me teknikën e kërkimit shkencor.

2.1. Teknika e vëzhgimit

Teknika e vëzhgimit është njëra ndër teknikat më të vjetra në shkencë, e cila ka zbatim të gjerë në shkencat natyrore, por edhe në ato shoqërore. Me anë të vëzhgimit studiuesi depërton në përmbajtjen e problemit, të fenomenit që e studion.

Gjatë teknikës së vëzhgimit duhet të kemi parasysh që:

- Të përcaktohen qëllimi i vëzhgimit dhe hipoteza;
- Të saktësohet qartë kush do të jetë objekt i vëzhgimit;
- Të përcaktohet njësia e studimit;
- Të hartohet programi i vëzhgimit;
- Të analizohen faktet dhe të përgjithësohen përfundimet e vëzhgimit.

Gjatë përpilimit të protokollit të vëzhgimit duhet të kemi parasysh edhe këto aspekte:

Së pari, duhet të përcaktohen shkallët vlerësuese për vëzhgimin.

Vëzhgimi numerik: Personi i cili bën vëzhgimin e një sjelljeje të caktuar ose vëzhgon karakteristikat do t'i paraqesë ato me numra, p.sh. 1 2 3 4 5, pra vlerësim numerik të sjelljeve.

Vëzhgimi i shkallëzuar sipas kategorive: Personi i cili bën vëzhgimin e një sjelljeje të caktuar ose vëzhgon karakteristikat do t'i paraqesë ato sipas kategorive, p.sh. shumë i zgjuar, i zgjuar, jo i zgjuar. Pra, vlerësim kategorik të sjelljeve.

Vëzhgimi grafik: Personi i cili bën vëzhgimin e një sjellje të caktuar ose vëzhgon karakteristikat do t'i paraqesë ato sipas grafikut P.sh., shumë i kujdesshëm, i kujdesshëm, pak i kujdesshëm. Pra, vlerësim grafik të sjelljeve.

Gjatë zbatimit të teknikës së vëzhgimit është me rëndësi që të respektohet anonimiteti i personit që vëzhgohet, përndryshe nuk do të lejojnë që të vëzhgohen.

Gjithashtu, me rëndësi është që kërkuesi mos të ndikojë në personin e vëzhguar, me apo pa dashje.

2.2. Teknika e intervistës

Intervista është teknikë mjaft e aplikueshme në kërkimet shkencore. Që të realizohet një intervistë, ajo duhet të kalojë nëpër një proces mjaft të spikatur.

Gjatë intervistimit kërkuesi duhet:

- Të përcaktojë qasjen që do ta ndjekë;
- Të përcaktojë pyetjet e përgjithshme dhe specifike;
- Të përgatitë draftin e pyetjeve të intervistës;
- Të bëjë pilot-testimin e protokollit të intervistës;
- Të caktojë kohën kur do ta realizojë intervistimin;
- Të përgatitet për shënimin ose regjistrimin e përgjigjeve të marra;
- Të realizojë intervistën.

Gjatë punës me teknikën e intervistimit, varësisht prej numrit të pjesëmarrësve, kemi:

- Intervista me nga një individ;
- Intervista normative - nga një numër i madh individësh.

Duke ditur se tipi i intervistës përcakton edhe planin, paraprakisht duhet shkruar udhëzuesin e intervistës.

Udhëzuesi i intervistës është një tërësi pyetjesh që përdoren gjatë intervistimit nga kërkuesi.

Intervista me një individ kërkon nga hulumtuesi që paraprakisht:

- Të caktojë kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistës;
- Të mos i pengojnë thirrjet telefonike dhe ndërhyrjet e tjera;

- Të përgatitet për marrjen e shënimeve (evidentim me shkrim, diktafonin etj).
- Të organizojë protokollin për shënimin e përgjigjeve.

Realizimi i intervistës

Gjatë intervistimit kërkuesi shtron pyetje të ndryshme lidhur me problemin që është objekt i studimit, ndërsa përgjigjet subjekti me të cilin bëhet intervista.

Me rëndësi janë kontrolli i përmbajtjes, duke e ndjekur udhëzuesin, dhe kontrolli i procesit gjatë intervistimit, të cilët arrihen:

- Duke e nisur mbarë intervistën;
- Duke iu përmbajtur temës;
- Duke i inkurajuar për dhënien e përgjigjeve ata që janë të rezervuar;
- Duke përdorur teknika komunikimi, si të dëgjuarit aktiv, pohimin me kokë etj.

Intervistat përmes internetit

- Shfrytëzohen për një numër më të madh, p.sh. studentë, profesorë;
- Zakonisht bëhen kur nuk kemi mundësi t'i takojmë personalisht individët;
- Paraprakisht pyetjet u dërgohen me e-mail adresë.

Analiza e të dhënave nga intervista

Është me rëndësi për hulumtuesit e rinj që:

- Te intervistat normative përgjigjet sasiore shënohen dhe analizohen nga aspekti statistikor, duke i vendosur në tabela, grafikone etj.
- Përgjigjet cilësore të analizohen nga aspekti përmbajtjesor i tyre.

2.3. Teknika e anketimit

Realizimi i një anketimi bëhet në rastet kur:

- Një problem kryesor kërkon përgjithësime;
- Hartohet hipoteza;
- Përgatitet një sistem pyetjesh.

Procesi i anketimit (grumbullimit të të dhënave) kushtëzohet nga:

- Monitorimi i procesit të anketimit;

- Kontrolli logjik i të dhënave (anketave) të grumbulluara;
- Procesimi (SPSS, etj) i të dhënave nga anketat.

2.4. Teknika e testimit

Testimi është proces, i cili kryesisht organizohet me qëllim të vlerësimit të njohurive për një qëllim të caktuar, p.sh. testimi i inteligjencës emocionale të mësimdhënësve.

Procesi i testimit realizohet përmes këtyre hapave:

- Organizimit të testimit;
- Monitorimit dhe mbikëqyrjes së procesit të testimit;
- Kontrollimit të të dhënave të testimit;
- Procesimit të të dhënave të testimit.

3. Shkallët e matjes

Në kërkime shkallët përdoren gjerësisht për matjen e variablave që ndryshojnë shumë në shkallë apo intensitet.

Për nga përmbajtja pohimet e tyre duhet të jenë njëdimensionale;

Përgjigjet e pohimeve të përfshira në shkallët dhe indekset duhet të jenë reciprokisht përjashtuese dhe shteruese.

- Përjashtuese: duhet të kenë një dhe vetëm një përgjigje;
- Shteruese: kategoritë e përgjigjeve duhet të përfshijnë të gjitha përgjigjet e mundshme.

Shkallët e matjes mund të jenë gjithashtu:

- Diferenciale - kuptimore, ku secila shkallë ka një mbiemër ose frazë;
- Shkallët e radhitjes - klasifikimit, dallimit, ku kërkojnë nga të rriturit të rangojnë rëndësinë e secilit qëllim në listë, duke i caktuar një numër rendor (p.sh 1.2.3).

Rëndësia e përdorimit të shkallëve qëndron në atë se përmes tyre bëhet:

- Një matje e saktë e indikatorëve (një pyetje e vetme e ka të vështirë që të marrë qëndrimin e dikujt ndaj një çështje);
- Krisin vlefshmërinë dhe besueshmërinë e indikatorëve;

- Rrisin variabilitetin e matjeve për indikatorët;
- Rrisin mundësinë e përdorimit të testeve të ndryshme statistikore.

3.1. Llojet e shkallëve

Në literaturën e gjerë ekziston numër i madh i shkallëve,¹² mirëpo në këtë rast do t'i trajtojmë vetëm disa prej tyre:

3.1.1. Shkalla Likert (Renis Likert 1932)

Bazohet një varg çështjesh, zakonisht në formën e pohimeve që shprehin opinionin ose pikëpamjen në lidhje me variablin/konceptin që po studiohet. Mund të përdoren shkallë Likert të përpunuara nga të tjerët në fushën përkatëse, nëse ato janë të përshtatshme për kontekstin shqiptar, mirëpo shkallët Likert mund të ndërtohen edhe vetë. Vendimi për të përdorur shkallë të gatshme varet nga disa faktorë. Së pari, si hulumtues, duhet të tregoni se shkallët, përfshirë edhe deklaratat që i përmban dhe kategoritë e përgjigjes, janë të përshtatshme në lidhje me kulturën e grupit që studiohet. A kanë kuptim deklaratat në aspektin e kulturës lokale? Nëse ndonjë nga deklaratat e ngre çështjen serioze sociale, politike, fetare, apo të tjera. Nëse ndonjë deklaratë shihet si qesharake!

Kjo lloj shkalle kërkon nga i pyeturi që të tregojë një masë aprovimi apo mosaprovimi për secilën nga seritë e thënieve në lidhje me objektin stimul. Shkalla Likert mund të ketë 5 deri në 7 pikë (shkallë): plotësisht dakord, dakord, deri diku dakord, jo dakord dhe aspak dakord.

Kodimi mund të bëhet nga 1 në 5, 0 - 4; 1 në 7, 0-6.

Pyetje: Tregoni nëse jeni dakord se shkolla juaj ofron mundësitë më të mira për studimin e lëndëve shoqërore:

4. Plotësisht dakord;
3. Dakord;
2. Deri diku dakord;
1. Jo dakord;
0. Aspak dakord.

Disa udhëzime për të ndërtuar shkallë Likert

¹² Staple skale, Thurston Scales, etj.

- Shkruani pohimet sa më thjesht që të mundeni;
- Përdorni një nivel gjuhësor që të jetë i kuptueshëm nga personat ku do të aplikohet shkalla;
- Shprehni pohimet në nivelin e gjuhës së përditshme që përdoret nga personat që do të përgjigjen;
- Përdorni pohime që shprehin qartë një opinion pozitiv ose negativ lidhur me konceptin/variablin që studioni;
- Përfshini pohime që shprehin një diapazon pohimesh që shkon nga niveli relativisht i butë te niveli më i fortë, pozitiv dhe negativ;
- Përzini pohimet me përmbajtje pozitive me pohimet me përmbajtje negative;
- Mos përdorni pohime neutrale (ato nuk diferencojnë mes personave që kanë pikëpamje të ndryshme për konceptin që ju po e studioni).

Numri i pohimeve në shkallën Likert

- Përfshihen pohime që përgjigjen minimalisht prej 2 kategorive për t' u përgjigjur: dakord, jo dakord;
- Në përgjithësi përdoren tri ose pesë kategori;
- Pohimet me pesë kategori (plotësisht dakord, dakord, i pavendosur, jo dakord, aspak dakord) rritin rangun e variabilitetit të rezultatit total të shkallës;
- Nuk duhen përdorur pohime me më shumë se 7 kategori, sepse kjo i ngatërron respondentët.

3.1.2. Shkalla e distancës sociale (Emory Bogdarus, 1933)

Përdoret për të studiuar distancën që dëshiron të mbajë një kategori e njerëzve nga një kategori tjetër. Shkallëzimi duhet të bëhet në atë mënyrë që “Jo” e fundi të merret si përfundimtare, pasi që nuk ka gjasa që respondentit pas dhënies së përgjigjes negative “Jo” të pohojë “Po” në përgjigjen pasuese. Pra, pyetje bëhen derisa respondentit të thotë “Jo” dhe në atë moment që thotë ‘Jo’ nuk i parashtrohen më pyetje.

Një grup pyetjesh mund të jetë:

1. A jeni të gatshëm që t'i lejoni serbët të jetojnë në Kosovë?

Po Jo

2. A jeni të gatshëm që t'i lejoni serbët të jetojnë në qytetin tuaj?

Po Jo

3. A jeni të gatshëm që t'i lejoni serbët të jetojnë në lagjen tuaj?

Po Jo

4. A jeni të gatshëm të jetoni pranë serbëve?

Po Jo

5. A jeni të gatshëm t'i lejoni fëmijët tuaj të luajnë me fëmijët serbë?

Po Jo

6. A jeni të gatshëm t'i lejoni serbët të vijnë në shtëpinë tuaj?

Po Jo

7. Do të jeni të gatshëm të lejoni që fëmija juaj të martohet me një serb?

Po Jo

Nëse vendosni të zhvilloni një shkallë sociale në distancë, duhet të bëni analizën e duhur konceptuale, për të identifikuar se çfarë keni ndërmend të matni, si dhe të shkruani një seri pyetjesh kulturore të përshtatshme dhe të qarta. Zakonisht, 5 deri 10 artikuj janë të mjaftueshëm për matjen e distancës shoqërore.

3.1.3. Shkalla Gutman (Guttman 1980)

Është shkallë fikse vetë-raportuese, në të cilën pohimet/pyetjet janë vendosur në një radhë kumulative. Nëse respondenti përgjigjet në mënyrë korrekte në një pohim, ai do të përgjigjet po ashtu në mënyrë korrekte edhe në pohimet e mëparshme të shkallës.

Për të sqaruar më mirë shkallën Gutman, do të shërbehemi me një shembull të thjeshtë. Ne do të përdorim vetëm tre artikuj për matjen e qëndrimeve ndaj grave që punojnë jashtë shtëpisë, do të përdorim vetëm pajtohem ose nuk pajtohem.

Artikujt janë:

1. A është në rregull për gratë e martuara pa fëmijë të punojnë jashtë shtëpisë?

Pajtohem

Nuk pajtohem

2. A është në rregull për një nënë me fëmijë të rritur të punojë jashtë shtëpisë?

Pajtohem

Nuk pajtohem

3. A është në rregull për një nënë me fëmijë të vegjël të punojë jashtë shtëpisë?

Pajtohem

Nuk pajtohem

Përgjigjet e mundshme (pajtohem dhe nuk pajtohem) mund t'i kodojmë me 0 për pajtohem dhe me 1 nuk pajtohem.

3.1.4. Shkalla diferenciale semantike

Përdoret për të matur kuptimin e koncepteve. Të pyeturit kërkohet të zgjedhin se në cilën pozitë ai ose ajo qëndron, në një shkallë në mes të dy mbiemrave (antonime).

Shembull: "e mjaftueshme - e pamjaftueshme", "e mirë - e keqe" ose "e vlefshme - e pavlefshme").

Diferenca semantike mund të përdoret për të përshkruar jo vetëm personat, por edhe kuptimin e koncepteve abstrakte, gjithashtu për të matur ndjenjat/vlerësimet e njerëzve për çështjet që studiohen. Ai që përgjigjet vendos një pikë në vijën që i bashkon dy mbiemrat. Nëse përgjigjedhëni mendon se asnjëri nga mbiemrat nuk përshtatet, e vendos pikën në segmentin në mes të vijës së ndërprerë.

Shembull:

Mësuesi i gjuhës shqipe është:

I mirë 3 2 1 0 1 2 3 I keq

I dashur 3 2 1 0 1 2 3 Jo i dashur

Profesional 3 2 1 0 1 2 3 Joprofesional

Zakonisht, pozicioni i shënuar 0 është emërtuar "neutral", pozicionet 1 janë emërtuar "pak," pozicionet 2 "mjaft" dhe pozicionet 3 "jashtëzakonisht".

4. Indekset

Indekset përdoren për matjen e variablave, si p.sh. statusin socio-ekonomik ose indikatorë të ndryshëm socialë apo shëndetësorë.

Për ndryshim nga shkallët, të cilat janë të bazuara në pikat e ndryshme intensiteti, artikujt e përdorur në indekse trajtohen me të njëjtin intensitet.

Zhvillimi i një indeksi ndjek procesin e njëjtë të përshkruar më parë për ndërtimin e një shkalle, duke filluar me përkufizimin e konceptit për t'u matur. Pas ndërtimit të një shkalle, hapi tjetër bëhet për të zgjedhur treguesit për përdorim në ndërtimin e indeksit.

Shembull:

Nëse dëshirojmë të zhvillojmë një indeks për statusin socio-ekonomik të familjeve, së pari e definojmë konceptin, siç është përdorur shpesh, ashtu siç e kemi perceptuar në përgjithësi: nga familjet me status të lartë deri te ato më të ulët brenda komunitetit. Pastaj, duhet të përdorim tre treguesit e statusit socio-ekonomik: (1) vitet e shkollimit të meshkujve të parë të familjeve, (2) profesionet e krerëve të familjeve dhe (3) llojin e materialit që është përdorur për ndërtimin e shtëpive të tyre.

Një intervistues lehtë mund të shohë dhe të shënojë atë lloj materiali që është përdorur për ndërtimin e shtëpisë (më e vështirë do të ishte të bëhej matja e metrave katrorë të shtëpisë). Gjithashtu, ne e kuptojmë se është e vështirë të marrim të dhëna të sakta për pasurinë familjare. Gjithashtu, është më e lehtë të marrim të dhëna për vitet e shkollimit të personave që dëshirojmë dhe profesionet e tyre.

Shembull i një indeksi:

1. Cila është puna kryesore e kreut të kësaj familje?
2. Sa vjet të plotë të shkollimit i ka kreu i kësaj familje?
3. Shtëpia është bërë nga:
 - a. Kombinimi i kartonit, rroba, kallaji, etj;
 - b. Tulla balte;
 - c. Blloqe betoni;
 - ç. Tulla të pjekura;
 - d. Të tjera, të përshkruaj _____

Pyetja e parë dhe e dyta janë të hapura, kërkuesi do të shënojë atë që të anketuarit e japin si përgjigje të tyre. Pika e tretë përfshin katër kategori të përgjigjes me një përgjigje të hapur. Së bashku, këto kategori i kanë përmbushur kriteret për të qenë reciprokisht ekskluzive, por e kemi shtuar kategorinë "të tjera", për të siguruar se atributet e ndërtimit të shtëpisë do të plotësojnë kriterin shterues.

Hapi i ardhshëm do të jetë të caktojmë vlerat numerike të çdo atributi ose kategorie që përbën çdo tregues. Në shembullin tonë, për thjeshtësi, përdorim vetëm dy kategori për çdo ndryshore: "të ulët" apo "të lartë" për çdo send. Do të shqyrtojmë çdo profesion dhe për vendin e secilit në një kategori të lartë apo të ulët, bazuar në vlerësimet e prestigjin social të profesioneve në komunitetin që jemi duke e bërë studimin tonë.

5. Indikatorët

Indikatorit është një mjet për matje, i cili na mundëson qartësimin dhe matjen e një koncepti. Ai mund të jetë sasior ose cilësor.

Paraprakisht duhet ta kemi të qartë:

- Çka matim me këtë indikator?
- Pse e bëjmë matjen?
- Cili është indikatorit më i besueshëm?

Në projektin e kërkimit indikatorët janë manifestim i disa dukurive, drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, të cilat mund të evidentohen dhe njihen me

shqisa, përmes së cilave mund të arrihet njohuria e vërtetë dhe e verifikuar për atë dukuri.

Ky përkufizim është i vërtetë në kuadër të rregullave të shkencës, e cila nënkupton verifikimin intersubjektiv. Verifikimi intersubjektiv më tutje nënkupton mundësinë që disa subjekte të ndryshme, njëkohësisht, në të njëjtat kushte dhe në të njëjtën mënyrë, konstatojnë insistimin e manifestimit të tillë, vetive të tij dhe domethënies. Nëse konstatimet e disa subjekteve shprehin pajtimin, atëherë kjo do të thotë se manifestimi është vërtetuar si tregues apo indikator i drejtë.

Indikatorët në projektin shkencor të kërkimit janë ai manifestim që ka të bëjë me strukturën e hipotezës, para së gjithash me qëndrimin dhe domethënien e saj që i përgjigjet sistemit kuptimor-terminologjik dhe domethënës. Arsye për këtë është se i njëjti manifestim i një dukurie, në situata të ndryshme dhe në projekte të ndryshme hulumtuese, në kohë të ndryshme dhe në vend të ndryshëm, mund të ketë kuptime të ndryshme, sidomos për subjekte të ndryshme shoqërore.

Indikatorët duhet të jenë të definuar qartë dhe ta përshkruajnë realitetin, të cilit i përkasin konceptet e marrëdhënieve, gjegjësisht realitetin që tregohet. Indikatorit apo treguesit tregon atë që me manifestim është shfaqur. Lidhur me shembujt tashmë të përmendur këtu, kjo do të dukej kështu: Gazeta Y në rubrikën e saj politike brenda shtatë ditësh për një eksel politik, konflikt, qëndrim, ose akt shkruan pesë herë.

A është ky indikator?

Natyrisht, ky është indikator kuantitativ i thjeshtë për shpeshësinë e temave të caktuara në artikuj. Kurse a është indikator edhe për neutralitet-paanshmëri të rubrikës në fjalë, apo për konsekuencë, respektim të parimeve. Ky fakt vetvetiu nuk mjafton dhe nuk është indikator i drejtë, ndonëse ky është komponent i rëndësishëm i indikatorit. Për t'u formuar indikatorit i drejtë për neutralitet - paanshmëri, është e nevojshme që të shtohen edhe indikatorët për orientimin e artikullit, qëndrimeve që u cekën, autorët e qëndrimeve, burimet e njohjes, vlerësimet, etj. Pra, nuk ka mundësi që të formohet një indikator i thjeshtë, por është i nevojshëm indikatorit i komplikuar. Pastaj, është e qartë se indikatorit ka të bëjë me qëndrimin e hipotezës. Indikatorët nuk mund të konsiderohen "operacionalizim i nocionit të variablit".

Në të vërtetë indikatorët faktikë janë tregues të drejtpërdrejtë, por edhe indirektë të qëndrimeve të hipotezës. Indikatorët nuk e kanë të njëjtën vlerë, kurse vlera e tyre përcaktohet për çdo projekt, madje edhe për çdo hipotezë në raste të jashtëzakonshme. Mirëpo, për të gjithë indikatorët vlen një imperativ: të jenë të drejtë! Për këtë arsye vlera e tyre verifikohet.

Karakteristikat e indikatorëve të drejtë janë:

- a) objektiviteti;
- b) besueshmëria;
- c) njëkuptimësia;
- d) saktësia;
- e) reprezentimi.

Është e pakontestueshme se deri te këto forma arrihet përmes të gjitha mënyrave të cekura më lart dhe kjo është e mundur përmes kërkimit të posaçëm të indikatorëve, gjë që edhe rekomandohet në kushte të caktuara.

Kemi shumë lloje të indikatorëve, por më të zakonshëm janë indikatorët në bazë të klasifikimit në vijim:

- a) sipas kriterit të përmbajtjes - indikatorët e variablave dhe indikatorët e qëndrimeve të hipotezave;
- b) sipas kriterit të vlerës - të përdorueshëm dhe të papërdorueshëm, gjegjësisht relevantë dhe jorelevantë;
- c) sipas kriterit të lindjes - ekspresiv (indikatorët e qëndrimeve) dhe predikativ (indikatorët e dimensioneve reale - veçorive). Në kuadër të këtij kriteri kemi edhe indikatorët objektivë; të tilla janë faktet objektive reale, të cilat mund të konstatohen me shqisa dhe me përvojë dhe indikatorët subjektivë. Të tillë janë mendimi i objektit, përjetimi i tij, ndjenjat dhe emocionet;
- d) sipas kriterit të ndërlikueshmërisë - indikatorët elementarë, të thjeshtë dhe të ndërlikuar në kuptimin e tërësisë së lidhjes.

Zgjedhja e indikatorëve është e kushtëzuar para se gjithash nga të dhënat adekuate, të nevojshme dhe të vërteta, të cilat e vërtetojnë apo e përgënjeshtrojnë hipotezën.

Të tillë janë:

1. Veçoritë e objektit dhe qëllimeve të kërkimit;
2. Veçoritë e qëndrimit të hipotezës dhe variablave;
3. Njohuritë paraprake shkencore për objektin e kërkimit.

IV. HIPOTEZAT DHE VARIABLAT E KËRKIMIT SHKENCOR

1. Hipotezat e kërkimit shkencor

Hipotezë quajmë supozimin fillestar dhe jo të sigurt, por që megjithatë ka gjasa të vërtetohet, në bazë të së cilës mund të jepen shpjegimet e para lidhur me ndonjë dukuri, çështje e marrëdhënieve, problem etj.

“Hipotezat janë një lloj i veçantë i pyetjeve të hulumtimit... një pohim ose shprehje e marrëdhënieve midis dy ose më shumë koncepteve”¹³. Ato janë pohim i testuar për marrëdhënien ose marrëdhëniet midis dy ose më tepër koncepteve.

Hipotezë, pra, s’mund të quhet çdo supozim, andaj kur e shkruajmë një hipotezë paraprakisht duhet të dimë se ajo duhet të ketë:

- Një mbështetje solide në faktet e konstatuara dhe në parimet e mendimit logjik;
- Të ketë relevancë, të jetë e thjeshtë;
- Zakonisht është një supozim që mund të verifikohet, ose do të verifikohet pas kërkimit.

Çdo hipotezë i ka tri tipare kryesore:

- Është e pasigurt, por mund të verifikohet;
- Është e përkohshme, ngase duhet të verifikohet ose të përgënjeshtrohet;
- Duhet të jetë patjetër e verifikueshme.

1.1. Llojet e hipotezave shkencore

Në literaturë kur flitet për llojet e hipotezave flitet për:

- Hipotezën e përgjithshme;
- Hipotezat ndihmese;
- Hipotezën zero (nuk konstatohet më parë se a është apo nuk është ashtu, do të thotë nuk ka dallime);
- Hipotezën alternative (parashihet më parë se ka dallime).

¹³ Bob Matthews dhe Liz Ross. 2010. Metodatat e Kërkimit, Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane, CDE, f. 58.

a. Nga mënyra se si nxirren, hipotezat ndahen në:

- Induktive - mënyrë arsyetimi e kërkuesit për hipotezën që niset nga e veçanta dhe e pjesshmja për të nxjerrë përfundime të përgjithshme;
- Deduktive - mënyrë arsyetimi e kërkuesit për hipotezën që niset nga e përgjithshmja për të nxjerrë një koncept të ri, më pak të përgjithshëm.

b. Nga mënyra e formulimit të tyre kemi:

- Hipoteza alternative (e kërkimit) - hipoteza që përshkruan parashikimin tuaj specifik për marrëdhënien në mes të variablave (hipoteza që studiuesi përipiqet të tregojë se është e vërtetë). (Simboli: H1 ose HA).

Shembull i hipotezës alternative:

Gjendja ekonomike ndikon dukshëm në trafikimin e qenieve njerëzore.

Në kuadër të hipotezave të kërkimit hyjnë:

- Hipoteza njëdrejtimëshe: Ky lloj i hipotezës shpreh një drejtim specifik në marrëdhëniet mes variablave dhe hipoteza nul (zero) tregon se nuk do të ketë ndonjë ndryshim ose shpreh ndonjë parashikim, por në drejtimin e kundërt me atë të hipotezës alternative.

Shembull i hipotezës njëdrejtimëshe:

Cili është ndikimi i emisioneve televizive te fëmijët e moshës shkollore në edukimin moral të tyre.

Hipoteza alternative (H1 ose HA): *Ndikimi i emisioneve televizive është shumë i madh në edukimin moral të fëmijëve të moshës shkollore.*

Hipoteza nul (H0): *Emisionet televizive nuk ndikojnë fare në edukimin moral të fëmijëve të moshës shkollore.*

- Hipoteza dydrejtimëshe: Kur studiuesi beson se do të ketë një ndikim, mirëpo hipoteza alternative nuk specifikon një drejtim në marrëdhënien mes variablave.

Shembull i hipotezës dydrejtimshe:

Cili është ndikimi i emisioneve televizive te fëmijët e moshës shkollore në edukimin moral të tyre.

Hipoteza alternative (H1 ose HA): *Emisionet televizive ndikojnë në edukimin moral të fëmijëve të moshës shkollore.*

Hipoteza nul (H0): *Emisionet televizive nuk ndikojnë në edukimin moral të fëmijëve të moshës shkollore.*

- Hipoteza zero (statistikore): Hipoteza që përshkruan të gjitha rezultatet e tjera të mundshme në lidhje me marrëdhëniet mes variablave në studim. (Hipoteza e kundërt e hipotezës alternative (Simboli: H0 ose H0)).

1.2. Ndërtimi i hipotezave të kërkimit

Hipotezat nxirren nga teoritë ekzistuese, i sfidojnë ato, ose përpiqen të nxjerrin teori të reja.

Hipoteza duhet të përfundojë me një tezë, e cila duhet të japë përgjigje për pyetjen që deri më tani nuk ka dhënë përgjigje ose ka dhënë përgjigje, por nuk jemi të kënaqur ose dëshirojmë ta verifikojmë, apo fare nuk pajtohemi, andaj duhet të jetë specifike dhe jo e përgjithshme. Hipoteza duhet të çojë të përgjigjja ndërmjet shkakut dhe pasojës, në formë të një marrëdhënie logjike, ndërmjet ndryshoreve, me anë të një metode të zgjedhur (p.sh. krahasuese).

Hipoteza është një parashikim specifik dhe i testueshëm empirikisht për një marrëdhënie midis dy ose më shumë variablave. Ajo përshkruan në mënyrë konkrete se çfarë pritet të ndodhë në studim dhe pohon ekzistencën e një marrëdhënieje midis variablave të studimit dhe drejtimin specifik të marrëdhënies.

Hipotezat burojnë nga supozimet ose nga frymëzimet, por pasi të jenë formuluar ato duhet të testohen në mënyrë të rreptë (pilotohen), duke përdorë metodën e duhur.

Në varësi prej problemit hulumtues dhe asaj që dëshirojmë të nxjerrim me anë të hulumtimit, paraprakisht edhe e parashtrijmë hipotezën.

Shembull:

1. Nëse tema është *Ndikimi i dhunës ndaj nxënësve në braktisjen e shkollës* dhe dëshirojmë të dimë se nxënësit e cilës gjini e braktisin më tepër shkollën si rezultat i dhunës në shkollë, atëherë hipoteza alternative do të ishte: Dhuna e mësimitdhënësve ndikon më shumë te nxënësit e gjinisë femërore që ta braktisin shkollën, ose si hipoteza e përgjithshme mund të ishte: Dhuna ndaj nxënësve ndikon shumë që nxënësit ta braktisin shkollën.

2. Tema *Ndikimi i mësimitdhënies tradicionale dhe mësimitdhënies ndërvepruese në procesin mësimor* (krahasim).

Hipoteza: Mësimitdhënia ndërvepruese ndikon më mirë në procesin mësimor sesa mësimitdhënia tradicionale.

1.3. Formulimi i hipotezave

Hipoteza paraqet pikën fillestare në kërkim, që duhet të mbështetet në njohjen e thellë të problemit. Hipotezat duhet të jenë të formuluarat qartë dhe thjesht, lidhur me supozimin tuaj për rezultatet e pritshme. Ajo përfaqëson bazën nismëtare për përcaktimin e qëllimeve dhe detyrave. Çdo kërkim eksperimental ose shpjegues nis duke pritur ndonjë rezultat të caktuar. Kjo pritje e ndonjë rezultati është HIPOTEZA.

Hipoteza siguron nismë dhe nxitje për kërkim shkencor dhe ndikon në metodën e kërkimit.

Në dritë të kësaj pritjeje disa vrojtime vlerësohen si relevante dhe disa të tjera si jorelevante.

Si bëhet pilotimi i hipotezës dhe si të jemi në dijeni se ajo është e saktë.

Nëse parashikimet dalin të sakta, atëherë hipoteza juaj është provuar (mbështetur në të dhënat empirike) dhe mund të qëndrojë përderisa testet e ardhshme të provojnë pasaktësinë e saj.

1.4. Modifikimi i hipotezave

Hipotezat mund të ndryshohen apo të modifikohen në proces e sipër, gjatë punës hulumtuese.

Nëse parashikimet e nxjerra nga hipoteza nuk dalin të jenë të sakta, atëherë duhet të braktisni ose të modifikoni hipotezën.

Pasi të keni arritur te hipoteza, që është produkt i imagjinatës tuaj, atëherë kaloni në një proces më rigoroz dhe logjik, bazuar në argumentin deduktiv, dhe së këndejmi rrjedh termi ‘hipotetiko-deduktiv’.

Kërkuesi gjithnjë duhet të formulojë një hipotezë para se ta testojë atë. Për shembull: “Lëvdatat ndikojnë më shumë se qortimet në të nxënit e nxënësve të shkollës fillore”.

Nuk ka shkencëtar që pret derisa të mbledhë të gjitha të dhënat për të provuar t’u japë kuptim atyre.

Parashtrimi, ngritja e hipotezave

Ngritja e hipotezave pas modifikimit mund të bëhet në tri forma:

- Si shprehje eksplicite - kur nisemi nga fakti se ekziston korrelacion midis dy variablave, apo dukurive pedagogjike;
- Si shprehje implicite - kur shtrojmë pyetje se a ekziston dallimi midis dy dukurive pedagogjike;
- Si shprehje zero - se nuk ekziston lidhja midis dy dukurive.

1.5. Argumentimi i hipotezës

Hipoteza duhet të argumentohet në aspektin empirik dhe interpretimi i arsyeshëm teorik, në bazë të gjetjeve në kërkimet e mëparshme dhe nga analiza e literaturës për atë fushë. Të gjitha hipotezat e një studimi nuk duhet të bazohen vetëm në arsytetime ose në intuitë, por në radhë të parë duhet të formulohen dhe testohen mbi bazën e të dhënave që grumbullohen, përmes vëzhgimit të dukurive të botës reale, ashtu siç ndodhin, ose përmes eksperimenteve.

Pra, hipoteza duhet të provohet. Megjithatë, ky është një term që me disa përjashtime të vogla, në aspektin e edukimit, nuk përdoret më në kërkimet bashkëkohore, sepse prova varet nga konteksti vendor dhe rasti.

Hipoteza sprovuese është një hipotezë e mundshme, një parashtrim që duhet provuar, disaprovar ose rishikuar.

Teza sprovuese ju ndihmon të parapërgatiteni.

1.6. Funksioni i hipotezave

Hipoteza e kërkimit i ka dy funksione themelore:

- Përcakton qëllimin e kërkimit;
- Përcakton mënyrat e kërkimit (metodat, teknikat, instrumentet dhe llojin e të dhënave) për ta verifikuar ose hedhur poshtë.

Hipoteza parqet një “orientim”, ide udhëheqëse në rrugën e kërkimit, e cila na shërben edhe në seleksionimin e fakteve për verifikimin e saj.

Andaj, në literaturë flitet për tri funksionet kryesore të hipotezës, të cilat janë:

- konstatimi dhe shpjegimi i fakteve;
- shpjegimi i lidhjes konkrete midis gjësëndeve;
- shpjegimi i lidhjeve midis atyre proceseve që janë thelbësore dhe atyre që nuk janë thelbësore.

Nga hipoteza varen qasja, përcaktimi i metodave, teknikave, instrumenteve dhe zbatimi i procedurave hulumtuese.

1.7. Vlefshmëria e hipotezës në kërkim

Një hipotezë shkencore është me vlerë më të madhe njohëse, me shumë gjasa të verifikohet nëse është valide.

Për të qenë valide ajo duhet:

- Të mbështetet në sa më shumë fakte, të mbledhura paraprakisht dhe me plan;
- Të jetë rrjedhojë nga njohuritë e mëparshme të kërkuesit;
- Të ketë lidhje të drejtpërdrejtë me temën që hulumtohet;
- Të jetë e frytshme nëse me anë të saj mund të shpjegohen sa më shumë dukuri, apo procese që hulumtohen;
- Të jetë sa më e thjeshtë domethënia, nëse asaj nuk i nevojiten hipoteza të tjera ndihmëse.

Kur hipoteza është e vlefshme pas testimi dhe e formuluar mirë, atëherë ajo ngrihet në nivel të tezës (gjeneralizohet).

2. Variablat e kërkimit shkencor

Karakteristikat e matshme të njerëzve dhe sendeve që mund të marrintribute (vlera sasiore ose cilësore) të ndryshme quhen variabla.

Dukuria që është objekt i kërkimit dhe që mund të vërtetohet quhet variabël.

Përcaktimi i variablave në kërkimet empirike paraqet rrugën për njohjen kauzale (shkak – pasojë) të problemit kërkimor.

Çdo variabël i ka të paktën dy vlera të mundshme (përndryshe nuk ndryshon), p.sh. (“Po” dhe “Jo”). Shumica e variablave i kanë tri ose më shumë vlera të mundshme, ndërsa disa variabla e kanë një numër të pafundmë vlerash të mundshme.

2.1. Llojet e variablave

Variablat dallojnë ndërmjet tyre në bazë të:

Varësisë:

- Variabla të pavarura;
- Variabla të varura;

Në bazë të qasjes:

- Variabla sasiore;
- Variabla cilësore;

2.1.1. Llojet e variablave në bazë të varësisë

- Variablat e pavarura: Variabla e pavarur është faktori që matet, manipulohet ose seleksionohet nga studiuesi, me qëllim që të përcaktohet marrëdhënia e tij me një fenomen që vëzhgohet.

Shembull i variablës së pavarur

Tema: *Cili është ndikimi i emisioneve televizive tek fëmijët e moshës shkollore në edukimin moral të tyre.* Ndikimi i emisioneve televizive është variabël i pavarur.

- Variablat e varura: Variabël e varur është faktori që vëzhgohet dhe matet për të përcaktuar efektin e variablës të pavarur.

Shembull:

Tema: *Cili është ndikimi i emisioneve televizive tek fëmijët e moshës shkollore në edukimin moral të tyre.* Variabël e varur është edukimi moral.

2.1.2. Llojet e variablave në bazë të qasjes

a. Variablat sasiorë

Një variabël është sasior nëse vlerat e tij të vërteta dhe jo ato të koduara shprehen me numra.

Shembuj:

Madhësia e familjes: 1 person, 2 persona, 5 persona;

Mosha: 15 vjeç, 20, 35, etj.

Llojet e variablave sasiorë

Variablat indikatorë: Disa herë variablat sasiorë grupohen në kategori, p.sh. mosha: 21-25, 26-30, 31-35 etj. Këto kategori mund të rikodohen me numra, p.sh. 1. 21-25, 2. 26-30, 3. 31-35, etj.

Variablat intervalë: Një variabël interval (ose variabla e matur në nivelin interval) ka vlera që janë numra realë, të cili mund të mblidhen, zbriten dhe t'u llogaritet mesatarja. Është një lloj i posaçëm i matjes, i cili bëhet në bazë të matjes së hapësirës ose të madhësisë hapësinore ndërmjet vlerave numerike.

Fjala interval rrjedh nga gjuha latine - intervalum, që në gjuhën shqipe domethënë mes-hapësinor, madhësi mes-hapësinore ndërmjet vlerave apo ndërmjet dy numrave. Nëse do të krahasojmë dy raste dhe një variabël interval, mund të themi se ato kanë të njëjtën vlerë ose vlera të ndryshme. Dallojmë atë që ka vlerë më të ulët nga ai që ka vlerë më të lartë dhe po ashtu themi se sa më i ulët ose më i lartë është vlera e njërit rast nga e tjetrit, sepse mund të zbrisim njëren vlerë nga tjetra. Kështu që mund të përcaktojmë magnitudën e intervalit që i ndan ato dhe themi se sa larg janë rastet në lidhje me variablën e dhënë.

Nëse i krahasojmë tri raste për të njëjtin variabël interval, mund të përcaktojmë rastin që ka vlera të ndërmjetme dhe po ashtu përcaktojmë se

cili nga dy rastet e tjera është më afër këtij rasti. Por, nuk mund të themi se sa herë më e madhe është një vlerë nga një tjetër.

Shembuj: Niveli i pikëve të një testi

Nëse një nxënës i ka marrë në testin e parafundit në gjuhën shqipe 48 pikë, ndërsa në testin e fundit nga e njëjta lëndë i ka marrë 40 pikë, atëherë mund të themi se intervali në mes të këtyre numrave është 8 pikë.

Variablat e raportit apo proporcionalë: Një variabël raport (ose një variabël që matet në nivel raporti) është një variabël interval (që ka vlera që janë numra realë, të cilët mund të mblidhen, të zbriten dhe të nxirret mesatarja) që mund të pjesëtohet njëra vlerë me tjetrën (të llogaritet raporti i tyre) dhe të thuhet se njëri rast ka dyfishin e vlerës së tjetrit. Kjo kërkon që variabla të mos ketë një vlerë arbitrare zero, i cili përfaqëson në një farë kuptimi mungesën complete të karakteristikës me të cilën ka të bëjë variabla.

Me anë të variablave të raportit bëhet matje e drejtpërdrejtë dhe më së shumti përdoret për matjen e dukurive fizike, që shihen dhe preken me dorë.

Shembuj të variablave të raportit apo proporcionalë:

- Numri i fëmijëve (nëse njëri i ka 3 fëmijë dhe një tjetër i ka 6, atëherë mund të themi se x familja e ka dyfishin e fëmijëve të familjes y);
- Pesha e nxënësit (nëse një nxënës peshon 30 kg, ndërsa tjetri 60 kg, atëherë mund të themi se fëmija i dytë e ka dyfishin e peshës së fëmijës së parë);
- Pesha e çantës së nxënësit;
- Numri i nxënësve;
- Madhësia e popullatës;
- Niveli i të ardhurave (individualë ose familjet);
- Moshë (por e pakoduar).

b. Variablat cilësorë

Variabla është kualitative nëse vlerat e saj shprehen me fjalë:

Niveli i shkollimit, orientimi fetar, politik etj.

Llojet e variablave cilësorë

Variablat nominalë: Variablat nominalë janë variablat më të thjeshtë për matjen e dukurive masive. Me anë të variablave nominalë emrat, faktet, sendet, subjektet, objektet dhe dukuritë e tjera i emërtojmë¹⁴ dhe i zëvendësojmë me numra të veçantë, në mënyrë që gjatë punës sonë ta kemi më të lehtë manipulimin me numra.

P.sh. Gjinia: 1. femër, 2. mashkull,

Orientimi fetar: 1. mysliman, 2. katolik, 3. ortodoks,

Paralelet e një klase: I, II, III etj.

Po të shikohen këta shembuj, e kuptojmë se emërtimi ose nominimi ynë i variablave nuk është bërë për shkak të rëndësisë që kanë, por për shkak të lehtësisë të punës gjatë analizës (gjinia mashkull në raport me gjininë femër nuk është as më e rëndësishme, e as më pak e rëndësishme).

Numrat që i shohim më lart nuk kanë ndonjë vlerë reale, por vetëm vlerë emërtimi ose kodimi, me qëllim të identifikimit më të lehtë të fakteve.

Variablat ordinalë: Një variabël ordinal¹⁵ (ose një variabël i matur në nivelin ordinal) ka vlera të cilat përfshihen në një farë lloji të rangimit natyral. Në këtë lloj të variablave numrat i përdorim për matje në bazë të radhitjes ose rangimit që i bëjmë, sipas ndonjë kriteri. Sa herë që radhitim diçka në bazë të ndonjë kriteri, në të vërtetë i diferencuojmë dhe i matim ato. Numrat e ranguar në të vërtetë tregojnë se diçka është më i mirë apo më i keq se tjetri. Kështu që rastet mund të rangohen ose vendosen sipas një radhe të caktuar në përputhje me vlerat e tyre në një variabël ordinar.

Shembuj të variablave ordinalë:

Nivelet e shkollimit: 1. arsimit fillor, 2. i mesëm, 3. i lartë;

Niveli i dakordimit: 5. plotësisht dakord, 4. dakord, 3. deri diku dakord, 2. nuk jam dakord, 1. aspak nuk jam dakord.

Sa i përket kësaj radhe nuk është e domosdoshme të jetë kështu, mund të fillohet edhe nga më i ulëti.

Variablat e preferencës: Janë variabla kategorikë, vlerat e të cilave janë ose në sekuencë rritëse ose zbritëse.

¹⁴ Nga latinishtja: nomino-emërtim.

¹⁵ Nga latinishtja: ordino- radhë, radhitje.

P.sh. kërkohet që të përcaktojë rëndësinë e burimeve të informacionit, duke përdorur kodin 1 (informacioni më i rëndësishëm) dhe 5 (informacioni më pak i rëndësishëm).

P.sh. kanalet televizive që përcillen më së shumti:

1. Televizionet kombëtare,
2. Televizionet lokale,
3. Televizionet rajonale
4. Televizionet e huaja,
5. Kanalet digjitale etj.

Variablat e përgjigjeve të shumëfishta: Janë ato variabla që mund të marrin më shumë se një vlerë (pyetjet që u kërkohet respondentëve të rrethojnë më shumë se një variant).

Shënim:

Për t'u bërë të përpunueshme nga pikëpamja kompjuterike për secilin variant (kategori) duhet vënë vlera dikotomike: variantit të rrethuar i jepet kodi numerik 1 dhe variantit të parrethuar i jepet kodi numerik 0.

1. Numëroni ndonjë arsye që ju shtyn të vazhdoni të arsimoheni gjatë gjithë jetës:

- a) dua të di më shumë;
- b) dua të fitoj të ardhura më të larta;
- c) dua të avancohem në vendin tim të punës;
- d) dua të jem aktual në mjedisin ku punoj;
- e) dua të zë një pozitë më të lartë në organizatë;
- f) dua të bëhem model për fëmijët e mi;
- g) tjetër _____.

Rrumbullako vetëm a, b, c, d, e, f, g, apo shkruaj ndonjë arsye tjetër personale.

V. POPULLACIONI DHE GRUPI PËRFAQËSUES

1. Popullacioni

Popullacioni është tërësia e rasteve individuale që e përbëjnë masën dhe që e prodhojnë dukurinë masive, apo numri tërësor i rasteve që përfshihen si objekt kërkimi.

Shembull: Niveli i kënaqësisë në punë i mësimdhënësve të shkollës fillore sot në Kosovë.

Popullacionin e këtij problemi e përbëjnë të gjithë mësimdhënësit e shkollës fillore që aktualisht punojnë në Kosovë.

Kur numri i rasteve individuale është i vogël, është e lehtë dhe e preferueshme që kërkimi të kryhet në popullacion, mirëpo nëse rastet individuale janë të mëdha (siç edhe janë zakonisht), ky lloj studimi do të ishte i pamundur, por ndonjëherë është edhe e pakuptimtë.

Arsyetimi i pamundësisë së studimit në popullacion bëhet:

- Kur nuk do të ishte e mundur në aspektin ekonomik (do të kushtonte shumë);
- Nuk do të ishte e mundur edhe në aspektin e kohës (do të na merrte shumë kohë);
- Do të mungonin kuadrot profesionale për ta përfunduar këtë punë me sukses;
- Rezultatet nuk do të ishin shumë të sakta (për shkak të numrit të madh të pjesëmarrësve në kërkim, p.sh 1000000, studimi do të bëhej shkel e shko dhe rezultatet nuk do të jenë të sakta).

1.1. Llojet e popullacionit

Kemi lloje të ndryshme të popullacionit, por në këtë libër i kemi radhitur në bazë të disa kriterëve:

1.1.1. Në bazë të përcaktimit të numrit të popullacionit dallojmë:

Popullacion numerikisht të caktuar

Ky lloj i popullacionit nënkupton se të gjitha rastet individuale që e përbëjnë masën janë të regjistruara, e që është më e lehtë për studimin e rastit.

Shembull: Nëse do të dëshironim të bënim një kërkim, lidhur me suksesin e nxënësve që e mbarojnë vitin e fundit të shkollimit të mesëm, me këtë rast dihet qartë se cila është popullata, pasi që ekzistojnë ditarët dhe regjistrat e nxënësve.

Popullacioni numerikisht i pacaktuar

Me këtë lloj të popullacionit nënkuptojmë rastet individuale që e prodhojnë dukurinë dhe nuk janë të njohura për ne.

Shembull: Numri i fëmijëve me nevoja të veçanta në Kosovë që nuk i vijoje institucionet edukativo-arsimore nuk është i njohur për studiuesin, andaj është e vështirë që të bëhet kërkimi korrekt.

1.1.2. Në bazë të dallimeve kemi:

Popullacionin homogjen

Nëse anëtarët e një popullate janë identikë, popullata konsiderohet homogjene dhe aspak nuk do të ishte e vështirë për kërkuesin të bëjë studimin, pasi që nuk do të lodhej me të gjithë individët, por do të mjaftonte vetëm një rast.

Shembull: Nëse të gjithë nxënësit e Kosovës do të kishin karakteristika të njëjta (aftësi, afinitete, etj.), do të ishte e mjaftueshme që vetëm një nxënës ta studiojmë dhe ai do të tregonte cilësitë edhe të nxënësve të tjerë.

Popullacionin heterogjen

Kur individët e një popullate janë të ndryshëm, popullata quhet heterogjene (ka variacion të madh mes individëve).

Për të përshkruar një popullatë heterogjene duhen vëzhgime të shumë individëve, në mënyrë që të shpjegohen karakteristikat e ndryshme që mund të ekzistojnë.

Shembull: Karakteristikat e njerëzve janë individuale, ose siç përdoret thënia në popull gishtërinj të një dore janë, por dallojnë ndërmjet vete. Secili ka karakteristika që ngjasojnë, por edhe karakteristika dalluese.

2. Grupi përfaqësues

Për shkak të pamundësisë që rastet të studiohen në popullacion, jemi të detyruar që këtë ta bëjmë me anë të grupit përfaqësues. Grupi përfaqësues është pjesë e popullacionit, pra e zgjedhim një pjesë të rasteve individuale (në bazë të disa kritereve), me qëllim të përfaqësimit të tërë popullacionit.

Shembull: Niveli i kënaqësisë në punë i mësimitdhënësve të shkollës fillore sot në Kosovë.

Ne nuk do të marrim të gjithë mësimitdhënësit e shkollës fillore për ta studiuar këtë problem, por studimin do ta mbështesim në një grup të mësimitdhënësve të shkollës fillore, i cili do të jetë përfaqësues edhe për mësimitdhënësit e tjerë që nuk janë pjesëmarrës në kërkim.

Grupi përfaqësues në literaturë mund të haset edhe me emërtime të tjera: Grup përfaqësues, model, kampion, paradigmë, ekzemplar etj.

Qasja e përdorur për zgjedhjen e grupit përfaqësues varet nga pyetja e kërkimit, natyra e të dhënave dhe metodat e mbledhjes së analizave.

Karakteristikat e grupit përfaqësues:

Në qoftë se pyetja e kërkimit kërkon të gjeni ngjashmëritë ose dallimet e kohës së leximit midis nxënësve të klasës së tetë dhe të klasës së nëntë, duhet të përfshini në grup përfaqësues një numër të barabartë ose të përafërt të nxënësve të këtyre dy klasave.

Grup përfaqësues i mjaftueshëm është një grup përfaqësues që statistikisht është përfaqësues i një popullate.

2.1. Kuadri i grupit përfaqësues

Me qëllim të dhënies së mundësisë që të gjithë individët që e prodhojnë dukurinë ta kenë mundësinë për pjesëmarrje, duhet që të sigurojmë listën për të gjithë pjesëmarrësit. Kuadri i grupit përfaqësues është lista e të gjitha elementëve të popullatës që do të përdoren në grupin përfaqësues.

Shembuj të kuadrit të grupit përfaqësues: Lista e mësuesve të të gjitha niveleve, sipas shkollave.

Duke e siguruar listën e të gjithë mësimitdhënësve që e përbëjnë dukurinë masive ne sigurojmë një element të saktësisë dhe korrektësisë, na mbetet

edhe zgjedhja e grupit përfaqësues që studimi të jetë përfaqësues për popullacionin.

Shembull: *Niveli i kënaqësisë në punë i mësimitdhënësve të shkollës fillore sot në Kosovë.*

2.2. Llojet e grupeve përfaqësuese

Kemi dy lloje të grupeve përfaqësuese:

- Grupet përfaqësuese me probabilitet;
- Grupet përfaqësuese me joprobabilitet.

Më poshtë do të trajtohen disa lloje të grupeve përfaqësuese (me probabilitet), të cilat i konsiderojmë si llojet më të përsosura dhe që ofrojnë saktësi në përfaqësimin e popullacionit. Ekzistojnë edhe lloje të tjera të grupeve përfaqësuese (me joprobabilitet), që nuk e kanë saktësinë e zgjedhjes së grupit përfaqësues, për këtë arsye edhe nuk i kemi trajtuar fare.

2.2.1. Grupi përfaqësues i rastit

Grupi përfaqësues i rastit është një nga mënyrat që i siguron çdo elementi në popullatë të ketë një shans të barabartë për t'u zgjedhur. Ky grup përfaqësues formohet prej rasteve individuale të marra rastësisht nga popullacioni¹⁶. Kur dihet numri i rasteve individuale (popullacioni numerikisht i caktuar), i marrim të gjitha rastet individuale, ndërsa kur nuk dihet numri i saktë i rasteve individuale, atëherë i marrim rastet individuale që i kemi në dispozicion. Kjo zgjedhje e grupit përfaqësues bëhet në këtë mënyrë.

Shembull: *Niveli i kënaqësisë në punë i mësimitdhënësve të shkollës fillore sot në Kosovë.*

Grupi i rastit: Shënohen të gjithë emrat e mësimitdhënësve të shkollës fillore, palosen letrat në mënyrë që të mos shihen emrat, letrat vendosen në një enë, apo hapësirë të madhe, të gjitha letrat trazohen dhe një nga një merret një numër i letrave (emrave), që në fakt e formon grupin përfaqësues.

¹⁶ Më gjerësisht, Bektesh Bekteshi (2005). Statistika elementare, "Libri shkollor", Prishtinë, f. 238-239.

2.2.2. Grupi përfaqësues sistematik

Edhe nga vetë emërtimi i këtij grupi përfaqësues kuptojmë se zgjedhja e rasteve të popullacionit për grupin përfaqësues bëhet sipas një sistemi të caktuar. Grupi përfaqësues sistematik është një mënyrë, në të cilën një pikë fillestare caktohet me anë të një procesi rastësor dhe më pas numri që vjen pas një numri të caktuar x në listë zgjidhet në grupin përfaqësues.

Shembull: Prej listës së mësimdhënësve të shkollës fillore, prej 7000 vetash, dhe grupit përfaqësues 700, seleksionojmë një emër në mënyrë rastësore dhe caktojmë intervalin ($N7000/n700=10$). Pas seleksionimit në mënyrë rastësore dhe më pas caktimit të intervalit, vazhdojmë zgjedhjen e grupit përfaqësues në çdo të 10-in individ që ndodhet në listë. Intervali i grupit përfaqësues në këtë rast është i barabartë me 10. Gjatë përzgjedhjes në këtë mënyrë të grupit përfaqësues duhet të kemi kujdes në respektimin e intervalit, si dhe listimin e individëve (individët duhet të listohen në bazë të rastësisë, jo në bazë të ndonjë cilësie).

2.2.3. Grupi përfaqësues shtresor

Në kërkimet shkencore kemi raste kur nuk mund ta formojmë grupin përfaqësues të rastit, e as atë sistematik, sepse rastet individuale të zgjedhura në këtë mënyrë nuk do t'i shprehin të gjitha karakteristikat që i ka popullacioni i tyre.

Grupi përfaqësues me zgjedhje shtresore është një teknikë, me anë të së cilës përcaktohen nëngrupet nga grupe (shtresa) të ndryshme të paracaktuara, që kanë disa karakteristika të ngjashme. Nëse dëshirojmë të bëjmë një kërkim lidhur me qëndrimin e studentëve ndaj religjionit dhe do të aplikojmë dy mënyrat e tjera të përzgjedhjes, mund të ndodhë që të përfshihen vetëm pjesëtarë të një përkatësie fetare. Për këtë një popullatë ndahet në shtresa që nuk përkojnë me njëra-tjetrën. Më pas përcaktohet madhësia e grupit përfaqësues në secilin nëngrup dhe pastaj aplikohet zgjedhja rastësore në secilin nëngrup. Numri i individëve të përfshirë në grupet përfaqësuese të secilit nëngrup përbën numrin e kampionit total.

Nëse duam të hulumtojmë qëndrimin e individëve lidhur me religjionin, gjatë formimit të grupit përfaqësues shtresor, duhet pasur kujdes që pjesëmarrja e shtresave të jetë në proporcion me shtresat e popullacionit të tyre.

Shembull: Nëse popullacioni i ka 2000 studentë, prej tyre 80 % ose 1600 janë të besimit mysliman, 15 % ose 300 të besimit katolik dhe 5 % ose 100 të besimit ortodoks, atëherë grupi shtresor prej 200 vetash duhet të jetë: 160 myslimanë, 30 katolikë dhe 10 ortodoksë.

2.2.4. Grupi përfaqësues grupor

Në këtë rast njësia primare e grupit përfaqësues nuk është një element individual në popullatë, por një grup elementesh. Rastet individuale që e përbëjnë dukurinë masive shpeshherë janë të shpërndara në tërë territorin e vendit. Shembull i problemit: Respektimi i të drejtave të nxënësve në shkollën fillore ose ngarkesa fizike e nxënësve të shkollës fillore sot në Kosovë. Që të hulumtohen këto probleme me mënyrat e tjera (rastësore, sistematike) do të na binte që në mënyrë të shpërndarë të hulumtojmë nxënës të shumë shkollave të Kosovës, e që do të ishte shumë vështirë të bëhej kërkimi¹⁷.

Për këtë e ndajmë popullacionin në grupe dhe grupet duhet të seleksionohen në mënyrë rastësore dhe me to të formohet grupi përfaqësues për kërkim. Kështu, lidhur me problemin që e cekëm më lart mund të hulumtojmë në 2-3 shkolla në qytet dhe në 2-3 shkolla në fshat. Paralelet dhe klasat e këtyre shkollave, si grupe më të vogla të popullacionit, e formojnë grupin përfaqësues grupor, nëpërmjet të cilit grup e hulumtojmë problematikën dhe respektimin e të drejtave të nxënësve në shkollën fillore.

2.3. Madhësia e grupit përfaqësues (mostrës)

Një pyetje që shpesh bëhet është se sa të mëdha duhet të jenë grupet përfaqësuese të kërkimit¹⁸.

¹⁷ Bekteshi, fq. 241.

¹⁸ Për madhësinë e grupit përfaqësues shih më gjerësisht: Luis Cohen dhe të tjerë (2000), *Research Methods in Education (Metodat kërkimore në shkencë sociale)* fifth edition, London, fq. 93.

Nuk ka përgjigje të qartë për madhësinë e grupit përfaqësues, por kjo varet nga qëllimi i studimit dhe natyra e popullacionit në shqyrtim. Megjithatë, është e mundur të japim disa sugjerime lidhur me këtë çështje. Kështu, madhësia e grupit përfaqësues prej 30 pjesëmarrësve është konsideruar nga shumë njerëz si minimale.

Është shumë me rëndësi për kërkuesin që para çdo mbledhje të të dhënave të dijë llojet e marrëdhënieve që dëshirojnë të eksplorojnë brenda nëngrupeve.

Kërkesat e një numri minimal të rasteve bëhen me qëllim që të shqyrtohen marrëdhëniet midis nëngrupeve, andaj studiuesit duhet të marrin madhësinë minimale të mostrës që do të përfaqësojnë saktë popullacionin.

Një numër i madh i grupit përfaqësues është vështirë të hulumtohet, por edhe një numër shumë i vogël i grupit nuk është përfaqësues për popullacionin.

Madhësia e nevojshme e mostrës për të përfaqësuar vlerat e një variable të caktuar varet edhe nga madhësia e popullsisë dhe niveli e heterogjenit në popullatë.

Në përgjithësi, për popullsinë e heterogjenit të madh duhet të merret numër më i madh i individëve të grupit përfaqësues.

Madhësia e grupit përfaqësues me probabilitet mund të përcaktohet në dy mënyra, ose nga studiues që ushtrojë kujdes që të sigurojë se modeli i përfaqëson tiparet më të gjëra të popullacionit me numrin minimal të rasteve, ose duke përdorur një tryezë, e cila, nga një formulë matematikore, tregon madhësinë e duhur të një madhësie.

Shembull: Përcaktimi i madhësisë së një mostre të rastit¹⁹

N	S	N	S	N	S
10	10	220	140	1200	291
15	14	230	144	1300	297
20	19	240	148	1400	302
25	24	250	152	1500	306
30	28	260	155	1600	310
35	32	270	159	1700	313
40	36	280	162	1800	317
45	40	290	165	1900	320
50	44	300	169	2000	322
55	48	320	175	2200	327
60	52	340	181	2400	331
65	56	360	186	2600	335
70	59	380	191	2800	338
75	63	400	196	3000	341
80	66	420	201	3500	346
85	70	440	205	4000	351
90	73	460	210	4500	354
95	76	480	214	5000	357
100	80	500	217	6000	361
110	86	550	226	7000	364
120	92	600	234	8000	367
130	97	650	242	9000	368
140	103	700	248	10000	370
150	108	750	254	15000	375
160	113	800	260	20000	377
170	118	850	265	30000	379
180	123	900	269	40000	380
190	127	950	274	50000	381
200	132	1.000	278	75.000	382
210	136	1.100	285	100,0000	384

¹⁹ Po aty.

Madhësia e grupit përfaqësues në bazë të gabimit

Gabimi i mostrës 5 % në nivelin 95 % Gabimi i mostrës 1 % në nivelin 99 %		
N	S (5 %)	S (1%)
50	44	50
100	79	99
200	132	196
500	217	476
1000	278	907
2000	322	1661
5000	357	3311
10000	370	4950
20000	377	6578
50000	381	8195
100000	383	8926
1000000	384	9706

N- Madhësia e popullacionit

S- Madhësia e grupit përfaqësues

Nëse kërkuesi zgjedh cilëndo prej këtyre mundësive të gabimit për të formuar grupin përfaqësues, duke respektuar të gjitha parimet dhe kriteret e parapara, konsiderojmë se grupi përfaqësues do të jetë mjaft përfaqësues për popullacionin.

Një sqarim lidhur me mundësinë e gabimit 5 % dhe 1 %. Sa më i saktë që dëshirojmë të rezultojë kërkimi, aq më i madh duhet të jetë numri i pjesëmarrësve në kërkim.

Shiko krahasimin në tabelë, ndërmjet mundësisë së gabimit 5 % dhe 1 %.

2.4. Statistika e grupit përfaqësues

Grupi përfaqësues zakonisht përzgjidhet sipas formulave statistikore. Mesatarja i ka dy synime: përshkruan vlerën që është tipike për një grup të

numrave dhe është vlere më e mundshme që do ta fitoni po të zgjidhni një numër nga një grup numrash.

Identifikimi i popullatës së caktuar

Popullatat janë grupe të njerëzve të përcaktuara për studim dhe definohen sipas karakteristikave të veta. Sipas gjinisë, arsimimit, vendbanimit etj.

Popullata, nga e cila zgjidhet grupi përfaqësues, mund të jetë e definuar (e kufizuar) dhe e padefinuar (e pakufizuar).

E definuar (në kohë dhe sasi), p.sh. nxënësit e klasës së dytë të shkollës fillore në komunën e Lipjanit në vitin shkollor 2012/2013.

E padefinuar, p.sh. nxënësit e klasës së dytë.

Një problem që i përcjell vazhdimisht kërkuesit e rinj është se çfarë madhësie të grupit përfaqësues të zgjedhim, apo sa të vogël ta zgjedhim atë.

Ndërlíkueshmëria është te grupi përfaqësues, i madh dhe i vogël, sepse numri që e veçon të madhen nga e vogla është numri 30.

Është e preferueshme që grupi përfaqësues të ketë besueshmëri statistikore dhe të jetë sa më e vogël vlere e gabimit, sepse sa më i vogël të jetë grupi përfaqësues aq më e madhe do të jetë mundësia e gabimit.

Sa më i madh që të jetë grupi përfaqësues, mundësia e gabimit është më e vogël, ndërsa saktësia më e madhe. P.sh., nëse popullacioni është i përbërë nga 5000 subjekte, grupi përfaqësues zgjidhet 500, pra 10 %, dhe është i mjaftueshëm, ose bazohemi në tabelën e lartcekur.

Kujdes, llojet e analizave që i bëni e diktojnë madhësinë e grupit përfaqësues.

Një nga faktorët që mund të ndikojë në madhësinë e grupit përfaqësues është edhe lloji i të dhënave. Varësisht nga lloji i të dhënave që duhet të grumbullohen, ato ndahen në:

- Kategorike, që nuk ndryshojnë shumë me kalimin e kohës;
- Numerike, të cilat mund të ndërrojnë me kalimin e kohës (mund të jenë diskrete dhe të vazhdueshme).

Po ashtu, ato mund të diktohen nga:

- Numri i popullacionit;
- Niveli i besueshmërisë së të dhënave (zakonisht 95%);
- Intervali i konfidencës /toleranca e gabimit (zakonisht 3-5%).

Problemet që hasen gjatë përzgjedhjes së grupit përfaqësues:

Grupet e mëdha kërkojnë më shumë mjete, kohë dhe buxhet, ndërsa kur zgjedhim një grup të vogël studimi nuk mund të kryhet siç e keni paraparë. Procedurat analitike mund të jenë jovalide dhe jo të besueshme, rezultatet e fituara mund të jenë të atilla që nuk mund t'i gjeneralizojmë dhe të themi se vlejné për popullata të mëdha dhe disa probleme nuk mund të hulumtohen me grup përfaqësues të vogël.

Ka disa arsye pse zgjidhen grupet përfaqësuese.

Grupi përfaqësues është model i zvogëlimit në përpjesëtim të caktuar të popullacionit:

1. Sigurimi i mbledhjes së informatave për kërkim, zakonisht kërkuesit zgjedhin diku 1.000 njerëz në vend të 3 milionë njerëzve, sepse është më ekonomike;
2. Sigurimi i përfaqësimit kualitativ të karakteristikave të popullatës;
3. Kontrollimi i faktorëve të huaj për fokusin e kërkimit.

Përfundimisht, gjatë përzgjedhjes së grupit përfaqësues (të madh ose të vogël) është me rëndësi identifikimi i qëllimit të tij, definimi i limiteve dhe kufijve të buxhetit, metodologjisë së grupit përfaqësues, popullatës së caktuar dhe përcaktimit të madhësisë minimale të mostrës së nevojshme, gjithnjë për të krijuar mundësi për një analizë të besueshme, valide dhe relevante.

VI. ETIKA HULUMTUESE DHE CILËSITË E HULUMTUESIT

1. Etika hulumtuese

Çka nënkuptojmë me etikën hulumtuese?

Etika është një parim moral, ose një kod i sjelljes, i cili mbikëqyrë... se çfarë bëjnë njerëzit. Ajo merret me mënyrën se si njerëzit veprojnë ose sillen.

Termi 'etikë' në hulumtim zakonisht u referohet parimeve morale, udhëzimeve në kërkim, të bëra nga një grup apo edhe një profesion (edhe pse nuk ka asnjë arsye logjike pse individët nuk duhet të kenë kodin e tyre etik). (Wellington, 2000: 54).²⁰

Etika hulumtuese ka të bëjë kryekëput me punët e kërkuesit, gjatë zbatimit të procedurës së parashtrimit të pyetjeve, trajtimit të përgjigjedhënësit, respektit dhe ruajtjes së anonimitetit.

Gjatë kërkimeve shkencore duhet të kemi parasysh se ekziston një etikë hulumtuese, e cila duhet të respektohet. Jo vetëm diçka që ndodh në fillim të një projektit hulumtues, para punës në terren (Lewis, 2004).

"Parimet etike duhet të jenë në ballë të çdo projekti hulumtues dhe duhet të vazhdojnë deri në përfundim të hulumtimit" (Wellington, 2000: 3).

Për etikën e kërkimit një autor amerikan thotë: "Unë kurrë nuk kam njohur një intervistues, i cili është plotësisht i sinqertë me të intervistuarit e tij, megjithatë kërkuesi gjithnjë duhet të mbajë në mend se asnjë metodë nuk mund të jetë plotësisht e sigurt për të apo të intervistuarit e tij. (Humphreys, 1970).

Kërkuesit duhet të ndërmarrin hapat e nevojshëm, me qëllim që të gjithë pjesëmarrësit në kërkim të kuptojnë procesin në të cilin po përfshihen, si dhe pse është e nevojshme pjesëmarrja e tyre, si do të përdoren të dhënat dhe kujt do t'i raportohen.

"Një grup mësimdhënësish të përfshirë në procesin e kërkimit që ka të bëjë me rikonfigurimin e plan-programit duhet patjetër të informojnë drejtuesit e shkollës për qëllimet e tyre." (BERA 2004, p. 9)

²⁰ Kjo dhe referencat e mëposhtme janë shembull i referencave që hasen zakonisht në burimet amerikane, si referenca më praktike, me të dhëna më të pakta.

Së pari, duhet të pajtohet përgjigjedhënësi se pranon të përgjigjet në pyetjet që i parashtrohen për gjëra të ndejshme, por më së miri është që ky pajtim ose leje të merret me shkrim, sepse ndryshe rezultatet nuk pranohen.

Po që se nuk e respektojmë etikën hulumtuese, nuk kemi bërë asgjë me vlerë shkencore.

Gjatë realizimit të hulumtimit kërkuesi duhet të ketë përgjegjësi profesionale, të shmangë shfrytëzimin e pjesëmarrësve të kërkimit, sidomos në rastet kur ai mund të jetë i dëmshëm për ta.

Kërkuesi duhet të ketë informacione mbi:

- Legjislacionin e mbrojtjes së të dhënave;
- Një fletë-informacion mbi kërkimin bazik;
- Një formë pëlqimi për pjesëmarrje në kërkim;
- Formularët përkatës;
- Shqyrtimin e procedurave të etikës hulumtuese;
- Shqyrtimin e procedurave të etikës hulumtuese për studimet në edukim.

Nëse jeni udhëheqës i projektit hulumtues dhe do të punoni edhe me hulumtues të tjerë, atëherë nga hulumtuesit e tjerë kërkohet:

- Të lexojnë në lidhje me çështjet etike;
- Të diskutojnë implikimet etike të kërkimit të tyre me mbikëqyrësit;
- Të dërgojnë një propozim të etikës së kërkimit për shqyrtim dhe kjo duhet të përfshijë:
 - Një deklaratë të kompletuar të etikës së kërkimit;
 - Një deklaratë të shkurtër se si ata propozojnë për t'iu qasur pjesëmarrësve të kërkimit;
 - Një fletë-informacion;
 - Një formë pëlqimi;
 - Nënshkrimet e kërkuesit dhe të mbikëqyrësit;
 - Propozimin se është miratuar ose është kërkuar nga studenti ta rishikojë dhe ta dorëzojë.

Kujdes: Kërkuesit që ndërmarrin kërkime hulumtuese ku përfshihen fëmijët duhet të marrin leje të posaçme nga prindërit.

Asociacioni britanik për kërkime në arsim (BERA, 2004) konsideron se të gjitha kërkimet arsimore duhet të zhvillohen duke pasur respekt për:

- Personin;
- Diturinë;
- Vlerat demokratike;
- Cilësinë e kërkimit arsimor;
- Lirinë akademike.

Më qëllim të udhëzimit të hulumtuesve drejt një procesi sa më të përshtatshëm, asociacioni paraqet këto përgjegjësi që duhet t'i ketë parasysh kërkuesi gjatë procesit të hulumtimit:

- Përgjegjësitë ndaj pjesëmarrësve në hulumtim;
- Përgjegjësitë ndaj përkrahësve të hulumtimit;
- Përgjegjësitë ndaj komunitetit të hulumtuesve arsimorë;
- Përgjegjësitë për respektimin e parimeve etike-standarde;
- Përgjegjësitë për marrjen e pëlqimit të pjesëmarrësve potencialë.

Studiuesi, gjithashtu, duhet të sigurojë informacion të saktë në lidhje me:

- Qëllimet dhe natyrën e kërkimit;
- Identitetin dhe detajet kontaktuese të studiuesve;
- Kohëzgjatjen e kërkimit dhe kohën e përfshirjes së tyre;
- Kush do ketë qasje në të dhëna dhe si do të ruhen ato;
- Pasojat e mundshme të pjesëmarrjes dhe të kërkimit;
- Nëse pjesëmarrësit do të kenë të drejtën të shohin transkriptet, apo të komentojnë mbi analizën e të dhënave të përkohshme;
- Si do të bëhet shpërndarja e rezultateve;
- Shkallën në të cilën konfidencialiteti dhe anonimiteti do të mbrohen.

Parimet etike, standardet/obligimet ndaj pjesëmarrësve të kërkimit:

- E drejta e pjesëmarrësve të tërhiqen nga kërkimi;
- Konfidencialiteti - kërkuesit e dinë se kush ua ka ofruar të dhënat, por ata nuk duhet ta bëjnë këtë publike;
- Anonimiteti;
- Të mos jetë i mundur gjurmimi;
- Mbrojtja e mirëqenies së pjesëmarrësit - d.m.th. të sigurohemi se pjesëmarrësi nuk do të dëmtohet nga kërkimi;

- Respekti për privatësinë e pjesëmarrësit;
- Ndjeshmëria për dallimet që lidhen me moshën, racën, kulturën, njerëzit me aftësi të kufizuara, gjininë, religjionin dhe orientimin seksual.

Përveç tjerash, kërkuesi, gjatë punës kërkimore-shkencore, duhet të ketë parasysh edhe disa çështje të tjera, që kanë të bëjnë me individët e përfshirë në kërkim, të cilat janë:

❖ *E drejta për të mos marrë pjesë në studim*

Çdo qytetar ka të drejtë që të mos marrë pjesë në një kërkim të organizuar nga një person, grup apo institucion. Kjo është e drejtë themelore e secilit njeri dhe duhet të respektohet nga të gjithë kërkuesit.

❖ *E drejta për privatësi*

Qytetari mund të pranojë të marrë pjesë në një studim, mirëpo atij duhet t'i respektohet e drejta për privatësi. Është e drejtë e të gjithëve që të mbahet e fshehtë ndonjë informatë, p.sh. orientimi seksual.

❖ *E drejta e anonimitetit*

Të gjithë pjesëmarrësit në një kërkim kanë të drejtë të mbeten anonimë. Çdo person i përfshirë në kërkim ka të drejtë të këmbëngulë që emri i tij të mos paraqitet në studim. Kjo është shumë e natyrshme, pasi nuk duhet të interesohemi për emra, por për çështjen e studimit dhe nuk është me rëndësi emri i personit që është i përfshirë në studim, përjashtimisht në rastet kur jemi duke hulumtuar për shpeshësinë e emrave, apo diçka të ngjashme.

❖ *E drejta për konfidencë*

E ngjashme me çështjen e privatësisë është edhe çështja e konfidencës. Është e drejtë e çdo pjesëmarrësi në kërkim që të dhënat e nxjerra nga kërkimi të trajtohen me konfidencë. Mënyra më e mirë për të bërë këtë gjë është që studiuesi në vend të emrave të përdorë numra.

2. Cilësitë e hulumtuesit

Që të merresh me kërkime shkencore duhet të kesh edhe disa cilësi, të cilat nuk mund t'i ketë çdo njeri:

- Kërkuesi duhet të ketë vetëmotivim për punë shkencore.- Në punën shkencore në shumë raste nuk ka stimuj të mjaftueshëm, as në aspektin material dhe as në atë moral;
- Kërkuesi duhet të jetë këmbëngulës.- Puna hulumtuese nuk është edhe aq e lehtë për t'u bërë, pasi që gjatë kësaj pune na dalin shumë barriera, mirëpo ne duhet të jemi shumë të vendosur dhe këmbëngulës në misionin tonë;
- Kërkuesi duhet të jetë edhe i moralshëm.- Gjatë punës hulumtuese ndodh që në disa raste duhet të mbahen disa të dhëna konfidenciale, andaj kërkuesi duhet t'i përmbahet këtyre kërkesave;
- Kërkuesi duhet të jetë korrekt.- Të dhënat e nxjerra nga kërkimi ndonjëherë nuk janë ato të priturat, mirëpo ne duhet të jemi korrektë dhe mos t'i shtrembërojmë këto të dhëna.

VII. FAZAT E KËRKIMIT SHKENCOR

Një kërkim shkencor duhet të kalojë nëpër disa faza, të cilat duhet të jenë të qarta dhe të analizuara mirë.

Fazat e kërkimit shkencor përmbajnë të gjithë hapat, sipas të cilëve do të zhvillohet kërkimi prej fillimit deri në fund, procedurë kjo që ndryshon në qasjen sasiore dhe qasjen cilësore të projekteve kërkimore, por ndryshon edhe nga trajtimi që i kanë bërë autorë të ndryshëm. Këta hapa ndryshojnë në varësi të llojit të studimit.

Në këtë përfshihen edhe supozimet dhe limitet e kërkimit. Një supozim është një 'fakt' që supozohet të jetë i vërtetë, por nuk është verifikuar ende si i tillë, ndërkohë që limitet janë aspekte të veçanta të kërkimit, për të cilat kërkuesi është i vetëdijshëm që mund të ndikojnë në rezultatet e kërkimit.

Fillimisht, fazat e kërkimit shkencor mund t'i ndajmë në tri grupe:

- Faza përgatitore: qartësia e synimit dhe qëllimit;
- Faza operative: rrugët, ecurinë dhe mjetet që nevojiten për arritjen e tij;
- Faza analitike: analiza e faktorëve dhe veprimtarisë hulumtuese në tërësi.

Nga këto tri faza bazë dalin edhe fazat e specifikuara, nëpër të cilat duhet të kalojë një kërkim shkencor:

- Zgjedhja e temës për kërkim-përcaktimi i problemit;
- Shqyrtimi i literaturës;
- Ndërtimi i hipotezave - çfarë synon të provosh, lidhja mes variablave;
- Zgjedhja e metodologjisë-metodave instrumenteve, teknikave;
- Shkrimi i projektit - plani konkret i temës;
- Mbledhja e fakteve (materialit) - mblidh dhe regjistro të dhënat;
- Përpunimi i fakteve (materialit);
- Interpretimi i rezultateve - përpuno rezultatet e mbledhura;
- Të shkruarit e raportit të kërkimit - cila është rëndësia e tyre;
- Përgatitja e punimit për botim;
- Zbatimi i rezultateve në praktikë.

1. Zgjedhja e temës për kërkim

Çështja e parë që ka të bëjë me fillimin e kërkimit është zgjedhja e temës. Idenë tuaj mbi temën duhet ta shkruani në formë të një teze.

Identifikimi i problemit hulumtues

Kërkuesit me përvojë theksojnë se pjesa më e vështirë është të ngushtohet fusha e studimit dhe të përcaktohet problemi i kërkimit (është me rëndësi të bëhet një dallim midis problemit dhe problemit të kërkimit).

Problemi është një mospërputhje apo zbrazëti midis asaj që dihet dhe asaj që nuk dihet, në mes të asaj si qëndrojnë gjërat dhe asaj se si duhen të jenë, ose në mes të dy çështjeve apo problemeve të lidhura potencialisht ndërmjet vete.

Pra, kur si hulumtues e identifikojmë problemin, interpretojmë zbrazësinë, duke u bazuar në të vërejtur ose observime.

Ndërsa, problemi i kërkimit është gjykimi i përpiluar nga interpretimi i zbrazësisë.

Në mënyrë specifike mund të themi se ky proces kalon në disa hapa:

- Hapi i parë është çka në të vërtetë dëshirojmë të hulumtojmë, nëse qëllimi i kërkimit është plotësimi i nevojave tuaja për kryerjen e kërkimit.
- Hapi i dytë, apo qëllimi i dytë, është kontributi për shkencën.
- Hapi tretë, apo qëllimi tretë, është plotësimi nevojave të agjencisë ose institucionit që e financon kërkimin.

Në mënyrë më të përgjithësuar mund të themi se gjatë zgjedhjes së temës për kërkim duhet pasur parasysh këto gjëra:

- Tema të formulohet qartë dhe në mënyrë specifike (sepse mos-specifikimi i titullit të temës mund të ketë pasoja në mbledhjen dhe interpretimin e të dhënave, si dhe vlerësimin e temës nga të tjerët);
- Të jetë e re, ose temë që nuk është ndriçuar sa duhet dhe si duhet;
- Të ketë një peshë të caktuar teorike dhe praktike (interes) për të tashmen dhe të ardhmen (analizojeni atë, duhet të hulumtohet për ato që s'janë thënë ose thuhën në një këndvështrim tjetër);

- Tema të jetë sa më e ngushtë, e kufizuar në pikëpamje kohore dhe në një problem.

1.1. Rëndësia e formulimit të titullit të temës

Pavarësisht llojit të kërkimit, titulli duhet të jetë i qartë, i saktë në aspektin përmbajtjesor dhe gjuhësor, specifik në përmbajtjen e tij, informativ, domethënës, tërheqës, aktual dhe etik. Rekomandohet të jetë sa më i shkurtër dhe të përshkruajë sa më qartë që të jetë e mundur qëllimin e kërkimit.

Formulimi i problemit për kërkim dhe përcaktimi i titullit shpesh është më esencial edhe se vetë kërkimi, prandaj tema duhet të formulohet në mënyrë sa më të saktë.

Karakteristikat që duhet të merren parasysh gjatë zgjedhjes së titullit:

- Të jetë aktual, një problem - çështje aktuale;
- Të jetë me interes shkencor;
- Të jetë i ndërlidhur me afinitetin personal të kërkuesit;
- Të ekzistojnë mundësitë materiale dhe metodologjike për realizim.

1.1.1. Ndikimi i faktorëve objektivë dhe subjektivë në përzgjedhjen e temës së kërkimit

Mundësia e realizimit të një kërkimi që dëshironi ta kryeni varet shpeshherë nga faktorët objektivë dhe subjektivë që ju i keni në dispozicion.

Që kërkimi të japë rezultatin e dëshiruar varet në radhë të parë nga faktorët subjektivë, ku hyjnë: aftësitë, profesionalizmi, sfondi akademik i kërkuesit etj.

Kërkuesi paraprakisht duhet të vendosë:

- Të jetë i pavarur, apo i përfshirë;
- Të krijojë kampion të madh, apo të vogël;
- Të verifikojë një teori, apo të krijojë një teori;
- Të kryejë një eksperiment laboratorik, apo të punojë në terren;
- Të merret me verifikim, apo me falsifikim.

Faktorët objektivë janë faktorët e imponuar nga jashtë, që ndikojnë në zgjedhjen tuaj:

1. Kërkimi të jetë brenda një buxheti të ndarë për kërkim - mundësitë financiare;
2. Kërkimi mund të realizohet me mjetet që i keni në dispozicion - kushtet e punës në zyrë.

1.2. Disa veçori që e kushtëzojnë zgjedhjen dhe përcaktimin e temës së kërkimit:

- *Sa është tema e kërkimit risi?* Gjatë zgjedhjes së problemit të kërkimit është e rekomandueshme që të eliminohen përsëritjet e kërkimeve tashmë të zhvilluara, përveçse në rastet kur duam të vlerësojmë nëse të arriturat/rezultatet e atyre kërkimeve janë të vlefshme edhe në kohën aktuale. Çdo kërkim i ri duhet të përmbajë në vete risi në teorinë që e përfaqëson, duke përmirësuar këtë teori, apo duke ofruar zgjidhje të reja për probleme të ndryshme.
- *Sa është e rëndësishme tema?* Kërkimet e ndryshme kanë peshë, arsyeshmëri dhe zbatueshmëri të ndryshme në hapësirë dhe kohë të caktuar, prandaj njohja dhe vlerësimi i drejtë i kësaj duhet pasur parasysh në zgjedhjen e temës së kërkimit.
- *Sa ka interes kërkuesi për problemin?* Secili kërkim është një proces që shoqërohet me vështirësi të ndryshme, shpeshherë të paparashikuara, të cilat një hulumtues me interesim jo të mjaftueshëm për temën që e ka zgjedhur mund ta detyrojnë të heqë dorë nga kërkimi i tij.
- *Mundësitë e realizimit dhe aftësia profesionale.* Meqenëse secili prej nesh e zgjedh temën e tij të studimit nga fusha përkatëse e përgatitjes së tij profesionale, niveli i kësaj përgatitjeje është i shoqëruar ngushtë me karakteristikat e një kërkuesi shkencor, si: dëshira, këmbëngulja, vullneti, ambicia etj., prandaj shpesh shihen si elemente të rëndësishme në zgjedhjen e temës së kërkimit
- *Koha e kërkimit.* Kërkimi ka nevojë për kohë të mjaftueshme, të cilën shpesh mund ta planifikojmë, por shpesh kërkimi mund të

kërkojë më tepër kohë, të cilën kërkuesi duhet ta respektojë dhe ta ketë parasysh në zgjedhjen e temës së tij të studimit.

- *Aktualiteti i rezultateve të kërkimit.* Mund të ndodhë që kur e bëjmë publikimin e rezultateve të kërkimit ato nuk janë më aktuale, sepse procesi që kemi hulumtuar tashmë ka përfunduar.

2. Përcaktimi i detyrave të kërkimit

Hapi i parë pasi keni vendosur për temën është vendosja e detyrave që rrjedhin nga qëllimi i kërkimit.

Përcaktimi i detyrave të kërkimit e largon konfuzitetin në mendjen tuaj, sepse e dini saktësisht çka dëshironi të arrini ose të vlerësoni në fund, e që ka rrjedhur si rezultat i procesit hulumtues.

Duhet të keni parasysh se detyrat e kërkimit janë kritere synuese, por edhe kritere realizuese.

Janë kritere synuese sepse disa nga to shpeshherë edhe nuk mund të realizohen pjesërisht apo tërësisht.

Me një përshkrim specifik mund të themi se:

- Kërkuesi duhet të dijë saktë cili është qëllimi i kërkimit të tij;
- Cili është objekti i kërkimit, (p.sh. të vlerësohen nxënësit, mësimdhënësit, apo programet etj.);
- Cila është rëndësia e kërkimit;
- Sa është e lehtë (vështirë) të kryhet kërkimi;
- Kërkuesi duhet të dijë saktë cilat informata i duhen që me anë të kërkimit (teknikave, instrumenteve) të përfitojë informata të duhura për temën;
- Kërkuesi duhet të dijë saktë se me cilat metoda mund t'i nxjerrë të dhënat;
- Kërkuesi duhet të dijë saktë çfarë detaje i nevojiten për kërkim;
- Kërkuesi duhet të dijë saktë çfarë detaje i nevojiten që t'i paraqesë në raportin e kërkimit.

3. Përcaktimi i objektivave të kërkimit

Objektivat e kërkimit shkruhen në mënyrë të përmblodhur, të cilat e plotësojnë qëllimin kryesor të tij. Objektivat e përgjithshme ose specifike shkruhen në paragrafë të veçantë, në funksion të qartësisë së përmbajtjes së tyre.

Objektivat e përgjithshme janë pohime më të gjera, të cilat e zërthejnë realizimin e qëllimit të kërkimit.

Objektivat specifike janë pohime, të cilat i referohen aktiviteteve specifike, apo të arriturave specifike të pritura të kërkimit, si rrjedhim i rezultateve empirike.

4. Shqyrtimi i literaturës

Pasi të keni zgjedhur temën e kërkimit, hapi i ardhshëm në këtë proces gjithsesi është gjetja e informatave që përdoren për mbështetjen e kërkimit dhe pasurimin e njohurive për problemin që keni marrë përsipër ta trajtoni. Kjo bëhet duke e përzgjedhur literaturën që do ta shfrytëzoni në kërkim: libra, revista, gazeta, fjalorë etj.

Kur kemi të bëjmë me studime të mirëfillta shkencore, duhet të kemi parasysh që të shfrytëzojmë sa më shumë burime relevante për temën që e kemi për studim. Kryesisht duhet të shërbehemi me artikuj shkencorë, por edhe me tekste që e trajtojnë atë problem. Artikujt shkencorë janë më të përshtatshëm, për shkak se e trajtojnë problemin në mënyrë më specifike, ndërsa tekstet janë më të përgjithshme.

Prandaj, të iniciosh pyetje të reja, të zbulosh mundësi të reja, të shikosh problemet reale nga këndvështrimet e reja, kërkohet imagjinatë krijuese, por njëkohësisht edhe punë të palodhur, lexim të pandërprerë - të qenit në hap me kërkimet apo studimet e fundit në fushën e studimit tuaj.

Që të jetë një kërkim aktiv, një hulumtues mendjehollë bën grumbullimin e literaturës së rëndësishme. P.sh. nga 1000 punime zgjidhen vetëm 100 dhe zakonisht lexohen vetëm abstraktet e tyre dhe nëse ia vlen të merret diçka nga këto, merren si fusnota ose parafrazime dhe futen në punim.

Domosdo duhet të përzgjedhim dhe të analizojmë në detaje studimet e kryera për atë temë, pastaj të konsultojmë libra, revista, gazeta, fjalorë etj., që kanë lidhje me temën e përzgjedhur. Pra, një sintetizim të njohurive të reja dhe në fund një krahasim kritik të tyre.

Pasi të keni hartuar pyetjen e kërkimit, i keni përcaktuar metodat dhe teknikat për mbledhjen e të dhënave, fillimisht duhet ta lexoni literaturën mbi temën, për të marrë informacione dhe për të vlerësuar ato në aspektin kritik. Ky lexim ju ndihmon të fokusoni kërkimin (fokusi i kërkimit përcakton literaturën specifike), të mësoni qasje të ndryshme për kërkim, të familjarizoheni me termat, t'i trajtoni ose përfshini gjetjet nga kërkimet e tjera.

Librat janë pikënisje për shqyrtim të literaturës, por edhe revistat, periodikët, dokumentet zyrtare, ofrojnë këndvështrime të ndryshme për problemin tuaj hulumtues.

Të gjitha këtyre duhet bërë një vlerësim kritik. Së pari, duhet të vlerësohen nëse kanë lidhje me temën, së dyti, duhet të vlerësohet saktësia dhe besueshmëria e tyre (kjo vlen sidomos për dokumentet qeveritare dhe internetin). Në qoftë se ka një numër të madh të literaturës, përcaktoni cilat libra, revista dhe artikuj të tjerë, sipas titullit, e kanë në fokus temën që ju po e hulumtoni. Lexoni abstraktet e tyre, përcaktoni cilat pjesë ose kapituj ju hyjnë në punë dhe lidhen me temën tuaj.

Literatura përdoret gjithashtu edhe gjatë shkrimit të raportit të hulumtimit për të ofruar edhe mendime të tjerëve për pohimet e bëra në kërkim. Ato gjithashtu ju ndihmojnë të vlerësoni kontekstin historik dhe aktual të problematikës që e hulumtoni.

5. Ndërtimi i hipotezave

Hipotezat shkencore ndërtohen pasi që është përcaktuar problemi i kërkimit shkencor dhe janë evidentuar variablat (variabla e varur dhe e pavarur) dhe pasi të jetë shqyrtuar literatura në lidhje me problemin e kërkimit.

Në kërkimin shkencor eksperimental është e domosdoshme që të ketë hipotezë, ndërsa në kërkimet eksploruese (induktive) nuk ka hipoteza.

6. Zgjedhja e metodologjisë

Në këtë fazë të kërkimit përcaktojmë se cilën qasje metodologjike do të zgjedhim. Po ashtu, në këtë fazë i përcaktojmë edhe metodat, instrumentet dhe teknikat e kërkimit shkencor.

7. Qasja në hulumtim

Është me rëndësi që fillimisht të përcaktohet qasja metodologjike e kërkimit. Shqyrtoni mirë strategjitë para se të filloni kërkimin, gjegjësisht cila strategji hulumtuese është më e mirë për ju si hulumtues për përbarimin e kërkimit dhe për vërtetësinë e hipotezës.

Së pari, theksojeni qasjen e ndryshme teorike për temën tuaj nga hulumtuesit e mëhershëm (nëse dëshironi të keni të njëjtën qasje), përzgjidheni se cilën do ta përdorni në kërkimin tuaj dhe përse? Kjo do t'ju ndihmojë të përcaktoni qasjen që do ta përdorni dhe do t'ju paraprijë të keni kornizën konceptuale për kërkimin tuaj.

Së dyti, përcaktohuni me cilën metodë logjike dëshironi t'i qaseni kërkimit: induktive apo deduktive.

Nëse dëshironi që nga e përgjithshmja të nxirrni një koncept të ri, apo më pak të përgjithshëm, përdoreni deduksionin, si metodë logjike.

Metoda logjike e deduksionit, si qasje në kërkime në shkencat sociale, zakonisht përdoret:

- Për shpjegimin e fakteve, faktorëve;
- Për parashikimin e ngjarjeve të ardhshme;
- Për zbulimin e fakteve dhe të ligjshmërive të reja;
- Për dëshmimin e tezave të shtruara;
- Për vërtetësinë e hipotezave;
- Për ligjërime shkencor.

Nëse dëshironi që nga e veçanta dhe e pjesshmja të nxirren përfundime të përgjithshme, përdoreni induksionin, si metodë logjike.

Në përgjithësi, metoda logjike induktive në kërkimet në shkencë sociale përdoret kur gjatë kërkimeve i përzgjedhim metodat hulumtuese: të vëzhgimit, të eksperimentit, statistikore (mesatarja, mediana, moda).

Mënyra më e thjeshtë për të përcaktuar se një kërkim është sasior apo cilësor është formulimi i pyetjes së kërkimit, metoda e përzgjedhur për mbledhjen e të dhënave dhe metoda që do ta shfrytëzoni për analizën e të dhënave. Këto përcaktojnë se kërkimi është cilësor ose sasior.

8. Përshtatja e metodave (cilësore ose sasore) të kërkimit

Për nga natyra e kërkimit, sasior dhe cilësor (pra për nga orientimi ndaj fenomeneve që studiohen).

Përshtatja e metodologjisë së kërkimit me kërkesat e qëllimit të kërkimit është një nga “sekretet hulumtuese” më të rëndësishme. Kjo përshtatje duhet të fillojë nga tema, sepse tema e zgjedhur e përcakton edhe metodologjinë që do të përdoret gjatë kërkimit.

Pasi të keni përzgjedhur temën, qëllimin dhe detyrat e kërkimit, vjen momenti për të vendosur se cilat metoda, teknika dhe instrumente do t’i përdorni për kërkimin tuaj. Pra, të përzgjedhim një aparaturë të mirë metodologjike për kërkim, ngase përzgjedhja e metodave kërkimore është puna më e rëndësishme gjatë kërkimit.

Në rastet kur tema e kërkimit është kryesisht *teorike* dhe nuk kërkon metoda empirike, kërkuesi kryesisht përdor grumbullimin dhe përzgjedhjen e materialit: literaturës, dokumenteve dhe fotografive, dhe përshkrimin e materialit të grumbulluar (theksi vihet në idetë, format, historinë etj).

Metodat që do të zbatohen (historike, krahasuese, fenomenologjike etj).

Në rastet kur tema e kërkimit kërkon *metodologji empirike*, ajo përfshin një përshkrim të kampionit të përzgjedhur, instrumentet e matjes dhe procedurat e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave:

- Çfarë lloj kampioni do të përdoret, karakteristikat dhe parametrat kryesorë?
- Instrumentet matëse: kush i ka zhvilluar ato dhe kur?
- Procedurat dhe kushtet e mbledhjes së të dhënave; metodat e përdorimit.

- Përpunimi statistikor (përse, cilat hipoteza do të vërtetohen?).

Përzgjedhja e metodave dhe instrumenteve varet edhe nga:

- Pyetja e kërkimit;
- Qasja metodologjike që e kemi zgjedhur për ta realizuar kërkimin;
- Lloji i të dhënave që do të mblidhen për të testuar hipotezën ose për t'iu përgjigjur pyetjes së kërkimit.

Metodat cilësore zakonisht zgjidhen kur dëshirojmë të mbledhim dhe përpunojmë të dhëna që janë të pastruara, si: mendime, bindje, rrëfime. Kur pyetja e kërkimit merr përgjigje përshkruese dhe shpjegimi bëhet sipas bindjeve dhe mendimeve të pjesëmarrësve në kërkim, kërkuesi është ai që vendos çfarë do të përfshihet dhe çfarë jo dhe zakonisht nuk përgjithësohen të dhënat.

Metodat sasiore zakonisht zgjidhen kur dëshirojmë të mbledhim dhe të përpunojmë të dhëna që janë të strukturuara, të cilat mund të paraqiten në mënyrë numerike, kur pyetja e kërkimit parashtrohet si hipotezë e testuar dhe mund të testohet përmes numërimit dhe analizës statistikore. Po ashtu, metodat sasiore përdoren kur instrumentet e hulumtimit synojnë ofrimin e të dhënave numerike dhe zakonisht mund të bëhen përgjithësime nga të dhënat.

E rëndësishme është që ato (metodat dhe instrumentet) të jenë të përshtatshme dhe efikase për ndriçimin e problemit ose çështjen që e hulumtoni. Gjithashtu, duhet të dini se secila metodë është e dobishme për një qëllim, por kjo nuk do të thotë se vetëm me përdorimin e një metode mund ta realizoni qëllimin, apo që vetëm ajo është më e mira.

Parimisht, metodat e kërkimit janë rrjedhojë e qëllimit të kërkimit:

- Në rast se qëllimi i kërkimit është të vëzhgojmë, atëherë përdorim metodën e vëzhgimit;
- Në rast se qëllimi i kërkimit është të përshkruajmë gjendjen, atëherë përdorim metodën deskriptive;
- Në rast se qëllimi i kërkimit është të krahasojmë, atëherë përdorim metodën e krahasimit;
- Në rast se qëllimi i kërkimit është të analizojmë, atëherë përdorim metodën e analizës teorike;

- Në rast se qëllimi i kërkimit është të kuantifikojmë, atëherë përdorim metodën statistikore.

Nga kjo del se duhen zgjedhur ato metoda që u përgjigjen sa më shumë qëllimit dhe detyrave të kërkimit.

9. Përzgjedhja e teknikave dhe instrumenteve

Pasi të keni vendosur se çfarë dëshironi të matni, duhet të vendosni se si do ta matni atë dhe cilën teknikë dhe instrument ta përdorni. Është e rekomandueshme të përzgjidhni një teknikë ose kombinim teknikash që mundësojnë të shtrohen pyetje të caktuara - të maten ndryshoret e caktuara që na interesojnë, gjithnjë duke e paraparë se ajo teknikë është e realizueshme dhe e zbatueshme sipas metodologjisë së zgjedhur.

Varësisht nga ajo se me cilin instrument pritet të realizohen kërkimet përzgjidhen teknikat hulumtuese, p.sh:

Nëse kërkimi është i bazuar në anketë, përzgjidhet teknika e anketimit;

Nëse kërkimi është i bazuar në eksperimente, përzgjidhet teknika e eksperimentit;

Nëse kërkimi është i bazuar në të dhënat dytësore, përzgjidhet teknika e mbledhjes së dokumentacionit.

9.1. Hartimi i pyetjeve në pyetësor

Hartimi i pyetësorit është faza më e rëndësishme për fillimin e mbledhjes së të dhënave.

Sa herë t'i shkruani pyetjet, duhet ta dini qëllimin, pse ju duhen dhe çfarë ju hyjnë në punën hulumtuese. Zakonisht, hartimi i pyetjeve bëhet varësisht se çfarë të dhënash kërkoni të siguronin me anë të pyetësorit.

Pra, gjithnjë mendojeni qëllimin e kërkimit:

- Nëse kërkoni të dhëna për njerëz dhe ngjarje, atëherë qëllimi i pyetësorit janë faktet, prandaj hartoni pyetje nga të cilat mund të regjistroni fakte;

- Nëse dëshironi të përshkruani diçka, atëherë qëllimi i pyetësorit është përshkrimi, prandaj hartoni pyetje të cilat mund të vjelin përshkrime të ndryshme;
- Nëse dëshironi të kuptoni se çfarë dinë njerëzit për diçka, atëherë qëllimi i pyetësorit është të masë njohuritë, prandaj hartoni pyetje që do të mund të matin njohuritë e njerëzve;
- Nëse dëshironi të merrni opinionet për diçka nga njerëzit, atëherë qëllimi është të vlerësoni opinionin e njerëzve, prandaj hartoni pyetje për të marrë opinionet e njerëzve;
- Nëse dëshironi të matni qëndrimet e njerëzve, atëherë qëllimi është të vlerësoni qëndrimet, prandaj hartoni pyetje që mund të vlerësoni qëndrimet e njerëzve.

Një pyetësor i mirë duhet të përmbajë një hyrje, një udhëzim se si do të plotësohet dhe të jetë sa më i shkurtër.

Varësisht se në cilën mënyrë (formë) bëhet pyetësori, hartohen edhe pyetjet.

- Pyetësor me intervista ballë për ballë;
- Pyetësor përmes telefonit;
- Pyetësor me vetëplotësim.

Kujdes të veçantë gjatë hartimit të pyetjeve duhet t'u kushtoni edhe përgjigjeve që dëshironi t'i merrni nga përgjigjedhënesit.

Ja disa nga llojet e ndryshme të përgjigjeve që kërkohen nga pyetësorët:

- Sasiore - numri i nxënësve ose numri i mësimdhënësve.
- Kategorike - mosha, profesioni;
- Përgjigje me zgjidhje - po, jo, nuk e di;
- Përgjigje të hapura - me vetë fjalët e të anketuarve;
- Përgjigje sipas rëndësisë - më i rëndësishëm, më pak i rëndësishëm;
- Përgjigje me alternativa - disa alternativa të ofruara, ndërsa u kërkohet të rrumbullakojnë një të njërën nga to.

9.2. Zgjedhja e mostrës për pilot-test

Grupi përfaqësues për pilotim të testit duhet të jetë sa më i afërt me grupin përfaqësues, të cilën do ta zgjidhni për projektin hulumtues, pra një numër të vogël të njerëzve që kanë karakteristika të ngjashme.

Nëse rezultatet ju dalin shumë të ndryshme, atëherë keni gabuar në përzgjedhjen e mostrës për pilot-testim.

Pilotimi i mostrës na ndihmon:

- Të verifikojmë pyetjet;
- Të përmirësojmë formulimin e pyetjeve;
- Të reflektojmë.

Pilotimi i pyetësorit

Pse është me rëndësi të bëhet pilotimi i pyetësorit të testit?

Pilot-testi në një kërkim tregon seriozitetin, praktikitetin dhe variabilitetin e instrumentit që ju do ta përdorni për kërkim. Nga rezultatet e pilot-testit kërkuesi mund të vërejë gabimet që duhet të përmirësohen, dallimet që vërehen nga disa respondentë dhe ndryshimet që duhet t'i bëjë për instrumentin përfundimtar. Pothuajse në çdo kërkim serioz gjithmonë testohet instrumenti për matje.

Zakonisht pilot-testi u jep përgjigje këtyre pyetjeve:

- A është secila pyetje valide;
- A janë të gjitha fjalët të kuptueshme;
- A janë të gjitha pyetjet të interpretuara (kuptuara) njëjtë nga të gjithë respondentët;
- A ka secila pyetje me përgjigje të mbyllura një përgjigje që i përshtatet secilit respondent;
- A krijon pyetësi përshtypje pozitive, të tillë që i motivon njerëzit të përgjigjen në të;
- A janë përgjigjur si duhet në pyetje;
- A sugjeron ndonjë aspekt i pyetësorit anim nga ana e kërkuesit.

9.3. Validiteti i pyetjeve të kërkimit

Në literaturën bashkëkohore kërkuesit rekomandojnë të shikohet edhe validiteti i pyetjeve të instrumentit që do ta përdorni në kërkim. Në vijim po i japim disa mënyra të validimit të pyetjeve.

- Validiteti përmbajtësor është kur ekziston relevanca e pjesëve përbërëse të pyetësorit;

- Validiteti bashkëveprues është kur një pyetje është e krahasueshme me një tjetër dhe që mat në mënyrë valide të njëjtën përmbajtje;
- Validiteti dallues është kur pyetja përdoret për të dalluar një grup nga tjetri. (P.sh., pyetja duhet të dallojë lënien potenciale të shkollës së mesme nga ana e nxënësve që marrin nota të dobëta dhe atyre që marrin nota të mira);
- Validiteti parashikues është kur një pyetje përdoret për të parashikuar një sjellje. (P.sh., testi i arritshmërisë përcakton edhe suksesin në shkollën e mesme);
- Validiteti ndërtues është kur disa pyetje, të cilat lidhen me një çështje, na japin rezultatin e kërkuar. (P.sh., vetëbesimi nuk mund të vlerësohet vetëm me një pyetje, mirëpo me disa pyetje të ndërtuara enkas për ta vlerësuar atë).

9.4. Siguria e pyetjeve të kërkimit

Për të qenë të sigurt për relevancën e pyetjeve për kërkim, me rëndësi janë testimi dhe ritestimi i pyetjeve, si dhe përputhja interne e tyre. Siguria test-ritest d.m.th. aplikimi i testit të njëjtë në dy ose më shumë raste të njëpasnjëshme, duke i vënë rezultatet në lidhje reciproke. Përputhje interne arrihet kur mund të vëmë në korrelacion rezultatet e disa pyetjeve që i përkasin përmbajtjes së njëjtë të shumës së përgjithshme të rezultateve.

9.5. Formatimi (grupimi) dhe renditja e pyetjeve në pyetësor

Grupimi dhe renditja e pyetjeve

Nëse ka shumë pyetje në pyetësor ato mund t'i gruponi. Grupimi i pyetjeve të instrumentit bëhet kur pyetjet janë të ngjashme për nga përmbajtja. Pyetjet themelore, si gjinia dhe vendbanimi, renditen të parat. Pyetja e parë është më e rëndësishmja në kërkim dhe ajo duhet të lidhet gjithmonë me temën. Ajo gjithashtu duhet të jetë interesante dhe e lehtë për përgjigje.

Renditja e pyetjeve

Renditja e pyetjeve më së miri është të bëhet sipas rëndësisë, që do të thotë se pyetjet që shihen nga kërkuesi si më të rëndësishme renditen së pari, pastaj ato më pak të rëndësishme vijjnë në fund.

Zakonisht fillohet me pyetjen e përgjithshme, e ndjekur nga një numër pyetjesh që kanë lidhje me pyetjen kryesore.

Përgatitja e draftit të pyetjeve

Gjatë përpilimit të një pyetëtori duhet të kihet parasysh formulimi i pyetjeve, ngase pyetja e formuluar mirë na siguron informacione të vlefshme për kërkimin e problemit.

Formulimi i fjalive dhe zgjedhja e fjalëve kanë rol vendimtar, andaj gjatë formulimit të pyetjeve duhet të kemi kujdes në këto rregulla:

- Çdo pyetje duhet të drejtohet për një gjendje faktike (pyetje njëdimensionale). Dimensionalitetet e shumta (dy apo më shumë gjendje faktike në një pyetje) çojnë në përgjigje jo të qarta;
- Pyetjet duhet të jenë të baraspeshuara dhe kjo do të thotë të mos ketë vetëm mundësi për përgjigje pozitive apo negative, por të mundësohen të dyja zgjedhjet;
- Pyetjet duhet të jenë të formuluar në mënyrë neutrale, pra të mos përmbajnë prejjudikime;
- Pyetjet duhet të përmbajnë fjalë të kuptueshme dhe të përshtatshme;
- Pyetjet duhet të jenë të shkurtra (përafërsisht 20 fjalë të jenë maksimalisht);

Disa rregulla gjatë parashtrimit të pyetjeve dhe llojit të përgjigjeve që kërkohen:

Gjatë parashtrimit të pyetjeve që kërkojnë përgjigje të hapura (mos e kufizoni përgjigjen, për shembull “çka mendoni ju për ...”), pra te pyetjet e hapura nuk ka nevojë të jepni përgjigje ju.

Gjatë parashtrimit të pyetjeve që kërkojnë përgjigje të mbyllura (shtroni pyetje rreth informacionit specifik, ose kufizoni të intervistuarit në përgjigje faktike në përgjigje po ose jo). Për këtë zgjedhja e përgjigjeve të bëhet me kujdes.

Gjatë parashtrimit të pyetjeve alternative shtroni pyetje që kërkojnë përgjigje, duke zgjedhur njërin nga alternativat e dhëna.

Gjatë parashtrimit të pyetjeve bindëse të pyeturit duhet të bëhet në mënyrë që përgjigjet të jenë njëra ose tjetra, p.sh. çfarë konsiderojnë se është drejt/gabim, gjegjësisht e vërtetë/jo e vërtetë.

Gjatë parashtrimit të pyetjeve që kërkojnë përgjigje rreth sjelljes shtroni pyetje që përqendrohen (me të vërtetë ose qëllimisht) në sjellje, gjegjësisht në veprimet e personave të pyetur.

Gjatë parashtrimit të pyetjeve që kërkojnë përgjigje direkte parashtroni pyetje (p.sh. çfarë mendoni për...?).

Gjatë parashtrimit të pyetjeve që kërkojnë pyetje indirekte pyetjet parashtrohen në një rrugë tjetër, apo tërthorazi (p.sh. pyetjet indirekte kontribuojnë në informacionet që ju nuk do të mund t'i merreni me pyetje direkte).

Rëndësi në përgatitjen e pyetjeve në kërkimet bashkëkohore ka edhe renditja e pyetjeve.

Kërkuesi gjatë renditjes së pyetjeve duhet të ketë kujdes që:

- Pyetjet t'i organizojë në nënseksione që lidhen me temën;
- Të përgatiten pyetjet për kalim nga njëra temë në tjetrën;
- Të përgatitet pyetësi dhe të përpunohen pyetjet.

Renditja e pyetjeve, andaj kërkuesi duhet të ketë kujdes që të:

- Organizoni pyetjet në nënseksione që lidhen me temën;
- Përgatisni pyetjet për kalim nga njëra temë në tjetrën;
- Përgatisni pyetësin dhe përpunoni pyetjet.

Kur kemi mbaruar me renditjen e pyetjeve, detyra në vazhdim është hartimi i pyetësit.

10. Shkrimi i projektit (planifikimi i punës kërkimore: skica, dizajni i kërkimit)

Të gjithë kërkuesit e mirë planifikojnë. Në praktikë kërkuesit e ndiejnë të nevojshme gjithmonë të planifikojnë me kujdes, duke pasur parasysh qëllimin e kërkimit.

Një planifikim skicë e një projekti hulumtues në fakt është një mendim (i shkruar) që ka të bëjë me atë që keni ndërmend të bëni dhe mënyrën se si do ta bëni.

Kohëzgjatja e planifikuar e kërkimit:

Ka të bëjë me përcaktimin e kohës, gjatë së cilës do të ndodhë tërë ecuria e kërkimit.

Kjo periudhë kohore përfshin momentin e fillimit të propozimit tuaj, deri në publikimin apo prezantimin e rezultateve.

Rekomandohet të bëhet një paraqitje tabelore e planifikimit kohor, në të cilën specifikohen aktivitetet e veçanta të kërkimit dhe periudha kur ato duhet të zhvillohen.

Planifikimi kohor është një paraqitje e shkruar e dinamikës së kërkimit që mbulon një periudhë disamujore, e cila përbëhet nga punët, veprimet praktike dhe teorike, të cilat duhet të kryhen nga kërkuesi.

Dizajni i kërkimit është plani mbi atë që dëshiron të bësh, pra ku përfshihen metodat që do të përdorësh, teknikat dhe procedurat për grumbullimin, analizën e të dhënave dhe një skicë për gjithë procedurën që do të ndjekësh për kryerjen e studimit.

Kërkimi duhet të mbështetet në një plan dhe një skicë.

Me skicë të projektit të kërkimit shkencor kuptojmë paraqitjen me shkrim (vizualizimin) e të gjitha veprimeve metodologjike, të cilat i parasheh kërkuesi në lidhje me kërkimin e temës së zgjedhur dhe të formuluar në mënyrë të saktë.

Megjithëse çdo problem kërkimi është unik, ekzistojnë ngjashmëri mes të skicave, që na çojnë drejt hartimit të një skice, e cila përmban:

- Arsyetimin e nevojës teorike dhe praktike;
- Qëllimet kryesore;
- Metodat, instrumentet dhe teknikat e kërkimit;
- Ngritjen e hipotezës;
- Mënyrën e verifikimit të hipotezës;
- Formulimin e ligjshmërive;
- Vlerësimin kritik të rezultateve të kërkimit.

Skica është një parashikim preliminar i punës hulumtuese, por kjo nuk do të thotë se ajo nuk mund të ndryshohet. Nëse gjatë procesit të kërkimit mund

të shfaqen dukuri ose fakte, të cilat nuk kanë qenë të njohura në fillim, mund të ndryshohet skica e projektit.

Para se të filloni të shkruani skicën është mirë të siguronit një platformë sa më të hollësishme. Mjeti më i mirë për të organizuar mendimet në këtë çast është skica. Skica do të ishte një lloj udhërrëfyese gjatë punës suaj.

Udhëzimet për të ndërtuar një skicë:

- Teza të shkruhet në krye të skicës;
- Skica duhet të përmbajë patjetër hyrjen dhe përfundimin;
- Sigurohuni që i gjithë materiali ka lidhje me temën dhe zhvillohet sipas rendit logjik;
- Kontrolloni paragrafët;
- Ruajeni baraspeshën ndërmjet ideve dhe shembujve;

Skica, pra, është një lloj projekti për variantin apo kopjen përfundimtare. Nga skica keni të drejtë të shtoni, të hiqni ose të riorganizoni informacionin para se të arrini në fazën tjetër, të quajtur varianti apo kopja e parë.

11. Mbledhja e fakteve - të dhënave

Pasi janë ndërmarrë hapat e nevojshëm, duke e caktuar drejt e qartë titullin e temës, janë ndërtuar hipotezat e kërkimit, është projektuar ideja se çfarë do të bëhet, janë caktuar metodat, teknikat dhe instrumentet e kërkimit, është bërë edhe një trajtim teorik të problemit, është koha kur duhet t'i përvisheni punës në terren dhe të mblidhen faktet empirike nga instrumentet e kërkimit.

11.1. Zgjedhja e llojeve të të dhënave për t'i mbledhur

Lloji i të dhënave që mblidhen dhe mënyra se si mblidhen ato ndikojnë në mënyrën se si përdoren ato të dhëna në kërkim.

Paraprakisht duhet të dimë çka do të matim dhe si do të matim.

Kur diçka matim, ia përcaktojmë një numër ose një emër.

- ✓ Kur numrat apo fjalët përdoren për të grupuar gjëra, këto të dhëna quhen të dhëna nominale: gjinia, raca, religjioni, vendbanimi etj;

- ✓ Kur numrat përdoren për të renditur një listë të gjërave, kjo e dhënë quhet ordinale (P.sh. renditja e shkollave të mesme profesionale të Kosovës, duke përdorur numra, është e dhënë ordinale);
- ✓ Kur numrat përdoren për të matur (vlerësuar) gjatësinë, peshën, moshën e individëve etj., këto të dhëna janë të dhëna në shkallë ose intervale.

Mbledhja e të dhënave bëhet përmes teknikave dhe instrumenteve të kërkimit, përmes pyetësorëve, intervistave, grupeve të fokusit, vrojtimit, rrëfimit, dokumenteve dhe me anë të komunikimit përmes kompjuterit, telefonit etj.

Varësisht nga lloji i kërkimit, i zgjedhim edhe instrumentet për mbledhjen e të dhënave në terren.

Nuk mund të konsiderohet një studim i mirëfilltë nëse nuk është i bazuar në fakte. Faktet duhet të mblidhen me anë të instrumenteve.

Planifikimi i mbledhjes së të dhënave:

- Mbledhja e të dhënave;
- Analiza paraprake e të dhënave;
- Kategorizimi i të dhënave;
- Përzgjedhja e treguesve më të rëndësishëm;
- Analiza përfundimtare.

11.2. Grumbullimi i të dhënave

Përshkruajeni qartë dhe në detaje mënyrën që do ta shfrytëzoni për sigurimin e të dhënave të projektit tuaj, e po ashtu kohën, vendin dhe nga kush është bërë grumbullimi i të dhënave.

Të gjitha llojet e kërkimeve shkencore kërkojnë dhe përmbajnë mbledhjen e të dhënave. Të dhënat janë pjesë e informacionit që e mbledhim dhe e përdorim për të ekzaminuar një pyetje hulumtuese, apo për të vërtetuar ose rrëzuar një hipotezë të ngritur. Metoda shkencore është e bazuar pikërisht në mbledhjen, analizimin dhe interpretimin e këtyre të dhënave. Ekzistojnë tri rrugë kryesore në grumbullimin e të dhënave kërkimore:

1. Administrimi i një instrumenti të standardizuar;

2. Administrimi i një instrumenti të krijuar nga vetë kërkuesi;
3. Regjistrimi i natyrshëm/regjistrimi i të dhënave tashmë të gatshme.

Ekzistojnë disa qindra instrumente të standardizuara apo jo të standardizuara, të cilat mund të përdoren nga secili hulumtues. Një test i standardizuar quhet ai test që është i administruar, i pikëzuar dhe interpretuar në të njëjtën mënyrë, pavarësisht kur dhe ku është përdorur.

12. Përpunimi i të dhënave (fakteve)

Pas mbledhjes së fakteve në terren, vjen puna në tavolinë, që ka të bëjë me analizën dhe përpunimin e të dhënave. Deklaratat e ndryshme kërkojnë analizë specifike për të gjetur treguesit që na interesojnë.

Përpunimin mund ta bëjmë me anë të programit Exel, mirëpo si program më i përsosur për përpunim të të dhënave është programi SPSS²¹, i cili mundëson që të dhënat e futura në databazë të përpunohen më shpejt.

Paraprakisht duhet të përpilohmë një skemë koduese të dhënash, në shprehje kuantifikuese. Kodimi i informatave është procesi e shndërrimit në një format të kuantifikuar, zakonisht numerik, që të mund të bëhet më lehtë analiza sistematike e tyre.

Procesi i kodimit fillon me kodimin e përgjigjeve paraprakisht, duke mundësuar që numrat të rrumbullakohen ose të shënuar të futen direkt në bazë të të dhënave.

Vlera e të dhënave si numra ose si emërtime varet nga analizat që dëshironi t'i bëni. Nëse jeni duke mbledhur të dhëna kualitative dhe mendoni të bëni analiza përmbajtjesore, atëherë elementet e të dhënave tuaja mund të futen si fjalë ose fraza në vend të numrave.

12.1. Analiza e të dhënave

Procesi i analizës së të dhënave duhet të jetë i qartë në fillim të projektit hulumtues. Analiza e të dhënave ka për qëllim që të përshkruajë, të vlerësojë

²¹ Lidhur me përdorimin e programit SPSS, shih SHTOJCA B.

dhe të shpjegojë karakteristikat e të dhënave, mundësisht për të ardhur në një përfundim për hipotezën ose pyetjen e kërkimit.

Varësisht nga metodologjia dhe instrumentet që janë përdorur për mbledhjen e të dhënave, kemi këto lloje të analizave:

- Statistikore;
- Tematike;
- Të përmbajtjes etj.

Nëse qëllimi i kërkimit është të mbledhim të dhëna sasiore, normalisht se nuk mund të bëjmë analiza cilësore.

Metoda më mirë për analizën e të dhënave është kur ajo është e harmonizuar me parametrat që ju i keni përcaktuar më herët dhe tipin e të dhënave të grumbulluara.

Kur flasim për llojet e analizave mund të kemi edhe:

- Analiza empirike - kur kërkuesi përdor një gjuhë të kuptueshme dhe objektive për të përshkruar dhe shpjeguar realitetin shoqëror. (Mund të jetë kuantitative apo kualitative);
- Analiza normative - kur qëllimi i kërkuesit është vlerësimi subjektiv i vlerave dhe normave që udhëheqin zbatimin e asaj që kemi mësuar/zbuluar nga ai realitet.

Objekti i kërkimit hulumtues në shkencat sociale bazohet mbi të dy llojet e analizës, empirike dhe normative, që të maksimizojë jo vetëm dijen, por edhe të kuptuarit për realitetin edukativ.

Secili projekt kërkimi përmban edhe pjesën e analizimit të të dhënave, në të cilën përshkruhen të gjitha teknikat që do të përdoren për të analizuar të dhënat e mbledhura.

Analiza e të dhënave është një përpjekje e kërkuesit për të përgjithësuar të dhënat e mbledhura në mënyrë të kujdesshme dhe të besueshme, me qëllim të prezantimit të të gjeturave të kërkimit në mënyrë të pamohueshme dhe të padyshimtë.

Ekzistojnë lloje të shumta të analizave

Sipas funksionit gnoseologjik (njohës) ekzistojnë dy lloje të analizave:

1. Deskriptive - kur përshkruhen elementet e ndonjë tërësie;

2. Eksplikative - kur bëhen përpjekje të shpjegohet tërësia e caktuar në bazë të pjesëve të saj.

Sipas ndërlíkueshmërisë analizat mund të klasifikohen në:

1. Elementare - në të cilën gjurmohet për elementet që e përbëjnë tërësinë;
2. Kauzale - në të cilën vërtetohen lidhjet shkak-pasojë;
3. Funksionale - në të cilën analizohen funksionet e elementeve që e përbëjnë strukturën e tërësisë së dukurisë.

Sipas qëllimit të kërkimit kemi këto lloje të analizave:

- Analiza kuantitative - kur nga analiza e fakteve përcaktohen në sasi të caktuara treguesit e vlerës, që mund të krahasohen në mes veti dhe të shpjegohen shkaktarët;
- Analizës kualitative - kur nga analiza e faktorëve mundësohet përcaktimi dhe paraqitja e së vërtetës shkencore.

Faktikisht, këto të dyja gjatë kërkimeve kanë lidhshmëri në mes veti dhe njëra e kompenson tjetrën me specifikat e veta, ose e plotëson.

Analizat kuantitative në edukim

Analizat kuantitative në edukim janë analizat e të dhënave që kodohen si të dhëna numerike.

Analiza e këtyre të dhënave kërkon që hulumtuesi paraprakisht të përcaktojë sistemin e kodimit (futjes së të dhënave në databazë, gjegjësisht në programet kompjuterike statistikore, Exel ose SPSS).

Këto dy programe ia mundësojnë kërkuesit jo vetëm përpunimin dhe analizën e të dhënave, por që ato të dhëna t'i ruajë dhe t'i kopjojë me lehtësi në programin në të cilin e përgatit punimin (Word).

Gjithashtu, analizat kuantitative në edukim mund të bëhen (ilustrohen) me anë të tabelave të ndryshme, grafikoneve të ndryshme, si dhe me anë të korrelacioneve dhe treguesve të tjerë statistikorë.

Në shumicën e kërkimeve aplikohen disa metoda statistikore gjatë analizës së të dhënave. Dy të dhënat statistikore më të rëndësishme në kërkimet në edukim janë: mesatarja dhe devijimi standard.

Mesatarja është njësi matëse e tendencës qendrore (bashkë me medianën dhe modën). Devijimi standard është njësi për matjen e shpërndarjes (bashkë me variancën e kufirit).

Analizat kualitative në edukim

Analizat kualitative në edukim janë analizat e të dhënave që përbëhen nga fjalët dhe vëzhgimet.

Të dhënat analizohen dhe interpretohen në mënyrë që të krijohet një rend dhe kuptueshmëri e tyre, sipas qasjes së përzgjedhur nga kërkuesi, mundësisht sistematike dhe në mënyrë kreative.

Në literaturë nuk ka një mënyrë të vetme të analizës së të dhënave kualitative, për faktin se analiza e të dhënave varet edhe nga pyetja kërkimore që parashtrohet, burimet që shfrytëzohen, si dhe kujt i dedikohet raporti i kërkimit.

Analiza e të dhënave kualitative bëhet kur kemi të dhëna përshkruese, vrojtime, të dhëna nga pyetjet e mbyllura, intervistat, diskutimet dhe bashkëbisedimet në fokus-grupe, ditarët, gazetatat, dokumentet, raportet, tregimet etj.

Procesi i analizës së të dhënave përshkruese

Procesi i analizës së të dhënave përshkruese bëhet duke kaluar nëpër disa hapa, të cilët ndihmojnë që të shpjegohen dhe interpretohen ato.

Hapi i parë - analiza e të dhënave tuaja.

Nëse të dhënat janë shkruar, ato duhet të lexohen dhe të rilexohen në mënyrë që të jenë të qarta, ngase sa më të qarta të jenë të dhënat aq më lehtë do ta keni të bëni analizën e tyre. Pra, analizimi i mirë varet nga kuptimi dhe qartësia e të dhënave.

Nëse të dhënat i posedoni si incizim, në formë audio ose vizuale, ato duhet të dëgjohen/shikohen disa herë dhe gjatë dëgjimit apo shikimit, nëse diçka ju duket e rëndësishme, duhet ta shënoni.

Hapi i dytë - fokusimi i analizës.

Analiza fokusohet atëherë kur kërkuesi e di saktësisht cili është qëllimi i analizës së tij dhe çfarë dëshiron të dijë dhe të kuptojë.

Kjo arrihet atëherë kur ai paraprakisht i ka identifikuar pyetjet (i ka shënuar), së cilave mbi bazën e të dhënave dëshiron t'u japë përgjigje.

Një aspekt tjetër, që ndikon në fokusimin e analizës nga kërkuesit, është edhe mënyra se si do të përdoren rezultatet e kërkimit.

Në literaturë përmenden dy qasje:

1. Fokusimi në një pyetje, temë ose ngjarje.

Kjo qasje e përqendron kërkuesin në analizën e të gjitha përgjigjeve rreth një pyetje, teme ose ngjarje. Zakonisht përdoret kur fletëpyetësi ka qenë i përbërë nga pyetjet e mbyllura.

2. Fokusimi në raste, individë ose grupe.

Kjo qasje e përqendron kërkuesin në analizën e të gjitha përgjigjeve në bazë të rastit (çështjes), individit ose grupit.

Këto dy qasje, analiza e të dhënave sipas pyetjes dhe sipas rastit, çështjes, individit apo grupit, mund të kombinohen nga kërkuesi gjatë analizës së të dhënave kualitative.

Hapi i tretë - kategorizimi i të dhënave.

Nëse gjatë analizës së të dhënave ato i etiketojmë në bazë të vlerave të njëjta dhe ua vendosim një kod, atëherë i kategorizojmë sipas një sistemi të kodimit ose indeksimit. Të dhënat kualitative kërkojnë që gjatë leximit dhe rileximit të dhënat të kategorizohen në mënyrë koherente, me qëllim që t'i japin kuptim tekstit. Ju mund të përdorni shkurtesa në formë kodesh, prej dy ose tri shkronjave, dhe t'i vendosni pranë temës.

Ka dy mënyra për kategorizimin e të dhënave:

1. Kategorizimi prezent - bëhet kur kërkuesi e ka një listë të kategorive të vendosura paraprakisht nga literatura. Pra, ky kategorizim i jep direktivat për të dhënat, të cilat ju i kërkoni.
2. Kategorizimi emergjent - bëhet kur kërkuesi i lexon të dhënat në tërësi dhe pastaj, në bazë të përmbajtjes së tij, i nxjerr temat ose çështjet, të cilat përsëriten në të dhënat tuaja. Pra, kategoritë nxirren ose përcaktohen pasi keni punuar me të dhënat si rezultat i punës.

Nganjëherë kërkuesit i duhet t'i kombinojë këto dy kategorizime. Kjo ndodh sidomos kur kategorizimi ka filluar me kategori aktuale dhe duke i shtuar kategoritë e tjera gjatë procesit të analizës së të dhënave.

Kategoritë kryesore të të dhënave mund të ndahen në nënkategori.

Hapi i katërt - identifikimi i modeleve dhe lidhjeve brenda dhe ndërmjet kategorive.

Pasi kërkuesi të bëjë kategorizimin e të dhënave sipas pyetjes, apo përmes rasteve, ai mund të vërejë modelet dhe lidhjet brenda dhe ndërmjet kategorive. E rëndësishme për analizën e të dhënave në këtë hap është vlerësimi i rëndësisë së temave të ndryshme, si dhe krahasimi dhe nënvizimi i dallimeve delikate.

Hapi i pestë - interpretimi, përmbledhja.

Në këtë hap, kërkuesi duhet të shpjegojë të gjeturat që janë të rëndësishme, të cilat janë rrjedhojë e kategorizimit dhe seleksionimit që quhet interpretim i kuptimit dhe rëndësisë. Pra, në këtë hap kërkuesit i duhet të interpretojë të gjeturat nga kërkimi, duke përshkruar idetë kryesore.

13. Interpretimi i rezultateve

Interpretimi i rezultateve bëhet duke u përpjekur që lexuesi ta ketë sa më të qartë se çfarë rezultatesh janë fituar nga kërkimi. Në këtë fazë, shkruesi i punimit rezultatet e fituara mund t'i paraqesë në tabela, grafikone, por mund të paraqesë edhe të dhëna statistikore.

Përfundimisht, pas prezantimit të rezultateve, ju do të jeni në gjendje të vlerësoni implikimet e tyre për hipotezat që i keni hartuar.

Gjatë interpretimit të të dhënave asnjëherë nuk mund të jemi absolutisht të sigurt se një variabël ka ndikimin kryesor, sepse as që mund t'i vrojtojmë të gjitha rastet. Por, mund të paraqesim shumë sigurt ndikimin e variablës në hipotezën e ngritur, duke e mbështetur në rezultatet e nxjerra. Nëse ato na mundësojnë të verifikojmë hipotezën me saktësi, atëherë ai interpretim është i rëndësishëm.

Kujdes: Gjatë interpretimit të të dhënave nuk duhet të interpretohen të dhënat që nuk përputhen me hipotezën e nxjerrë në mënyrë teorike ose së cilës i referohemi.

Gjithnjë duhet të jemi të hapur dhe të gatshëm për të pranuar qasje të reja për interpretimin e të dhënave.

Shpjegimi i fakteve

Me fakt kuptojmë ekzistencën e njëmendtë të një dukurie, strukture, lidhje, marrëdhënie, cilësie:

- Të konstatuar me anë të shqisave, në mënyrë të drejtpërdrejtë;
- Të aparateve dhe instrumenteve, në mënyrë jo të drejtpërdrejtë;
- Me anë të mendimit logjik, ose me anë të përvojës njerëzore.

Pra, fakt nuk është çdo e dhënë. Fakte janë vetëm ato të dhëna që janë me interes dhe me rëndësi për temën që hulumtojmë dhe që mund të verifikohen ose konstatohen nga të dhënat e dala nga kërkimi.

Faktet paraqesin vetëm lëndën e parë, janë një grup të dhënash të pakuptimta. Detyra e kërkuesit është që t'i shpjegojë, t'i sqarojë ato fakte dhe të ofrojë përgjigje në pyetjet kryesore: pse, për ç'arsye, në ç'mënyrë, në ç'kushte.

Pra, shpjegimi shkencor është domosdoshmërisht i lidhur me ndarje logjike: klasifikim, përfundim, argumentim, përgënjeshttrim dhe përshkrim.

Shpjegimet mund të jenë të llojllojshme, por më kryesoret janë:

- Shpjegimi shkakor, apo kauzal (shpjegim i shkaqeve, për ç'arsye);
- Shpjegimi kushtor, apo kondicional (shpjegon kushtet në të cilat paraqitet dukuria apo procesi i caktuar);
- Shpjegimi teologjik (shpjegon qëllimet dhe caqet e dukurive ose proceseve);
- Shpjegimi funksional (shpjegon mënyrën e funksionimit të ndonjë dukurie).

14. Të shkruarit e raportit të kërkimit

Pas përfundimit të hulumtimit duhet të paraqitet raporti lidhur me rezultatet e kërkimit.

Një raport i mirë i kërkimit mund të jetë vetëm 8 faqe. Për çdo rresht që shkruhet në raport kërkuesi duhet ta pyesë veten a ia vlen të jetë në raport apo jo. Me rëndësi është që raporti të jetë i thjeshtë dhe i kuptueshëm.

Një praktikë për të vlerësuar raportin e kërkimit është që t'u dërgohet ta lexojnë 10 vetave dhe nëse 6 prej tyre e vlerësojnë pozitivisht, atëherë

shkruhet raporti përfundimtar, në kundërtën duhet të modifikohet ose të ndryshohet tërësisht.

Për kërkuesit e rinj vështirësia është kur vjen në pyetje se çka duhet të përfshijë gjatë shkrimit të punimit.

Raporti i kërkimit zakonisht duhet të përmbajë ose të përshkruajë:

- **Titullin** - që duhet të jetë i përshtatshëm, konciz, i saktë dhe nëse është i mundshëm të tregojë, të shpreh përmbajtjen se çfarë flitet në punim (jo gjithmonë titulli i projektit punues). Krahas titullit të gjatë mund të vihet edhe nëntitulli.
- **Përmbajtjen** - në të shkruhen titujt e disa pjesëve të punimit dhe numri përkatës i faqes, zakonisht kapitujt dhe nënkaptujt.
- **Abstraktin** - një abstrakt i mirë është:
 - Korrekt (duhet të siguroheni që abstrakti në mënyrë korrekte të reflektojë përmbajtjen e punimit);
 - Jo vlerësues (duhet të raportojmë në vend se të vlerësojmë, nuk duhet të komentojmë mbi atë se çfarë përmban i gjithë punimi ynë);
 - Koherent dhe i lexueshëm (duhet ta shkruajmë në gjuhë sa më të qartë dhe koncize. Duhet të përdorim folje në vend të emrave dhe duhet të përdorim kohën e tashme për të prezantuar rezultatet, ndërsa në kohën e shkuar përshkruajmë variablat specifike, të manipuluar, apo matjet);
 - Konciz (duhet ta paraqesim sa më shkurt dhe të sigurohemi që secila fjali të jetë informative. Pra, abstrakti duhet të përmbajë konceptet më të rëndësishme.
- **Parathënien** - shënohet çka e shtyn autorin e shkrimit, falënderimet, kufizimet gjatë kërkimit etj.
Kujdes, parathënia dallon nga hyrja.
- **Hyrjen**

Hyrja ka për qëllim të paraqesë çfarë do të ndriçohet, apo të thuhet e re në temën e kërkimit, për çfarë flitet në punim, të saktësojë problemin që dëshironi ta përpunoni, apo të sqaroni:

- Pse ky problem është i rëndësishëm?
- Si ndërlidhet studimi ynë me ato të mëparshmet?
- Si ndryshon studimi ynë nga studimet e mëparshme të të njëjtit aspekt?
- Cilat janë objektivat dhe hipotezat e studimit dhe si ndërlidhen ato me teorinë?
- Si ndërlidhen hipotezat me dizajnimin e studimit?
- Cilat janë implikimet teorike dhe praktike të studimit?

Një gjë duhet të jetë e qartë: hyrja e një punimi shkencor përgatitet pasi të jenë përfunduar të gjitha punët brenda punimit:

- ✓ Qëllimi i kërkimit;
 - ✓ Detyrat e kërkimit;
 - ✓ Mostra e kërkimit;
 - ✓ Metodot, teknikat dhe instrumentet e shfrytëzuara (metodologjia);
 - ✓ Përgjigjet e hipotezës;
 - ✓ Përkruhen të dhënat kryesore të analizuar në mënyrë të duhur, në të cilat janë mbështetur përfundimet.
- **Përpunimin e të dhënave** - duhet të zërë më së shumti hapësirë për paraqitjen e fakteve, vrojtimeve etj.
 - **Pjesën përmbartëse** - duhet të përfshijë pikat kryesore dhe të rezultojë nga rezultatet dhe përfundimet e kërkimit.
 - **Përfundimet**
 - Qëllimi i përgjithshëm i kërkimit është nxjerrja e përfundimeve. Në pjesën e përfundimeve duhet të sqarohen vetëm ato rezultate që janë më të specifikuar dhe nga ato rezultate të qartësohet nëse mbështetet apo jo hipoteza e dhënë në fillim të kërkimit.
 - Ato duhet të jenë të shkruara shkurt (por jo që t'u humbet domethënia), të thuhet ajo që duhet thënë, sipas një rrjedhe logjike, dhe të mos përdoren citate.
 - **Rezy-menë**
 - Rezy-meja zakonisht shkruhet në një gjuhë të huaj dhe ka për qëllim ta njoftojë shkurtimisht opinionin e huaj me përmbajtjen themelore

të kërkimit. Në këtë pjesë mund të shkruhet edhe për perspektivën e çështjes, pyetjet që kanë mbetur ende pa përgjigje.

- **Shtojcën**

- Shtojca zakonisht përmban tabela, pyetësorë etj. Pra, të gjitha materialet e rëndësishme që përdoren gjatë studimit.

15. Përgatitja e punimit për botim

Është faza finale e përmbylljes së punimit, gjegjësisht përgatitjes së punimit për botim.

Rishikimi i punimit

Rishikimi nënkupton një shikim të dytë të asaj që është shkruar. Vlera e rishikimit është se gjatë shkrimit të punimit mund t’ju kenë përvjedhur elemente, të cilat janë gabim ose duhet shkruar me një stil tjetër të gjuhës.

Kjo do thotë ta bësh kërkimin të kuptueshëm nga aspekti gjuhësor, terminologjia profesionale dhe shkencore, sidomos kur e argumentojmë hipotezën dhe i realizojmë detyrat e kërkimit.

Kontrollimi i faktorëve të huaj (anësorë)

Një nga “mjeshtëritë“ e kërkuesit është të jetë i aftë që vazhdimisht të kontrollojë kërkimin. Kontrollimi, apo “pasja në dorë”, nënkupton reduktimin ose eliminimin e efekteve anësore që nuk janë në fokus të kërkimit dhe që mund të ndikojnë në mënyrë direkte ose indirekte në rezultatet e kërkimit.

Eliminimi i elementeve të panevojshme në punimin e kërkimit

Kërkuesi e ka për detyrë që të eliminojë të gjitha fjalët, paragrafët që s’janë të nevojshëm në punim, dhe të paraqesë vetëm argumentet e rëndësishme.

Kërkuesi duhet të heqë të gjitha ato që janë të tepërta, të parëndësishme dhe të përfshijë vetëm ato që janë të rëndësishme dhe që i kontribuojnë ndriçimit të çështjes.

VIII. DISA RREGULLA GJATË SHKRIMIT TË PUNIMIT SHKENCOR

Kur shkruajmë punime shkencore duhet të kemi parasysh se ekzistojnë disa rregulla, të cilave duhet t'u përmbahemi.

1. Hapësira në mes të rreshtave në punim

Kur shkruajmë ndonjë punim shkencor, për shkaqe praktike, është mirë që në mes të rreshtave të ketë një hapësirë, e cila mund të na shërbejë për ndonjë ndërhyrje me laps, por edhe do të duket më bukur punimi. Hapësira dyshe²² do të thotë duke lënë një mes me përmasa të plota bosh në çdo linjë të faqes. Për shumicën e programeve të përpunimit të fjalës kjo do të thotë vendosje e linjës, ndarje në dyshe. Nëse programi juaj specifikon në mes të rreshtave ndarje në aspektin e madhësisë, ju duhet të specifikoni hapësira rresht, që në kompjuterin tuaj mund ta gjeni në pjesën e sipërme ana e djathtë (Line spacing), ose do të vazhdoni me dy shtypje të tastit enter. Në literaturën e gjerë kryesisht pohohet se hapësira në mes të rreshtave duhet të jetë dyshe, mirëpo duke u bazuar në përvojën vetjake, konsiderojmë se hapësira në mes të rreshtave me 1.5 do të ishte më e qëndrueshme edhe në aspektin estetik. Kjo është një distancë e mjaftueshme në mes të rreshtave, pasi që edhe kur printohet teksti është i pranueshëm për syrin.

2. Kufijtë - margjinat

Largohen nga kufijtë e një uniforme së paku 2,5 cm në të majtë, lart, poshtë, dhe në të djathtë të çdo faqe. Në shumicën e programeve fjala e përpunimit, 2,5 cm është e paracaktuar për vendosjen kufijve. Kjo është diferencë minimale për të shkruar udhëzime dhe pyetje. Kufijtë uniformë i ndihmojnë redaktorët të llogarisin kopjet, gjatësinë e artikullit të botuar nga dorëshkrimi²³.

²² Më gjerësisht, Publication manual of the American Psychological Association (2002), Fifth edition, Washington, DC, f. 286.

²³ Po aty, f. 286-287.

3. Kufijtë - margjinat

Forma i referohet modeleve të përgjithshme të përgatitjes së kërkimit. Stili i referohet zbatimit të rregullave të gramatikës, përdorimit të shkronjës së madhe, shenjave të pikësimit, respektimit të standardeve të vendosura për punime të tilla etj.

- Përdoreni gjithmonë dhe pa përjashtim stilin ‘Standard’ në brendinë e punimit tuaj. Mos luani me brendinë e punimit tuaj duke përdorur stile apo fonte të ndryshme për paragrafë të veçantë;
- Shënoni numrat e faqeve, duke respektuar vendosjen e numrit në anën e djathtë të faqes, lart;
- Respektojeni rregullën e stilit ‘Standard’ në shkrimin e shenjave të pikësimit, si ; , ? !] }) etj, sipas të cilit asnjëherë mos përdorni një hapësirë para tyre, por gjithmonë përdorni një hapësirë pas tyre. Gjithashtu, për kllapat hapëse ([{, asnjëherë mos përdorni një hapësirë pas tyre, por gjithmonë përdorni një hapësirë para tyre;
- Përdoreni gjithmonë vetëm një hapësirë përpara dhe pas shenjave;
- Përpquni të shmangni sa më shumë që të jetë e mundur shkrimin brenda kllapave;
- Nëse shkronja e parë e një fjalie është numër, ose nëse ky numër është nëntë e më pak, këta numra zakonisht shprehen me fjalë. Përndryshe numrat janë të gjithë të shprehur si shifra *Arabic* (katër grupe u organizuan; u plotësuan gjithsej 256 pyetësorë);
- Referencat e punimit shkruajini në të njëjtën formë. Ndajini autorët me pikëpresje;
- Çdo referencë juaja që është e shkruar në brendinë e projektit propozimit duhet të jetë edhe në listën në fund të projektit dhe anasjelltas;
- Shkruani qartë dhe saktë, duke dhënë thelbin, esencën e përmbajtjes; Mos përdorni fjali shumë të gjata [rrezikoni të humbni kuptimin e asaj çfarë keni dashur të thoni]. Mundohuni gjithashtu të shmangni dykuptimësinë në fjalët dhe fjalitë që përdorni;
- Madhësia e shkronjave rekomandohet të jetë 12, ndërkohë që largësia midis rreshtave 1.5 dhe mos bëni asnjë ndryshim për ndonjë paragraf.

- Gjerësia e margjinave duhet të jetë e njëjtë në të katër anët e faqes (nëse projekt propozimi lidhet, të llogaritet hapësira që do të zërë lidhja dhe e njëjta t'i shtohet anës përkatëse).
- Përdorni komandën 'Justify' (Ctrl+J) për tërë brendinë e projektit tuaj. Kjo krijon një dukje më estetike dhe më të qartë të përmbajtjes.

Çdo punim duhet të përmbajë diçka të re, pra së paku qasje të re, që dallohet me përpunimin, argumentimin, që zakonisht nxirret nga të dhënat empirike, korrektësinë gramatikore dhe drejtshkrimore, arsyetimin dhe përfundimet origjinale, si dhe veçorinë e stilit të shkruarit, e cila është diçka tërësisht personale.

Në fund të kërkimit duhet të figurohet literatura përkatëse (librat dhe revistat shkencore) që kanë qenë në dispozicion për t'u shfrytëzuar, si pikëmbështetje teorike dhe si model i kërkimit.

Po ashtu, mund të paraqiten edhe burime të tjera: dokumente, raporte, të dhëna statistikore, si dhe burime për mbështetjen e kërkimit.

4. Citimet

Gjatë punës shkencore shumë herë i përdorim mendimet e të tjerëve. Që të mos biem ndesh me rregullat shkencore, ose më mirë të themi t'i respektojmë mendimet e të tjerëve, mendimin e tjetrit e fusim në thonjëza dhe e marrim ashtu si është, pa asnjë ndryshim, duke përfshirë edhe gabimet eventuale nga ana e autorit që e citojmë, pastaj e vendosim një fusnotë. Duke cituar mendimet e të tjerëve, ne do t'i shmangeshim plagjiaturës. Mirëpo, duhet të kemi kujdes që mos ta teprojmë me citime, pasi që nuk do të kemi asgjë tonën në punimi dhe të mos i përdorim aty ku nuk duhet. Në hyrje dhe përfundim të punimit nuk rekomandohet të citohet, gjithashtu nuk rekomandohet të citohet në fjalinë e parë të titullit ose nëntitullit dhe në fjalinë e fundit.

Në punime studimore dhe raporte citimet mund të përdoren:

- Për të treguar se një autoritet i fushës mbështet mendimin tuaj;
- Për të paraqitur mendimin e dikujt, të cilin do ta komentoni ose të cilin do ta argumentoni;

- Për të dhënë një pjesë të plotë teksti, vlera shprehëse dhe kuptimore e të cilit do të humbiste nëse do të shprehej me fjalët tuaja²⁴.

5.1. Llojet e citimeve

5.1.1. Citimet e drejtpërdrejta

Këto lloje të citimeve bëhen atëherë kur citojmë nga autori drejtpërdrejt, nga burimi i drejtpërdrejtë.

P.sh., autori Remzi Bujari, lidhur me rolin e mësimdhënësit në mësimdhënien ndërvepruese, thekson: “Në mësimdhënien ndërvepruese mësimdhënësi nuk është më në rolin shpjegues dhe të një dhënësi të diturive të gatshme me recetë fikse. Ai tashmë për nxënësin është më atraktiv, më i afërt, bashkëpunëtor që nxënësit i ndihmon për të mësuar rrugën, metodën e arritjes së diturisë e arsimimit”. Nëse burimi nuk është cituar më parë, shënojmë Remzi Bujari (2010). Mësimdhënia tradicionale dhe mësimdhënia ndërvepruese, “Berati”, Prizren, f. 52. Nëse burimi është cituar më parë, mund ta shënojmë: op cit. f. 52, ose nëse citohet radhazi nga i njëjti burim dhe autor shënohet: po aty, f. 52.

Nëse brenda tekstit që citohet dëshirojmë të bëjmë ndërhyrje, këtë e bëjmë brenda kllapave. Nëse dëshirojmë të heqim ndonjë pjesë të tekstit që e citojmë, atëherë në atë vend vendosim tri pika (...).

5.1.2. Citimet jo të drejtpërdrejta

Kur citojmë mund të ndodhë që të citojmë një burim brenda një burimi tjetër. Më mirë do të ishte që të citojmë nga burimet primare, mirëpo ndonjëherë kjo nuk është e mundur. Kur citojmë nga burime të tjera brenda një burimi, atëherë, përveç të dhënave nga e marrim tekstin, e cekim, e citojmë edhe burimin origjinal²⁵.

²⁴ Nishku, fq. 66.

²⁵ Boce, fq. 34-35.

5. Parafrazimet

Nuk është e thënë që mendimet e autorëve të tjerë çdoherë t'i marrim ashtu si janë. Për këtë ekziston mundësia që mendimet e tyre t'i modifikojmë e t'i përshtatim për nevojat e punimit tonë. Mirëpo, edhe me këtë rast duhet të kemi kujdes, pasi që nëse i marrim mendimet e të tjerëve dhe nuk tregojmë se i kemi marrë, bëjmë plagjiaturë.

Me rastin e perifrazimit, e marrim mendimin e dikujt tjetër, e rregullojmë me fjalët tona, por këtë tekst nuk e fusim fare në thonjëza, vetëm e vendosim një fusnotë.

6. Fusnotat

Fusnotat janë numra që vendosen në fund të tekstit që e citojmë, apo e perifrazojmë. Pasi të kemi përfunduar me tekstin e cituar, apo të perifrazuar, shkojmë tek insert, pastaj tek references, pastaj përcaktohem për insert footnote. Pas këtyre veprimeve, në fund të tekstit do të shfaqet një numër, po ashtu në fund të faqes do të shfaqet i njëjti numër dhe pas tij duhet të shënohen të dhënat se ku është marrë mendimi, p.sh. Remzi Bujari (2010). Mësimdhënia tradicionale dhe mësimdhënia ndërvepruese, "Berati", Prizren, f. 52.

Një model që zakonisht haset në tekstet dhe burimet e tjera amerikane është kur pas fjalisë futet në kllapa vetëm mbiemri i autorit, viti i botimit dhe faqja. P.sh. (Bujari, 2010, 52), ose (Bujari 52), pa e cekur vitin.

Një model tjetër është një kombinim i dy modeleve të mëparshme, pasi që pas fjalisë vendoset fusnota dhe në fund të faqes shënohet: Bujari, 2010, f. 52.

Këto janë disa (jo të vetmet) prej modeleve që aplikohen në shkencë, megjithëse dy të fundit janë më praktike, pasi që marrin më pak kohë, sepse shënohet vetëm një pjesë e të dhënave, ndërsa nëse dëshirojmë të dimë më tepër për atë burim, shkojmë te bibliografia dhe e gjejmë burimin me të dhënat e kompletuara.

Vërejtje: Në rast se autori, të cilit i referoheni, ka më tepër se një tekst në bibliografinë e punimit tuaj, patjetër duhet shënuar viti i botimit, por nëse ka

më shumë se një burim në të njëjtin vit, atëherë duhet shënuar edhe titulli i burimit.

P.sh. (Bujari, Mësimdhënia tradicionale dhe mësimdhënia ndërvepruese, 2010, 52).

Në këtë tekst jemi munduar që gjatë punës, në mënyrë praktike, të paraqesim mënyrat e ndryshme të vendosjes së fusnotave dhe mendimeve të të tjerë: në fund të faqes me të dhëna të kompletuara, në fund të faqes në formë të shkurtuar, në fund të fjalisë.

7. Bibliografia

Bibliografia është një pjesë e domosdoshme e çdo kërkimi dhe zakonisht vendoset para pjesës së shtojcave të punimit (nëse ka shtojca), por mund të vendoset edhe pas shtojcave.

Bibliografia përmban të gjitha burimet dhe shkrimet që i keni përdorur në çfarëdo mënyre në punën tuaj.

Kjo listë e burimeve të përdorura bëhet në mënyrë alfabetike, sipas mbiemrit të autorit. Ato burime, të cilat nuk kanë autor (enciklopedi, filma etj.), duhet të alfabetizohen sipas titullit të tyre. Çdo burim i cituar në projekt duhet të jetë i përfshirë edhe në listën e referencave/bibliografisë.

Ekzistojnë disa formate të ndryshme të shkrimit të bibliografisë, të cilat varen prej natyrës së shkrimit, llojit të lëndës, por edhe prej autorit dhe sistemit për të cilin ai përcaktohet.

Më poshtë janë disa udhëzime të përgjithshme për shkrimin e përmbajtjes së bibliografisë:

- * Mos vendosni numër në listën e bibliografisë!
- * Organizoni punimet e të njëjtit autor (kur ka më tepër se një titull) sipas vitit të botimeve të tyre dhe jo sipas titullit.

Për një autor. Shembull:

Nushi, P. (2005). *Psikologjia e përgjithshme*. “Libri shkollor”, Prishtinë.

Për dy autorë. Shembull:

Bredecamp, S. & Copple, C. (1997). *Developmentally appropriate practices in early childhood programs*. Revised Edition. Washington, DC:NAEYC

Kur autori nuk është përmendur. Shembull:

Kurrikula e edukimit parashkollor në Kosovë, 3-6 vjeç. (2006). Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. 'Libri Shkollor', Prishtinë.

Për enciklopedi. Shembull:

Enciklopedia Britanike, (1997). Volumi 7, 'Gorillas', f. 50-51

Për revistë. Shembull:

Azemi, B., (2012). "Të mësuarit e vetorganizuar dhe të vetëdrejtuar". "Kërkime Pedagogjike", 3, 25-39.

Për gazetë. Shembull:

Azemi, B., (2012). "Si të bëhesh një mësues më i mirë". "Mësuesi", Prishtinë, nr. 12, f. 7.

Për tezë të pabotuar. (Raport, magistraturë apo doktoratë) Shembull:

Rose, B. (1994). The importance of Gross Motor Coordination in the Psycho-social lives of Children. Unpublished PhD Thesis. University of Western Australia.

Për intervistë. Shembull:

Arta Berisha. Juriste. 19 Mars 2009.

Për film. Shembull:

Braveheart, (1950). Dir. Mel Gibson, Icon Productions.

Për CD. Shembull:

Compton's Multimedia Encyclopedia: Macintosh version, (1995). "Civil rights movement," p.3. Compton's Neësmedia.

Burimet 'online'

Burimet 'online' vendosen gjithmonë në fund të listës së bibliografisë.

Internet. Shembull:

Ellen Block, (15 shtator, 1995). New Winners. Teen Booklist (World Wide Web:

<http://www.boston.com>. Today's News, 1 gusht, 1996 online). Helen Smith@wellington.com

<http://www.nethelp.no>. 12 mars 2007.

Gjatë punës shkencore përdoren shumë burime shkencore, mirëpo disa burime mund të përdoren gjatë formimit të përmbajtjeve, e disa burime të

tjera vetëm i konsultojmë. Nëse vetëm i kemi konsultuar këto burime, nuk do të thotë se nuk kemi të drejtë t'i renditim në kuadër të bibliografisë.

Mënyrat e renditjes së burimeve në kuadër të bibliografisë:

- Në bazë të alfabetit - Kjo mënyrë e renditjes është më e mirë, pasi që është më lehtë t'i gjejmë autorët e ndryshëm, p.sh. Bujari, Remzi. 2010, *Mësimdhënia tradicionale dhe mësimdhënia ndërvepruese*, "Berati", Prizren. Pastaj do të vijë autori që i fillon mbiemri me shkronjën pasuese, p.sh. Cana, Hasan, ose Zabeli, Naser. Nëse i njëjti autor ka më shumë se një punim të botuar, preferohet që punimi më i ri të vendoset i pari.

Shembull:

Bujari, Remzi. 2010, *Mësimdhënia tradicionale dhe mësimdhënia ndërvepruese*, "Berati", Prizren;

Bujari, Remzi, "Mundësitë dhe parakushtet e përfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta në sistemin e rregullt mësimor", "Dija", RHRDP, nr. 3, Prishtinë, 2003.

- Në bazë të vitit të botimit - Kjo mënyrë e renditjes nuk është e preferuar, sepse i njëjti autor (nëse ka më shumë se një botim) mund të gjendet në fillim ose në fund të renditjes.
- Vendosja e vitit të botimit - Shumë autorë vitin e botimit e vendosin pas vendit të botimit, p.sh. Koliqi, dr. Hajrullah, *Historia e pedagogjisë botërore I*, UP, Prishtinë, 1997. Mirëpo, më e preferuar është që viti i botimit të vendoset menjëherë pas emrit dhe mbiemrit, p.sh. Koliqi, dr. Hajrullah (1997), *Historia e pedagogjisë botërore I*, UP, Prishtinë.

Burimet nga interneti

Një nga burimet e informacionit që citohet në kërkimin tuaj janë edhe faqet e internetit.

Nga vetë natyra e tij, interneti është përherë në ndryshim, prandaj zakonisht duhet të shënohet data e klikimit kur është shfrytëzuar një dokument përmes internetit.

Kujdes, informacioni që gjendet në internet është vështirë të vlerësohet.

FJALORTH

Abstrahimi - proces i ndarjes së të përgjithshmes dhe asaj që është fillimisht e përbashkët nga ajo që është e posaçme dhe shumë individuale.

Abstrakti i një kërkimi - një përmbledhje që përshkruan aspektet më të rëndësishme të kërkimit.

Administrimi i të dhënave të gatshme - të dhënat që merren nga portofolio, dokumentacioni, udhëzimet, ligjet etj.

Argumentimi - krejt ajo që nuk ka mundur të përgënjeshtrohet.

Artikulli, vështrimi - punimi shkencor që i kushtohet një problemi të vogël brenda një problemi të madh shkencor.

Aspiratë - synimi ndaj një qëllimi të caktuar, që përcillet me një dëshirë dhe motiv të fuqishëm për realizimin e qëllimit.

Besueshmëria e kërkimit - përmasa në të cilën përfundimet e kërkimit shkencor janë të qëndrueshme sa herë që ai të përsëritet, si dhe përmasa në të cilën një studim mund të replikohet (të përsëritet nga studiues të tjerë).

Bibliografia libër – libër që përmbledh, vlerëson, zgjedh, analizon përmbajtjet dhe përshkruan veprat e publikuara, të shumëzuara, të cilat janë të dedikuara për publik. (Njëra nga detyrat më të rëndësishme të bibliografisë libër është grumbullimi, përpunimi dhe prezantimi i informacioneve relevante për veprat e publikuara, si ato të shkruara e të papublikuara nga lëmenjtë shkencorë).

Bibliografia si literaturë e cituar - burimet që janë cituar diku në tekst (jo materialet që janë shfrytëzuar për lexim të përgjithshëm). Bibliografia duhet të listohet numerikisht në mënyrë alfabetike në bazë të mbiemrit të autorit të parë.

Buxheti i kërkimit - kostoja (paraja) e nevojshme që duhet paguar për realizimin e kërkimit (preferohet të jepet në formë tabelare, të ndarë në aspekte apo etapa të veçanta të realizimit të kërkimit).

Caktimi i mostrës - zgjedhja e njësisë (subjekteve) për kërkim.

Deduksioni - metoda e nxjerrjes së përfundimeve nga një apo më tepër premisa, gjegjësisht nxjerrja e qëndrimeve nga një qëndrim i përgjithshëm, apo nga dy apo më shumë qëndrime. (**Deduksioni i drejtpërdrejtë** nënkupton nxjerrjen e qëndrimit të ri nga një premisë. **Deduksioni i tërthortë** nënkupton nxjerrjen e qëndrimit të ri nga dy apo më tepër premisa).

Devijim standard - matje statistikore që tregon një vlerë të shpërndarjes brenda një renditjeje vlerash, e barabartë me rrënjën katrore të variancës. (Simboli i tij është s - sigma. Ai është treguesi më i përdorur i variacionit të vlerave prej mesatares).

Dikotomia - procedura e ndarjes së një nocioni apo koncepti në dy pjesë: njëra pozitive dhe tjetra negative. (P.sh.: i suksesshëm - i pasuksesshëm; i vlefshëm- i pavlefshëm; i shkathët - i ngathët; i angazhuar - i paangazhuar).

Disertacioni i doktoratës - punim origjinal i kandidatit për zgjedhjen ose ndriçimin e çështjeve të ndryshme shkencore, në të cilën zbulohen fakte të reja.

Dokumentimi - veprimi kur kërkuesi mban shënime, regjistron dhe përshkruan sjellje dhe mbi bazën e tyre, pas një analize, bën raportin me shkrim të kërkimit.

Elementi i kampionit - një rast ose një njësi e vetme që zgjidhet prej popullatës dhe matet në njëfarë mënyre - përbën bazën për analizë (p.sh. një person, objekt, kohë specifike etj).

Enciklopedia - vepër gjithëpërfshirëse, që përmbajtur njohuri, informacione me përmbajtje të shkurtra.

Eseja shkencore - punimi që përmban elemente të shkrimit shkencor, letrar dhe publicistik për një çështje të caktuar shkencore, shoqërore etj.

Faktorët objektivë - faktorët e imponuar nga jashtë, që ndikojnë në punën hulumtuese.

Faktorët subjektivë - aftësitë, profesionalizmi, sfondi akademik i kërkuesit, njohja e gjuhëve të huaja etj.

Fazat e kërkimit shkencor - hapat sipas të cilëve do të zhvillohet hulumtimi i projekteve kërkimore, prej fillimit deri në fund.

Fjalorët - fjalët dhe shprehjet me të cilat shërbehemi më shpesh për të mësuar dhe sqaruar fjalët dhe shprehjet që i përdorim gjatë kërkimit.

Formulimi i problemit - zgjedhja e temës (zakonisht është titull i punimit).

Fusnotat - numrat që vendosen në fund të tekstit që e citojmë apo perifrazojmë.

Grupi përfaqësues - pjesë e popullacionit, e zgjedhur nga një pjesë e rasteve individuale (në bazë të disa kriterëve), me qëllim të përfaqësimit të tërë popullacionit. (Në literaturë mund të haset edhe me emërtime të tjera: model, kampion, ekzemplar etj).

Hipoteza - ide ose hamendje për një çështje, problem të caktuar, e parashtruar si bazë për punë empirike.

Kërkim empirik - hulumtim faktik i realitetit, i kryer në një fushë të caktuar edukative.

Kërkimet shkencore - aktivitete intelektuale, shumë konkrete dhe të definuara qëllimisht, të cilat realizohen me zbatimin e një procedure të përcaktuar, sipas kriterëve të definuara të zgjedhjes dhe vlerësimit në një shkencë apo disiplinë shkencore. (Kërkimet shkencore dallojnë nga kërkimet profesionale, si në mënyrën e ofrimit dhe shtjellimit të të dhënave dhe fakteve, po ashtu edhe në përmbajtjen dhe vëllimin e tyre).

Indeksi i cilësisë së shkollës - instrument që synon të masë aspekte të organizimit, menaxhimit të shkollës dhe mirëqenies së fëmijës.

Induksioni i plotë - kërkon njohuri mbi të gjithë pjesëtarët e grupit (ka të bëjë vetëm me grupin përfundimtar) dhe nxjerrjen e qëndrimit (mendimit) të përgjithshëm, në bazë të të gjitha qëndrimeve apo mendimeve për çdo pjesëtar individualisht.

Induksioni jo i plotë - nxirret në bazë të numrit të caktuar të ekzemplarëve për të gjitha modelet e klasës, i cila mund të jetë përfundimtar (ta ketë numrin përfundimtar të ekzemplarëve).

Iniciativa për të hulumtuar - gatishmëria e kërkuesit për të filluar kërkimin dhe për të kërkuar në drejtime të reja.

Instrumenti i gatshëm - instrumenti i standardizuar, i cili ka nevojë vetëm të përshtatet për kontekstin e caktuar.

Instrumenti i përzier - kërkuesi merr disa nga pyetjet nga instrumenti i standardizuar, por hiqen disa pyetje dhe vendosen disa pyetje të tjera, që lidhen me kontekstin vendor.

Instrumenti i ri - kërkuesi harton një instrument enkas për kërkimin, i cili duhet t'i nënshtrohet validimit dhe besueshmërisë së tij.

Intervistë [e strukturuar] - instrument kërkimor i përbërë nga një listë pyetjesh të parapërcaktuara, të cilat synojnë të mbledhin të dhëna mbi një çështje të caktuar. (Ka të bëjë me përcaktimin e kohës, gjatë së cilës ndodh tërë ecuria e kërkimit, në të cilën të specifikohen aktivitetet e veçanta të kërkimit dhe periudha kur ato duhet të zhvillohen përfshin momentin e fillimit të propozimit tuaj deri në publikimin apo prezantimin e rezultateve).

Kampioni - varg rastesh që zgjidhen nga një grup më i madh dhe që përdoren për të bërë përgjithësime për popullatën.

Kampioni mbi bazë grupi - në këtë rast njësia primare e kampionit nuk është një element individual në popullatë, por një grup elementesh.

Kampioni me bazë rastësore sistematike - pika fillestare që caktohet me anë të një procesi rastësor dhe më pas numri që vjen pas një numri të caktuar x në listë zgjidhet në kampion.

Kampioni me zgjedhje rastësore, i stratifikuar (i shtresëzuar) - përcaktohen nëngrupe nga grupe (shtresa) të ndryshme të paracaktuara, që kanë disa karakteristika të ngjashme.

Kampioni me zgjedhje të thjeshtë rastësore - siguron se çdo element në popullatë ka një shans të barabartë për t'u zgjedhur në kampion.

Kërkim korrelacional - lloj i kërkimit shkencor, nëpërmjet të cilit përcaktohet nëse ndërmjet dy a më shumë ndryshoreve ekziston një lidhje domethënëse, pozitive apo negative. (Nëse korrelacioni është pozitiv, kjo do të thotë se rritja apo ulja e vlerave të njëjës ndryshore (x) shoqërohet me rritjen apo uljen e vlerave të ndryshores tjetër (y) dhe anasjelltas).

Kërkime aktive (në veprim) - kërkime që zakonisht i zhvillojnë mësuesit për të përmirësuar mësimdhënien dhe të mësuarit e nxënësve të tyre.

Klasifikim - grupim i dukurive që hulumtohen në kategori. (Klasifikimi është procedura e ndarjes së një tërësie në disa nyje, sipas kriterit të definuar që më parë, i cili njëkohësisht shpreh përkatësinë e të gjithë anëtarëve, tërësisë së caktuar, por edhe specifikat e dispozitave të tyre).

Klima e shkollës/klasës - atmosfera sociale e mjedisit, apo e rrethanave të të nxënit.

Koeficient korrelacioni - vlerë midis -1 dhe 1, që tregon fortësinë e lidhjes ndërmjet ndryshoreve (vlera -1 tregon një lidhje të fortë negative, vlera 1 tregon një lidhje të fortë pozitive, ndërsa vlera 0 tregon se midis ndryshoreve nuk ka asnjë lidhje (masë e shkallës së bashkëlidhjes midis variablave në hulumtim).

Koha e realizimit të kërkimit - dinamika e realizimit të kërkimit sipas javëve ose muajve.

Konkludimi - pasim i një mendimi të ri nga mendimet e tjera.

Konkluzioni - mendim i nxjerrë me procedurë të drejtë nga mendimet e tjera autentike.

Konteksti i kërkimit - mjedisi ose situata tërësore që e rrethon një dukuri që e hulumton kërkuesi dhe që ka ndërveprim ndikues.

Korrelacion – përshkrim statistikor që mundëson të vihen re se sa ngushtë lidhen dy ndryshore.

Kritika shkencore - opinione për punimet e autorëve të tjerë. (Zakonisht kritikët kanë një qasje të argumentuar, objektive dhe shkencore, kur i shkruajnë ato).

Marrëdhënie shkakësore - marrëdhënie nëpërmjet së cilës një gjendje (pasojë) është rezultat i diçkaje tjetër (shkakut).

Menaxhimi i projektit - procedura për zbatimin e strukturuar të detyrave me përmbajtje komplekse, gjatë realizimit të projektit, të cilat janë të kufizuara në kohë, kanë një qëllim të caktuar dhe shfaqen gjatë punës së përditshme të gjithsecili hulumtues.

Mesore - numri që ndodhet në mes të një game numrash, mënyrë e llogaritjes së tendencës qendrore, që ndonjëherë është më e përdorshme se llogaritja e të mesmes.

Metoda e trekëndëshit - përdorimi i disa metodave kërkimore njëkohësisht, në mënyrë që të sigurohet vlefshmëria e të dhënave.

Moda - tregues i tendencës qendrore, vlera që përsëritet më së shpeshti dhe nuk ndikohet nga vlerat ekstreme (përdoret për të dhëna numerike dhe kategorike).

Monografia - punim që trajton një temë të veçantë në tërësinë e saj, që ka titullin e vet dhe që zakonisht botohet si libër.

Grupi përfaqësues - nënkupton zgjedhjen e numrit të caktuar të njëjësive reprezentative të njohurisë dhe përfundimin për atë dukuri, në bazë të atyre njëjësive.

Kampioni jo me probabilitet - mënyra arbitrare në seleksionimin e njëjësive të kampionit që bazohen në konsiderata subjektive ose gjykime personale.

Kampioni me probabilitet - çdo njësi (element i popullatës) së studimit ka një probabilitet jo- zero në seleksionimin në një kampion dhe çdo anëtar i popullatës ka një probabilitet të barabartë në përzgjedhjen e një kampioni.

Objektivat e përgjithshme - pohime, të cilat zbërthejnë realizimin e qëllimit të kërkimit.

Objektivat specifike - pohime, të cilat i referohen aktiviteteve specifike apo të arritave specifike të pritura të kërkimit, si rrjedhim i rezultateve empirike.

Pastrimi i të dhënave - heqja e të dhënave që nuk na interesojnë, ose që nuk kanë lidhje me kërkimin.

Përgënjeshtrimi - verifikimi i pasaktësisë së njohurisë, gjegjësisht përgënjeshtrimi i rezultateve të mëparshme.

Përzgjedhje - zgjedhje e një përqindje individësh ose rastesh nga popullsia, si përfaqësuese të asaj popullsie në tërësi.

Pilotim i testit - testim vlerësues për pyetjet në test dhe vlefshmërinë e testit.

